

Fetnete Ramosaj

KRIMET SERBE NË KOSOVË
PA APOLOGJI
ME FAKTE KUNDËR SHPIFJEVE

Editor:

Rasim Selmanaj

Recensentë:

Dr. Zymer Neziri

Dr. Lush Culaj

Faton Mehmetaj

Ballina:

Shkëlzen Rexha

Realizimi kompjuterik:

n_design@yahoo.com

Shtypi:

“Dukagjini”

Pejë, 2005

Tirazhi:

10 000 kopje

Fetnete Ramosaj

KRIMET SERBE NË KOSOVË PA APOLOGJI ME FAKTE KUNDËR SHPIFJEVE

(Ribotim)



Prishtinë

2005

Përmbajtja

HYRJE	7
PJESA E PARË	
Humbjet në vijat e frontit serbët i paraqesin si viktime të	
“sulmeve terroriste”	17
Sulme të pandërprera, goditje edhe me raketa “Luna”	23
Masakrat e tmerrshme në Lybeniq	27
Serbia nuk zgjodhi mjete për të arritur qëllimet e veta	33
Humbjet në luftimet e zhvilluara gjatë vitit 1999	44
Fundi i kriminelëve famëkëqinj Vidomir Shalipur	
e Millutin Prashçeviq	46
PJESA E DYTË	
Krimet që ka bërë vet, Serbia ua mveshë “terroristëve shqiptarë” ..	67
Si tenton të “shfajësohet” regjimi serb për krimet e bëra?	70
Serbët, pasi e vrasin plakën 75-vjeçare, krimin e shpallin	
vepër të “terroristëve shqiptarë”	82
Krimi makabër në Rakovinë	85
Loja me kartën e përçarjes fetare	98
Vrasësit e Aganit, sipas Danica Marinkoviqit,	
kishin “kryer me nder punën e vet”	99
Mbulimi i krimeve të kryera në Kosovë, shkatërrimi dhe	
zhdukja e dëshmive	108
NË VEND TË PËRFUNDIMIT –	
DËSHMI TË VERIFIKUARA	117
Burimet dhe literatura	121
Faksimile e fotografi	123

Hyrje

Populli i Kosovës në krye me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe pse bëri luftë mbrojtëse, luftë për liri, megjithatë, shqiptarët po e paguajnë shtrenjtë haraçin e krimeve që kryen forcat serbe në Kosovë. Propaganda e zezë serbe edhe pse tërësisht e bazuar në shpifje e të pavërteta, ka dhënë e po jep rezultate.

Çdo krim të kryer nga forcat serbe në Kosovë, Serbia është përkujdesur me kohë që t'ia adreson UÇK-së. Ndërkaq në raste të tjera është përkujdesur të trumbetojë se krimi apo krimet të jenë bërë gjithsesi për shkak të saj (UÇK-së). Edhe pse e vërteta e këtyre vrasjeve dihet botërisht, fabrikimet, shpifjet dhe trillimet e tilla kanë mjaftuar të bëhen lëndë për kriminalizimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Megjithëse pa asnjë bazë qëndrueshmërie, "argumentet" e milicisë serbe janë bërë "brum" i mirë për dosje kundër pjesëtarëve të UÇK-së.

Pas luftës në Kosovë, më së shumti janë diskutuar "krimet" që nga qarqe të caktuara i janë mvëshur UÇK-së. Madje, dëshmitë kundër saj, janë stimuluar në mënyra nga

më të ndryshmet, ndërsa krimet serbe është tentuar dhe po tentohet të lihen në harresë. Jo rastësisht po mbulohen krimet serbe, jo rastësisht po tentohet të tërhiqen paralele për bashkëpërgjegjësi për luftën e zhvilluar në Kosovë. Pasojat e këtyre tendencave janë tepër të rënda dhe të kushtueshme si për të sotmen, ashtu edhe për të ardhmen e Kosovës. Deri më tani, asnjë serb nuk është përgjigjur për vrasjet dhe masakrimet e rreth 20 000 qytetarëve të Kosovës; askush nuk është përgjigjur për mijëra dhunime; askush nuk është përgjigjur për qindra-mijëra djegie e shkatërrime; askush nuk është përgjigjur për dhunën, terrorin, gjenocidin dhe dëbimin masiv të popullit të Kosovës. Madje, askush nuk denjoi as të kërkojë falje për të bëmat mizore në Kosovë.

Se në lartësitë e Kopaonikut të Kosovës ekziston një kamp sekret, ku punojnë specialistë të policisë sekrete nga Beogradi, u mësua në Gjyqin e Hagës. Në atë kamp marrin mësim dhe përpunohen ish-spiunët e UDB-së serbe që të dalin dëshmitarë në Gjyqin e Hagës kundër pjesëtarëve të UÇK-së.¹ Praktikisht, edhe shumë deklarata akuzuese kundër UÇK-së, janë nxjerrë me dhunë gjatë luftës në policinë serbe, në burgjet serbe, nga njerëz të zënë rob, nga njerëz të kërcënuar me vdekje. Ata që guxuan të thonë të vërtetën u kushtoi me jetë.²

¹ Sylejman Krasniqi, *Akademikët serbë – piromanë të Ballkanit*, "Shekulli", janar 2005; "Fokusi", shkurt 2005.

² Fetnete Ramosaj, *Haga rrëshqiti në shpifjet e Serbisë, Viktimat demantojnë & demontojnë aktakuzën e shpifur*, "Fokusi" nr. 94, 25 mars 2005.

Se thënia e të vërtetës për krimet serbe në Kosovë kushton shtrenjtë e dëshmon edhe një rast i ndodhur më 1 prill të vitit 1999, kur forca të mëdha ushtarake, policore e paramilitare serbe e kryen masakrën e dytë brenda një viti në Lybeniq të Pejës.³ Rrahjet brutale, fyerjet, provokimet e kërcënimeve që u bëhen atë ditë njerëzve, nuk pushojnë që nga momentet e para të dëbimit të familjeve nga shtëpitë e tyre e deri në kryerjen e njëres nga masakrat më monstruozë në këtë anë. Pyetjes provokuese të njërit nga xhelatët serbë se kush i ka djegur disa shtëpi të fshatit një vit më parë, i ishte përgjigjur Adem Haradinaj: *“Shtëpitë i ka djegur policia serbe”*, por thënia e të vërtetës i kushtoi me ekzekutim mizor. Pas kësaj përgjigjeje policët e nxjerrin nga turma e njerëzve dhe e ekzekutojnë me breshëri pushkomitralozi. Menjëherë pas tij, në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtin pretekst nxirret nga turma e njerëzve dhe para syve të tyre me breshëri pushkomitralozi ekzekutohet edhe Ukë Bushati... Pjesa dërrmuese e njerëzve të tubuar (80 vetë) vriten, por edhe të plagosurit shtiren si të vrarë. Vrasësit, duke dashur që të mos lënë dëshmitarë të gjallë, zbrazin breshëri armësh mbi të gjithë ata që me lëvizjet apo klithmat e tyre kanë dhënë shenja jete.⁴

Përderisa, në vitin 2003, u ngrit aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër Fatmir Limajt – Komandant “Çelikut”, Isak Musliut dhe Haradin Balajt, me

³ Po aty.

⁴ F. Ramosaj, po aty.

qëllimin e vetëm – kriminalizimin e luftës çlirimtare të UÇK-së e me tendencë të qarta për rikthimin e Kosovës nën Serbi, në anën tjetër, kriminelët nga Beogradi i gëzoheshin aktakuzës së ngritur nga Haga mbi vlerësime politike të gabuara për UÇK-në (madje edhe aktakuza tërësisht të gabuara për persona që nuk kanë qenë fare pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç ishte rasti me Agim Murtezin). Krahës kësaj, dolën me kërkesa dhe veprime konkrete për krijimin e njëfarë “mini-Serbie” brenda territorit të Kosovës. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2003 Ministri Republikan i Drejtësisë së Serbisë, Vladan Batiq dhe kreu i UDB-së, Aleksandër Vasiljeviq u kanosën se do të dërgonin në Hagë më tepër se 400 shqiptarë.⁵

Është shkelje e rëndë e të drejtës njerëzore kur bëhen padrejtësi në emër të drejtësisë. Një gjë e tillë po ndodh në rastin e ish-komandantit të ZOD-it, njëherit ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj dhe bashkëluftëtarëve të tjerë Lahi Brahimaj e Idriz Balaj, një gjë e tillë po u ndodh shqiptarëve, jo për të parën herë. Duke parë kutet e dyfishta të “drejtësisë” ndërkombëtare, te shqiptarët e Kosovës gjithnjë e më shumë po thellohet bindja se kurrë nuk do të marrin drejtësi dhe se akuzat e ngritura kundër ish-luftëtarëve të UÇK-së janë thellësisht politike. Në anën tjetër, qëllimisht janë lënë në harresë mijëra kriminelë serbë

⁵ S. Krasniqi, po aty.

që e gjakosën Kosovën për të satën herë. Haga ka dëshmi më se të mjaftueshme për krimet e tyre.⁶

Mjafton të përkujtojmë krimin e kryer gjashtë vjet më parë në Beleg të Deçanit, ku forcat policore serbe vranë e zhdukën 66 shqiptarë, në mesin e tyre edhe 6 fëmijë të mitur. Sipas atyre që e mbijetuan krimin, në krye të aksionit ishin oficerët dhe policët e MUP-it serb të Deçanit. Dy ditë e netë radhazi dogjën, plaçkitën, dhunuan e çka nuk bënë. Asnjë gjurmë e 66 të zhdukurve as sot e kësaj dite. Në atë masakër një oficer serb i MUP-it të Deçanit, e kishte gjymtuar dhe ia kishte prerë gjuhën profesorit, intelektualit dhe atdhetarit të nderuar të kësaj ane, Nezir (Ibish) Vishajt, nga Belegu, pse e fliste bukur e qartë gjuhën letrare shqipe. I plagosur profesori kishte arritur të largohej nga fshati, por jo t'i shpëtonte ekze-kutimit. Mizorisht së bashku me shtatë civilë të tjerë të plagosur zihet dhe ekzekutohet më 6 prill 1999 në fshatin Bardhaniq të Gjakovës. Tribunali i Hagës disponon me të dhënat konkrete për autorët e këtyre krimeve.⁷

Aktakuza me nr. IT-04-84-I, e ngritur nga prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte, kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lahi Brahimaajt, mund të jetë gjithçka, mund të jetë fyerje, shpifje, trillime, fabrikime, por jo aktakuzë e mirëfilltë, aq më tepër

⁶ Fetnete Ramosaj, *Kështu operuan eskadronet serbe të vdekjes - Këta i bënë krimet dhe ua mvishnin "terroristëve shqiptarë"*, "Fokusi", Nr. 95, 1 prill 2005.

⁷ Po aty.

e përpiluar nga një Tribunal Ndërkombëtar. Rastet që përfshihen aty, është e qartë se janë bartur komplet nga dosjet serbe (10-15 mijë faqe) të dorëzuara nga MUP-i serb dhe ish-ministri i Drejtësisë i Republikës së Serbisë, Vladan Batiq, i cili, pas ngritjes së aktakuzës, u shpreh i entuziazmuar se ato janë "faktet" e tij, por që, fatmirësisht, nuk përkojnë aspak me të vërtetën. Shpifje të tilla tash gjashtë vjet na ka rënë t'i hasim në adresa interneti (madje edhe në adresa zyrtare të MUP-it serb), në publikime të "Jedinstvo"-s, në "Bela Knjiga" etj.⁸

Dihet mirëfilli se organizimi i luftës dhe i radhëve të UÇK-së ka qenë vullnetar dhe si i tillë nuk i është imponuar askujt me dhunë.

Hartuesit e aktakuzës "harrojnë" faktin se në Kosovë gjatë periudhës mars 1998 - qershor 1999 është zhvilluar luftë në mes të forcave pushtuese serbo-jugosllave dhe njësive çlirimtare të UÇK-së. Fakti se kush ka qenë sulmues e kush mbrojtës dihet botërisht. Asnjë veprim i UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit, e aq më tepër i Ramush Haradinajt, nuk përkon me aktakuzën për "diskriminim" as mbi bazë fetare, as politike, as racore. Në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishte edhe pjesëtarë të kombësive joshqiptare: boshnjakë, egjiptianë, romë, turq, prej të cilëve edhe kanë rënë dëshmorë. Të tjerë janë vrarë nga forcat serbe vetëm pse nuk kanë pranuar të jenë

⁸ F. Ramosaj, *Haga rrëshqiti në shpifjet e Serbisë*..., pun. i cit. më lartë.

bashkëpjesëmarrës në terrorin e organizuar kundër shqiptarëve.⁹

Kishte familje serbe që qëndruan në shtëpitë e tyre në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja edhe gjatë zhvillimit të luftimeve dhe askush nuk u ka thënë asgjë. Përmendim këtu rastin e Milivoje Shqekiqit nga Rashiqi i Pejës, i cili ishte bashkë me të shoqen dhe të birin 31-vjeçar, me aftësi të kufizuara. Për muaj të tërë u kujdesën shqiptarët për të. Madje edhe për sigurinë e tyre dhe sigurimin e gjërave ushqimore, veshmbathjen etj. Familjen Shqekiq, policia serbe e kishte shpërngulur me dhunë pas ofenzivës së shtatorit të vitit 1998. Sapo kishin arritur në Pejë, djalin e tyre e mobilizuan në radhët e policisë.¹⁰

Është bërë shumë zhurmë mediale kinse për varrezat masive të “zbuluara” nga policia serbe në rajonin e Gllogjanit, të Irzniqit e të Liqenit të Radoniqit, në shtator të vitit 1998. Por, për këtë nuk ka asnjë fakt real. Dihet se prej 12 gushtit 1998, këto rajone bien nën kontrollin e forcave serbe. Kur pas ofenzivës së gjerë të ndërmarrë kundër pozicioneve të UÇK-së prej datës 2 deri më 12 gusht, në frontin e luftës: Hereç – Gramaçel – Baballoç – Rastavicë – Prejlep – Carrabreg – Beleg dhe në anën tjetër Gramaçel – Sukë e Bitesheve – Shaptej – Gllogjan – Irzniq forcat ushtarako-policore serbe përdorën gjithë makinerinë e rëndë luftarake, madje edhe helmet kimiko-biologjike. Në

⁹ F. Ramosaj, *Kështu operuan eskadronet serbe të vdekjes...*, pun. i cit. më lartë.

¹⁰ Po aty.

kuadër të forcave serbe në numër të konsiderueshëm kishte edhe mercenarë rusë e bullgarë. Gjatë gjithë kohës u luftua për jetë a vdekje. Këtë e tregon edhe numri më i madh i dëshmorëve të rënë, por edhe numri i luftëtarëve të plagosur të UÇK-së në vijat e para të frontit.

Për një muaj me radhë forcat serbe kanë bërë inskenimin e “vendit të ngjarjes” për të paraqitur veprimet e “terroristëve shqiptarë”. Aty kanë përfshirë edhe viktimat shqiptare të ekzekutuar e të gjetur në vendet, të cilat si në kohën e vrasjes, si në kohën e gjetjes së kufomave, kanë qenë nën kontrollin e plotë të forcave serbe. Në të kundërtën, sikur vërtet të kishin ekzistuar “varreza masive”, forcat serbe nuk do të prisnin një muaj për të publikuar “lajmin” senzacional.¹¹ Këso kohe në këtë rajon, pos tjerash, ishin të përqendruara edhe njësitë kriminale serbe: Njësitë Speciale të Policisë (Posebne Jedinice Policije - PJP), Njësia terroriste “Munja”, Njësitë e Komandës 125 të Brigadave të Motorizuara Tankiste të Serbisë, etj.

Është për keqardhje që Tribunali i Hagës, ka rënë pre e shpifjeve të tilla të Serbisë, e cila me çdo kusht është përpjekur e përpiket t’i fshehtë gjurmët e krimeve të veta (vrasjen me gjakftohtësi të më shumë se 12 000 civilëve, e zhdukjen e 3 500 të tjerëve), për çka askush nuk është përgjigjur deri më tani (përgjashtë gjykimin e Millosheviqit).

¹¹ Po aty.

Dihet se gjatë luftës frontale në rajonin e Dukagjinit, pandërprerë janë zhvilluar luftime tepër të rrepta. Nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Dukagjinit kanë rënë 706 dëshmorë, 24 vetëm prej Gllogjanit, dy prej tyre vëllezër të Ramush Haradinajt. Por, edhe humbjet e forcave ushtarake-policore e paramilitare serbe nuk ishin të vogla. Prandaj, fokusimi i organeve shtetërore serbe të kohës së luftës dhe të pasluftës kundër bartësve të luftës në këtë rajon nuk është i rastit.¹²

Ngritja e aktakuzës kundër komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, njëherit kryeministër i Kosovës, dhe dy bashkëluftëtarëve të tjerë, ka shkaktuar indinjatë e zhgënjim në drejtësinë ndërkombëtare, tek mbarë populli i Kosovës, pa dallime politike e fetare. Krahas kësaj, çjerrja e maskave të kësaj aktakuze ka filluar.¹³ Gjithnjë e më shumë familjarët e viktimave të përfshira në këtë aktakuzë, përmes reagimeve publike, në mediat e shkruara dhe ato elektronike e audiovizuese të Kosovës, po i demantojnë akuzat e TPI-së, duke theksuar se këto raste (si të vrasjeve, si të montimit të akuzës), kanë vetëm një burim - SERBINË.¹⁴

Është absurde të tentohet të barazohet fajësia. E ardhmja nuk ndërtohet mbi padrejtësi të reja.

¹² F. Ramosaj, *Haga rrëshqiti në shpifjet e Serbisë...*, pun. i cit. më lartë.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

PJESA E PARË

HUMBJET NË VIJAT E FRONTIT SERBËT I PARAQESIN SI VIKTIMA TË “SULMEVE TERRORISTE”

Duke parë krimet monstruoze të orgjive serbe të kryera mbi popullatën civile shqiptare, pa kursyer gratë, pleqtë e fëmijët, në fundshkurtin dhe fillimarsin e vitit 1998, në rajonin e Drenicës, si në Prekaz, Likoshan, Qirez e gjetiu, edhe popullsia e Rrafshit të Dukagjinit, sikurse e mbarë Kosovës, u bind se vetëm me organizimin e një lufte efektive mbrojtëse mund t'u shpëtonte vrasjeve e masakra meve masive, të cilat populli i këtyre trevave i kishte përjetuar në kurrizin e vet shumë herë gjatë historisë nga regjimet e ndryshme serbosllave.

Prandaj, duke parë koncentrimin e madh të forcave policore e ushtarake serbe, edhe në Rrafshin e Dukagjinit, që në ditët e dimrit, ishte e qartë për secilin se i njëjti skenar sikurse në Drenicë do të përsëritej shpejt edhe në këtë rajon. Aq më tepër, kur punkteve të deriatëhershme të policisë serbe në Deçan, Irzniq, Baballoç e Junik, që nga 4 shkurti i vitit 1998, u erdhën në përforcim edhe njësitë e Brigadës Speciale të Policisë, nga Beogradi. Dhuna, maltretime të

keqtrajtimet e qytetarëve shqiptarë ishin shtuar tej mase. Deri atëherë e vetmja forcë serioze që u ishte kundërvënë forcave pushtuese ushtarake-policore e paramilitare serbe ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila, edhe pse me sakrifica të shumta, edhe pse e vetëdijshme se kishte të bënte me një armik gjakatar, me të cilin ishte e pabarabartë për nga përgatitja dhe teknika luftarake, tashmë kishte dhënë prova faktike se ishte e pathyeshme në përballje me forcat serbe. Prandaj, nuk është e rastit se në protestat e organizuara anekënd Kosovës, por edhe në diasporën shqiptare, në përkrahje të luftës çlirimtare të zhvilluar në Drenicë, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, parulla më e shpeshtë e më domethënëse ishte **“Krejt Kosova UÇK”**.

Një shembull të këtillë të luftës e qëndresës heroike, luftëtarët e lirisë e dhanë edhe në kundërpërgjigje të sulmit të forcave të shumta ushtarake-policore e paramilitare serbe, më 24 mars 1998, kur u sulmua familja Haradinaj dhe fshati Gllogjan përgjithësisht. Në këtë betejë, që zgjati më se dhjetë orë, u vranë tre pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, *Gazmend Hysen Mehmetaj* (20), *Himë Rasim Haradinaj* (16) dhe *Agron Nimon Mehmetaj* (19), të tre nga Gllogjani, ndërsa u plagos rëndë edhe vetë komandanti Ramush Haradinaj. Në këtë sulm, forcat serbe, të përbëra nga njësitë policore të MUP-it të Deçanit, të Gjakovës e të Pejës, njësitë paramilitare dhe njësitë ushtarake të Korpusit Ushtarak të Gjakovës, përdorën gjithë makinerinë e

blinduar, arma-timin e rëndë dhe helikopterët. Njësitë ushtarake serbe, shtëpinë e Stojanoviçëve, që gjendej përballë shtëpisë së Hilmi Haradinajt, gjatë këtyre luftimeve e shfrytëzuan si objekt ushtarak, gjë që pohohet edhe në raportet e Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH) të Natasha Kandiqit. Gjatë tërë kohës, i tërë fshati mbahej i rrethuar nga tre rrathë të forcave serbe, të cilat zunë peng rreth 130 nxënës të shkollës fillore “Hasan Prishtina” të Glllogjanit, sikurse edhe 13 banorë të fshatit, të cilët i përdorën si *“mur të gjallë”* për të lëvizur nëpër fshat.* Gjatë betejës u dëmtuan shumë shtëpi të fshatit, ndërsa njëres prej tyre (shtëpisë së Rexhep Haradinajt) forcat serbe ia vunë zjarrin dhe e dogjën me themel. Duhet theksuar se, këtë ditë, banorët e fshatrave Glllogjan, Gramaçel, Irzniq e Dubravë nëpër plumba u detyruan t’i braktisin fshatrat e tyre. U kthyen vetëm pasi këto fshatra i mori nën kontroll Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Në betejën e zhvilluar në Glllogjan, organet serbe zyrtarisht pranojnë se është vlarë polici **Miodrag Otović** (1962) nga Peja, pjesëtar i MUP-it serb prej vitit 1990, ndërsa janë plagosur policët: Sinisha Vidiq, Slllobodan Jokić, Rajko Rajković, Filip Raiçević, Vlladica Radosav-leviq, Miroslav

* Emrat e glllogjanasve të zënë peng: Smajl Nimanaj, Shaban Zeqiraj, Besim Haradinaj, Rifat Haradinaj, Beqir Haradinaj, Mehmet Bajramaj, Mustafë Ramaj, Imer Dervishaj, Shemsedin Haradinaj, Lan Halilaj, Bege Haradinaj, Atifete Haradinaj dhe Zenel Dobraj nga Gramaçeli. Të njëjtën ditë ishte arrestuar nga policia serbe edhe veprimtari Rasim Selmanaj.

Vuliq, Nikolla Stefanov dhe Millan Jeftiq, të gjithë policë të MUP-it të Deçanit.¹⁵

Duke parë përqendrimin dhe përgatitjet e forcave serbe për ndërmarrjen e sulmeve të organizuara kundër fshatrave të rajonit të Rrafshit të Dukagjinit, me theks të veçantë të fshatrave të komunës së Deçanit, të komunës së Gjakovës, veçanërisht kundër pjesës së brezit kufitar dhe të Dushkajës, dhe duke patur shembull se vetëm ku hasin në rezistencë, ato tërhiqen pa bërë masakra në popullsinë civile, pasoi mobilizimi i përgjithshëm në rajonin e Dukagjinit. Pozicionet e luftës brenda një kohe të shkurtër nga Glllogjani patën një shtrirje të gjërë.

Fillimisht, më 12 prill 1998, ushtria jugosllave përqendroi sistemin raketor dhe topat e kalibrave të mëdhenj në Shtëpinë e Shëndetit në Deçan, përkatësisht në Podin e Gështenjave (ku tash gjendet kazerma e Brigadës 334 “Agron Rama” të TMK-së); aktivizoi bazat ushtarake në Hulaj, në Zagermë të Pejës, në Tamnik të Gjakovës. Njëkohësisht tek Diga e Pendës së Liqenit të Radoniqit u stacionuan forcat e ushtrisë dhe të policisë serbe, ku i vendosën sistemet raketore dhe topat e kalibrave të mëdhenj, duke paraqitur rrezik permanent dhe duke kërcënuar vazhdimisht se në rast sulmi të UÇK-së, do ta shpërthenin Digën e do të përmblynin fshatra të tëra.

¹⁵ Shih librin *Zloçini albanskih terorista (1995-1998)*, (*Krimet e terroristëve shqiptarë (1995-1998)*), botim i “Jedinstvo”-s, Prishtinë, janar 1999, f. 144-145; adresën e MUP-it serb në internet: <http://www.mup.sr.gov.yu>.

Prej këtyre pozicioneve, në ditët që pasuan granatoheshin pothuajse të gjitha fshatrat e komunës së Gjakovës, të Deçanit, të Pejës, etj. S'do mend se organet zyrtare serbe, të gjitha humbjet e tyre në njerëz, përkatësisht në policë, ushtarë e paramilitarë serbë, kanë tentuar t'i paraqesin si viktima të "sulmeve terroriste" të UÇK-së, me gjithë faktin e pamohueshëm e të njohur botërisht se të gjithë ata janë vrarë në vijat e frontit gjatë ofensivave serbe të ndërmarra për ndëshkimin e zonave të përfshira në luftime.

Mbase për shkak të pozitës së rëndësishme strategjike, të afërsisë së kufirit me Shqipërinë, për të penguar depërtimin e armatimit edhe në zonat tjera të luftimeve në Kosovë, përqendrimi i forcave serbe në këtë rajon ishte tejet i madh dhe ofensivat serbe nuk u ndalën asnjëherë.

Pa dyshim, vija e frontit në fshatin Prejlep të Deçanit, ishte njëra ndër pozicionet më të pathyeshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila asnjëherë gjatë luftës nuk u thye nga forcat armike, edhe pse sulmet ndaj këtyre pikave ishin të përditshme. Prejlepasit, duke e parë të vetmin shpëtim tek armët e lirisë, pa asnjë hezitim që në fillim të muajit prill '98, njëzëri iu përgjigjën kushtrimit të luftës për liri. Më 20 prill 1998, rreth shtatëdhjetë (70) prejlepas nisen drejt Shqipërisë për të marrë armë. Mirëpo në të kthyer për në Kosovë, më 27 prill, në vendin e quajtur "Sergun", jo larg Vokshit, bien në pritën e forcave ushtarako-policore serbe, ku për më se gjashtë orë radhazi zhvillohen luftime të rrepta. Në këto luftime tepër të rrepta e të pabarabarta

bien dëshmorë **Sadri Azem Latifaj** (35) bashkë me **Haxhi Mustafë Tolaj** (38) dhe **Edmond Hysni Dabiçaj** (21). Në anën tjetër, burimet serbe lajmëruan për tre ushtarë serbë të vrarë dhe disa të plagosur. Këtë ditë u granatuan pandërprerë fshatrat Voksh dhe Hulaj. Në Sergun të Vokshit u zunë rob nga forcat serbe Fadil Dabiçaj, Hysen Latifaj, Bedri Kukalaj dhe Armend Mazrekaj të cilët u dënuan me dënime drakonike prej 8-17 vjet burgim, dhe përjetuan ferrin nëpër kazamatet serbe që nga Nishi, Dubrava, Burgu Qendror (CZ) i Beogradit, Mitrovica e Sremit e gjetiu ku u torturuan çnjerëzisht edhe nga mjekët, për t'u liruar në muajin mars 2002, të dërrmuar nga torturat.

Derisa në fshatin Prejlep, më 29 prill, po bëhej varrimi i tre dëshmorëve, forca të shumta policore që qarkullonin përgjatë rrugës magjistrale Deçan – Gjakovë në fshatin Prejlep, qëllojnë me armë zjarri në drejtim të masës. Ndërkaq, akti më barbar i kësaj dite është vrasja e **Bilall (Idriz) Mazrekajt** (26) nga Drenoci. Atë policia serbe pasi e zbriti nga traktori kur po kthehej nga varrimi i kushe-rinjve të Prejlepit, te rruga që shpie për në Drenoc, e ekzekutoi para syve të nënës së tij dhe mbi pesëmbëdhjetë grave të tjera. Këtë vrasje të tmerrshme e transmetuan po-thuajse të gjitha stacionet televizive evropiane e botërore.

Pas këtyre ngjarjeve tronditëse, edhe pse luftëtarët prejlepas u goditën që në hapat e parë të luftës, në këtë fshat caktohen pozicionet mbrojtëse. Dhe, në këtë vijë të

frontit asnjëherë gjatë luftës nuk do të shënohen thyerje të vijës së frontit as depërtim i forcave serbe, edhe pse ishte ndër më të rrahurat nga sulmet e përditshme të policisë, ushtrisë e paramilitarëve serbë, si fshat bri rrugës magjistrale Deçan – Gjakovë. Forcat serbe i rrënuan me buldozherë të gjitha shtëpitë dhe muret rrethuese të lagjes Dabiçaj përgjatë magjistrals.

Pas sulmeve të ndërmarra kundër fshatrave Baballoç e Gramaçel, më 21 prill 1998, luftimeve të zhvilluara në Smolicë, Punashec, Morinë etj., luftimeve të zhvilluara në Sukë të Cermjanit, ku operacioni luftarak drejtohej nga forcat e ushtrisë jugosllave (UJ), më 22 maj 1998, fillojnë edhe sulmet frontale kundër vijës së frontit në Prejlep e Rastavicë, për t'u zgjeruar pastaj edhe në Carrabreg dhe në vetë qytezën e Deçanit, gjithnjë përgjatë rrugës magjistrale deri në Raushiq e Loxhë të Pejës. Prandaj, këso kohe nuk është i rastit as konstatimi i ambasadorit Hill, kur pas vizitës që ia bëri komunës së Deçanit në qershor të vitit 1998, deklaroi: *“Deçani është shkatërruar me armatim të rëndë dhe është djegur deri në themele”*.

SULME TË PANDËRPRERA, GODITJE EDHE ME RAKETA “LUNA”

Prej datës 22 deri më 26 maj 1998 forcat serbe ndërmarrin një sulm të gjerë përgjatë magjistrals Deçan - Gjakovë, kundër fshatrave Prejlep e Rastavicë, për të depërtuar në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja, me ç'rast në Prejlep, më 24 maj sulmojnë edhe njësitë e ushtrisë serbe, por nuk mundën t'ia arrijnë qëllimit. Duhet theksuar se forcat serbe gjatë ofensivave kundër Prejlepit shpesh janë maskuar edhe me uniforma me amblema të UÇK-së, mbase duke e patur parasysh se në këtë vijë të frontit luftimet zhvilloheshin në afërsi. Sërish më 3 qershor, forcat serbe fillojnë sulmin për të depërtuar në Prejlep nga drejtimi i shkollës fillore që gjendet në fillim të fshatit, me ç'rast luftime të rrepta zhvillohen mbi fshatin Prejlep, tek Ura e Bajramhasanëve në magjistralen Deçan – Gjakovë. Aty, gjatë luftimeve, bien dëshmorë tre luftëtarë të UÇK-së: *Rexhep Musë Mazrekaj* (39), *Selmon Tahir Dukaj* (37) dhe *Ahmet Ismet Baqaj* (32) të tre nga Drenoci, trupat e të cilëve mbetën mbi dhe në vendin e vrasjes deri në fundshtatorin e atij viti.

Ndërsa më 5 qershor 1998, Prejlepi dhe Rastavica sulmohen edhe me aeroplanë luftarakë. Forcat serbe në Prejlep, fillimisht sulmuan me mjete të blinduara që hynë tek Ura e Bajramhasanëve (nga drejtimi i Deçanit) dhe tek

“24 Gurët” (nga drejtimi i Gjakovës) si dhe me forca të shumta të këmbësorisë. Ndërsa rreth orës 13, Prejlepi u bombardua njëkohësisht nga katër aeroplanë luftarakë. Sulmi zgjati gjatë tërë ditës. Njësitë e UÇK-së bënë një qëndresë vërtet heroike, ku u shkatërruan edhe tri blindat. Në këto luftime vriten pjesëtarët e UÇK-së, **Jeton Zeqir Dabiqaj** (23) e **Beqir Haxhë Qufaj** (21) ndërsa në luftimet e zhvilluara dy ditë më vonë bie dëshmor edhe **Gazmend Selmon Lokaj** (23), nga Prejlepi.

Nga magjistralia Deçan – Gjakovë, prej vendit të njohur me emrin Bunari i Fushës (mes fshatrave Carrabreg e Prejlep), në mbrëmjen e 11 qershorit '98, ushtria serbe, për herë të parë që nga fillimi i luftës në Kosovë, lansoi katër (4) raketa tokë-tokë të prodhimit rus të tipit “Luna”. Flaka e motorëve të raketave u pa në gjithë pjesën Perëndimore të Kosovës. Raketat goditën fshatrat Glllogjan dhe Irzniq.

Në vijën e frontit në Prejlep luftimet nuk u ndalën asnjëherë. Këtu duhet përmendur edhe konfrontimin e rreptë me këmbësorinë serbe e cila sulmoi në orët e hershme të 28 qershorit 1998. Në këto luftime, organet e MUP-it serb të Deçanit, pranojnë se është vrarë polici **Pero Tintor** (1971) nga Senti, pjesëtar i MUP-it të Kikindës. Ndërsa më 10 korrik '98, në luftimet e zhvilluara në Prejlep vritet polici i MUP-it të Pançevës, **Petar Rajković** (1976). Edhe gjatë ofensivës më të rreptë të forcave serbe të ndërmarrë gjatë muajit gusht '98, kundër të gjitha pozicioneve të luftës në rajonin e Dukagjinit, Prejlepi qëndroi i

palëkundur. Edhe përkundër përdorimit të makinerisë së rëndë luftarake dhe forcave të shumta të këmbësorisë, forcat serbe nuk mundën të thyejnë rezistencën. Kështu, më 2 gusht 1998, në orët e hershme të mëngjesit këmbësoria dhe mjetet e blinduara serbe u përpoqën të depërtojnë në fshatrat Rastavicë e Prejlep, ku bie në vijën e parë të frontit në Rastavicë, dëshmori **Rexhep Brahim Kadrijaj** (24), nga Rastavica. Forcat tona i pritën me zjarr njësitë serbe dhe i zbrapsën rreth mesditës. Me këtë rast, sipas raporteve zyrtare serbe, janë vrarë policët: **Nenad Bellosheviq** (1973) nga Cirkolezi, **Elvis Shunjeviq** (1969) nga Rijeka, **Miomir Stojanović** (1955) nga Peja dhe **Damjan Jovanović** nga Peja, të gjithë pjesëtarë të MUP-it serb të Pejës. Ndërsa janë plagosur policët e MUP-it të Pejës: Lubisha Maksimović, Nebojsa Pavićević, Zoran Tmushiq, Petko Milićević, Mladen Martinović, Dragolub Vukićević dhe policët e MUP-it të Deçanit: Milko Nikoliq e Marko Radovanović si dhe Gjorgje Karan, polic i MUP-it të Beogradit.

Edhe përkundër dështimit të sulmit të datës 2 gusht, forcat serbe sërish më 9 gusht sulmojnë vijën e frontit Prejlep – Carrabreg. Këtë ditë, sipas burimeve serbe, në luftimet e zhvilluara në Prejlep, vritet polici **Zdravomir Bukiliq** (1970) nga Kollashini, polic i MUP-it të Deçanit ndërsa plagoset polici Radulle Sedllareviq. Të njëjtën ditë në luftimet e zhvilluara po në Prejlep vriten policët: **Zoran Gjokić** (1970), **Srgjan Drashković** (1967) dhe **Bojan Kocić**

(1975), policë të MUP-it serb të Leskovcit.¹⁶ – Ndërkaq nga ana e UÇK-së, më 9 gusht, në vijën e parë të frontit në Carrabreg bie dëshmor eprori **Sokol Muzli Sejfi** (28), nga Gllgjani. Më 11 gusht '98, në luftimet e zhvilluara në këtë vijë të frontit, në Gerdaja (mes fshatrave Prejlep e Carrabreg) bien luftëtarët e UÇK-së, **Maxhun Malë Çekaj** (57), komandant i shtabit lokal të UÇK-së së fshatit Irznik, **Gëzim Shaban Dervishaj** (19) dhe **Naser Muzli Idrizaj** (31). Në Gerdaja, më 2 shtator 1998, vritet nga forcat serbe edhe pjesëtari i UÇK-së, **Kadri Selim Latifaj** (1977), nga Prejlepi, trupi i të cilit u gjet pas një muaji.

Ndërkaq, më 20 nëntor 1998, në Prejlep, gjatë konfrontimit të forcave policore serbe me një njësi të UÇK-së vriten policët: **Zoran Vrbashki** (1973) nga Verbasi, pjesëtar i MUP-it serb të Suboticës; **Janosh Çizmadia** (1953), polic i MUP-it të Novi Sadit, **Igor Vus** (1973) dhe **Çaba Padkaji**, policë të MUP-it serb të Kikindës.

Në pranverën e vitit 1998, Kosova *de facto* ishte territor i pushtuar nga Serbia dhe po përballej me terrorin e gjenocidin më të egër që po ushtrohej nga të gjitha segmentet e shtetit serb. Edhe sekretarja amerikane e Shtetit, zonja Medlin Ollbrajt, më 2 prill 1998, në Uashington, deklaroi se *Kosova është një territor i pushtuar*.

Këso kohe numri më i madh i forcave serbe u koncentrua në rajonin e Dukagjinit, për ndërmarrjen e operacioneve të pandërprera luftarake, me qëllim që ta shuajnë çdo

¹⁶ Libri *Zloçini...*, i cit. më lartë, f. 160; adresën <http://www.mup.sr.gov.yu>, e cit. më lartë.

shkëndijë rezistence por edhe ta pengojnë depërtimin e armatimit nga Shqipëria. Sepse kështu do t'i jipej goditje rezistencës shqiptare në mbarë Kosovën. Me theks të veçantë, operacionet ndëshkuese ishin të drejtuara kundër popullatës civile, për ta vrarë e masakruar dhe dëbuar nga trojet e veta. Aty ku mundën të depërtojnë, forcat serbe vranë e masakruan mizorisht. Këso kohe, në këtë anë, rasti më i rëndë ishte masakra e kryer në Lybeniq të Pejës. Lidhur me këtë rast, në raportet serbe thuhet se rreth orës 8, të datës 25 maj 1998, në rrugën magjistrale Deçan – Pejë, në afërsi të Lybeniqit, është sulmuar me armë zjarri vetura “Golf” që po udhëtonte në drejtim të Deçanit, me ç’rast janë plagosur **Momçilo Antiq**, pjesëtar rezerv i MUP-it të Deçanit, **Slobodan Vukoviq**, punëtor i “Elektro-Kosovës” dhe **Dimitrije Radoviq**, pensionist.¹⁷ Mirëpo, siç u dëshmua më vonë, ky “sulm” nuk ishte asgjë tjetër pos një improvizim, të cilin policia serbe e shfrytëzoi si pretekst për masakër, të cilën e përsëriti sërish në prill të vitit 1999.

¹⁷ Shih *Zloçini...*, vep. e cit. më lartë, f. 42.

MASAKRAT E TMERRSHME NË LYBENIQ

Më 25 maj 1998, që nga ora 9.30 deri në orët e mbrëmjes fshati Lybeniq u rrethua nga forca të mëdha policore. Këto forca policore gjatë kohës së këtij rrethimi me armë nga më të ndryshmet granatuan fshatin Lybeniq, vranë e masakruan, dogjën shumë shtëpi, të cilat edhe u plaçkitën deri në imtësira, edhe pse askush prej banorëve të këtij fshati nuk kishte qëlluar veturën e lartëpërmendur dhe asnjë banor shqiptar i këtij fshati nuk ishte i armatosur.¹⁸ Ngjarja ndodhi rreth orës 13.40 minuta. Së pari filluan të shtiejnë me topa të kalibrave të ndryshëm prej rrugës kryesore dhe nga Suka e Zabllaçit me të cilat goditnin përmbi fshat, e pastaj edhe brenda në fshat. Një numër banorësh që gjendeshin afër xhamisë u strehuan nëpër shtëpi dhe bodrume ngase nuk kishin kurrfarë armësh e as mjete të tjera për rezistencë. Pas gjuajtjeve të shumta nga armët e rënda, ekspedita e policisë serbe hyn në fshat.¹⁹ Në oborret e shtëpive të tyre vrasin e masa-krojnë: *Zeqë Hamzajn* (1930), *Brahim Hamzajn* (1934), *Dervish Hamzajn* (1947), *Ymer Hamzajn* (1945), *Gani Hamzajn* (1973), *Rifat Hamzajn* (1974), *Bashkim Hamzajn* (1975), *Hysen Alimehaj* (1958) dhe mysafirin e familjes Huskaj, *Haxhi*

¹⁸ KMDLNJ – Pejë, *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb mbi popullatën shqiptare në regjionin e Pejës gjatë vitit 1998*, (dorëshkrim), f. 27-28.

¹⁹ KMDLNJ – Pejë, *Kronikë e dhunës...*, vep. e cit. më lartë, f. 28.

Gogajn (1976) nga Deçani, dhe i plagosin Nezir Sali Jahmuratajn (40), Lulzim Ymer Hamzajn (23) dhe Ardeshtik Mehmet Gogajn (24) nga Deçani. Ndërkaq, më 29 maj 1998, policia serbe vrau *Mehmet Ukë Ukshinajn* (1926) dhe ia dogji kufomën. Eshtrat e djegura i janë gjetur në tetor të vitit 1998, 50 metra larg shtëpisë, kurse kafka 10 metra më larg. Më 5 qershor në këtë fshat është gjetur edhe kufoma e *Ramë Isuf Haradinajt* (1928), i cili ka qenë i paralizuar dhe kishte mbetur në shtëpi në momentin e dëbimit të familjarëve të tjerë. Më 15 gusht 1998, forcat policore serbe e kanë vrarë *Dervish Metë Aliçkajn* (1919) derisa po ruante bagëtinë.²⁰

Ndërkaq, më 1 prill 1999, qysh në orën 7 të mëngjesit forca të mëdha ushtarake, policore e paramilitare serbe e sulmojnë sërish fshatin Lybeniq dhe gjatë tërë kohës së aksionit nuk pushojnë të shtënat dhe mitralimi i fshatit. Breshëritë nga llojet e ndryshme të armëve derdhen rreth e përqark fshatit, por edhe nëpër rrugë e oborre të shtëpive. Pas vënies së fshatit nën rrethim të plotë dhe rrugëve të tij nën kontroll të rreptë, grupe të armatosura e me uniforma të ndryshme, me sjelljet dhe veprimet e tyre më brutale, duke i rrahur mizorisht njerëzit e pambrojtur, duke i plaçkitur e duke i kërcënuar me vrasje, i detyrojnë familjet: burra, gra e fëmijë, që menjëherë t'i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të tubohen në qendër të fshatit. Gjatë dëbimit me

²⁰ Qendra Rajonale e KMDLNJ-së - Pejë, *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës (mars-qershor 1999)*, Pejë, 2002, f. 41.

dhunë nga shtëpitë e tyre dhe gjatë shkuarjes së detyrueshme drejt qendrës së fshatit, grupet e armato-sura dhe të uniformuara me uniforma të ndryshme që tregojnë përkatësinë e formacioneve militare e paramilitare serbe, shtien me breshëri armësh para këmbëve të kolonës së të dëbuarve, ose përmbi kokat e tyre, në mënyrë që t'i zbatojnë shpejt dhe me përpikëri urdhërat e tyre. Rrahjet brutale, fyerjet, provokimet e kërcënimeve që u bëhen njerëzve, nuk pushojnë që nga momentet e para të dëbimit të familjeve nga shtëpitë e tyre e deri në kryerjen e njërit nga aksionet më monstruoze në këtë anë. Nga rrahja brutale që i bëhet, Riza Shabanajt, i cili, që nga momenti i rrahjes së rëndë ka mbetur i palëvizshëm, tmerrohen të gjithë ata që ishin të pranishëm. Gjatë aksionit të dëbimit të familjeve nga shtëpitë dhe gjatë tubimit të tyre në qendër të fshatit, aksion ky që përcillet me gjendje ankthi e tmerri të paparë, për shkak të përdorimit të metodave më brutale, fillon seleksionimi dhe veçimi i të gjithë atyre që pas pak do të ekzekutohen me breshëri armësh, kurse gratë, pleqtë dhe fëmijët urdhërohen të shkojnë drejt rrugës kryesore për t'u deportuar në Shqipëri.²¹

Numri i përgjithshëm i të ndaluarve, sipas të dhënave të KMDLNJ-së, arrinte në rreth 80 persona. Në pyetjen provokuese të njërit nga vrasësit se kush i ka djegur disa shtëpi të fshatit një vit më parë, përgjigjet *Adem Haradinaj* (1932)

²¹ Qendra Rajonale e KMDLNJ-së - Pejë, *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 41-45.

dhe u thotë se ato shtëpi i ka djegur policia serbe gjatë vitit 1998. Menjëherë pas kësaj përgjigje policët e nxjerrin nga turma e njerëzve dhe para syve të tyre e ekzekutojnë me breshëri pushkomitralozi. Menjëherë pas tij, në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtin pretekst nxirret nga turma e njerëzve dhe para syve të tyre me breshëri pushkomitralozi ekzekutohet **Ukë Bushati** (1923). Pas këtyre dy ekzekutimeve pason një heshtje e shkurtër dhe e akullt mortore dhe një shkëmbim bisede përmes "*toki-vokit*" në mes të njërit nga të informuarit dhe eprorit të tyre që, sipas konfirmimit të atyre që mbijetuan vdekjen, qëndronte me forca të shumta të motorizuara në rrugën Pejë - Gjakovë. Pas asaj bisede të shkurtër midis tyre, mbi masën e njerëzve të tubuar zbrazen breshëri automatikësh dhe pushkomitralozësh. Pjesa dërmuese e njerëzve të tubuar vriten, por edhe të plagosurit shtihen si të vvarë. Vrasësit, duke dashur që të mos lënë dëshmitarë të gjallë, zbrazin breshëri armësh mbi të gjithë ata që me lëvizjet apo klithmat e tyre kanë dhënë shenja jete. Me këtë rast janë vvarë: *Bajram Alimehaj* (68), *Shaban Alimehaj* (66), *Fadil Alimehaj* (56), *Rrustem Alimehaj* (49), *Hazir Alimehaj* (42), *Shaban Alimehaj* (41), *Haxhi Alimehaj* (52), *Osman Alimehaj* (37), *Bekë Bobi* (57), *Zeqë Bobi* (30), *Haradin Huskaj* (65), *Osman Huskaj* (34), *Tafil Huskaj* (18), *Nekë Huskaj* (59), *Smajl Huskaj* (84), *Metush Huskaj* (72), *Naim Huskaj* (42), *Haxhi Huskaj* (38), *Ramë Huskaj* (64), *Fehim Huskaj* (18), *Gëzim Avdullahaj* (15), *Ramë Avdullahaj* (35),

Ruzhdi Ukshinaj (34), *Fazli Ukshinaj* (29), *Ramë Ukshinaj* (52), *Hajdar Ukshinaj* (51), *Qamil Ukshinaj* (33), *Shyhrete Ukshinaj* (33), *Muhamet Ukshinaj* (2), *Riza Morina* (31), *Çun Morina* (30), *Adem Bushati* (67), *Smajl Bushati* (62), *Bajram Bushati* (37), *Jashar Hamzaj* (64), *Xhavit Hamzaj* (24), *Selim Jahmurataj* (69), *Smajl Jahmurataj* (34), *Kadri Jahmurataj* (87), *Salih Rrustemaj* (42), *Nazmi Rrustemaj* (37), *Sefer Shoshi* (61), *Gani Shoshi* (23), *Ali Shoshi* (75), *Ramiz Berisha* (29), *Rexhep Rexhaj* (29), *Ilir Lokaj* (43), të gjithë nga Lybeniqi, si dhe *Selim Aliçkaj* (87) nga fshati Irznik, *Arif Tahiraj* (24) nga fshati Carra-breg, *Selaim Sylaj* (39) nga fshati Glllogjan, *Haxhi Cacaj* (88) nga Deçani, *Zize Cacaj* (79) nga Deçani, *Rrustem Ukaj* (62) nga Strellci.* Me qëllim të mbulimit të gjurmëve të krimit, vrasësit i kanë marrë dhe i kanë zhdukur trupat e 50 viktimave, ndërkaq, kufomat e 14 viktimave të tjera janë gjetur në varrezat e qytetit, janë ekzaminuar gjatë muajit shtator 1999 dhe janë rivarrosur në varrezat e fshatit Lybeniq.²² Të njëjtën ditë, pra më 1 prill 1999, në bjeshkën e Lybeniqit, nga këto forca serbe janë vrarë edhe *Hate Alimehaj* (72), *Ferdane Alimehaj* (33), *Leonard Alimehaj* (6), *Hatmane Alimehaj* (43) dhe *Fatmir Alimehaj* (18).²³

* Ndërkaq, janë plagosur: Demush Ukshinaj (64), Besim Huskaj (43), Jusuf Avdullahaj (19), Shaban Jahmurataj (83), Gani Bushati (57), Sadik Jahmurataj (47), Sadik Berisha (64), Maxhun Alimehaj (47), Shefqet Bobi (37), Xhevdet Aliçkaj (37), Ibër Bushati (40) dhe Vjollca Shala (25). (Shih: *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 41-45).

²² Po aty.

²³ Po aty.

Duhet vënë në dukje se bashkëfshatarët e tyre serbë e malazezë, gjatë tërë kohës, kanë qenë shumë aktivë dhe kanë bashkëvepruar ngushtë me forcat ushtarake, policore e paramilitare. Që nga fillimi kanë qenë të armatosur dhe veprimet e tyre kundër bashkëfshatarëve shqiptarë ishin tërësisht të hapta.²⁴ Masakrat në Lybeniq, të kryera nga bashkëfshatarët e tyre serbomalazezë, janë përsëritur historikisht që nga fillimi i shekullit të kaluar.

Më 4 prill 1999, një grup i të dëbuarve me dhunë nga fshati Buçan i Pejës vendosin që të mos i bashkohen kolonës që deportohej për në Shqipëri por të nisen drejt Bjeshkëve të Lybeniqit. Më 8 prill, forcat serbe e vrasin *Agron Gashin* (17).

Pas mbarimit të luftës, një grup fshatarësh të Buçanit nisen drejt atyre bjeshkëve për të hulumtuar bashkëfshatarët e tyre, për fatin e të cilëve nuk dihej. Ata në bjeshkën e Lybeniqit e gjejnë kufomën e *Kapllan Gashit* (63) të cilën e kanë identifikuar në bazë të rrobave dhe të pasaportës. Kufoma ka qenë me kokë të prerë dhe me dy vrima nga predhat. Ndërsa tek vendi i quajtur "*Ujëvara e Lybeniqit*" në një grykë të thellë, gjejnë edhe kufomat e *Shaqir Gashit* (55), *Nexhat Gashit* (25), *Musa Gashit* (23), *Riza Gashit* (20), *Murat Gashit* (67), *Arif Gashit* (13), *Rrustem Gashit* (61), *Xhavit Gashit* (41), të gjithë nga fshati

²⁴ Po aty.

Buçan, mandej të *Hysen Ademajt*, nga fshati Loxhë, si dhe të *Qamil Ukshinajt* (33) nga fshati Lybeniq.

Sipas dëshmitarëve të gjallë, para ekzekutimit këta njerëz janë vërejtur dhe vëzhguar nga helikopteri i ushtrisë jugosllave. Forcat e ushtrisë jugosllave, i kanë rrethuar në Bjeshkën e Lybeniqit, ku ishin të përqendruara formacio-net e Armatës së Tretë Serbe. Pas vrasjes dhe masakrimit i kanë hedhur në humnerën e “*Ujëvarës së Lybeniqit*”.²⁵ Po ashtu në bjeshkën e Lybeniqit që nga data 7 prill 1999 janë zhdukur pa gjurmë: *Selim Shala, Valdet Shala, Demë Shala, Kushtrim Shala, Abedin Shala, Sejdi Shala, Jeton Shala, Januz Bezeraaj, Muhamet Bezeraaj, Hazir Bezeraaj, Nazmi Shala, Servete Gjocaj, Sylë Gjocaj, Lulëzim Gjocaj, Nazmi Gjocaj, Arben Gjocaj, Agim Gjocaj dhe Deli Bricori*, të gjithë nga fshati Rashiq i Pejës.²⁶ Në fshatin Lybeniq, pas luftës janë gjetur edhe kufomat e 5 personave të vrarë gjatë muajve prill e maj 1999, që nuk janë identifikuar.²⁷

²⁵ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 41-45.

²⁶ Po aty, f. 41-45.

²⁷ Po aty, f. 41-45.

SERBIA NUK ZGJODHI MJETE PËR TË ARRITUR QËLLIMET E VETA

Gjatë ofensivës masive të forcave serbe të ndërmarrë në rajonin e Dukagjinit, në gushtin e vitit 1998, burimet e MUP-it serb bëjnë të ditur se janë vrarë edhe këta policë: **Zhelko Bozhiq** (1952), Vishegrad, i vrarë më 2 gusht 1998 në Jabllanicë të Gjakovës. – Duhet vënë në dukje se ditën e sulmit të forcave serbe mbi Jabllanicë (tash Shqiponjë), më 2 gusht 1998, janë vrarë pjesëtarët e UÇK-së: **Idriz Bajram Gucati** (1952) nga Polaci dhe **Azë Zekë Brahimaj** (1921), nga Jabllanica, e cila më pas është masakruar e prerë copë-copë me thika bashkë me të ëmën, 95-vjeçare.* Ndërkaq të njëjtën ditë në luftime në Cermjan është vrarë dëshmori **Jeton Idriz Hoxha** (1973), nga Cermjani; **Branko Gjuriçiq** (1969) nga Grabanica, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1990, i vrarë më 2 gusht 1998 në Grabanicë të Klinës; **Nebojsa Saviq** (1967) nga Manjaku, komuna Vladiçin Han, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993, i vrarë më 5 gusht 1998 në Rakovinë; **Miroslav Petroviq** (1964), polic i MUP-it të Prishtinës, i vrarë më 9 gusht 1998 në luftimet e zhvilluara tek Suka e Bitesheve; **Zoran Jovanović** (1973), Lebanë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994, i vrarë më 10

* Të dyja, më 3 gusht 1998, janë varrosur në një varr të përbashkët në Jabllanicë.

gusht 1998 në fshatin Bitesh, komuna e Gjakovës. – Më 10 gusht 1998, në luftimet e zhvilluara në këtë vijë të frontit (në Shaptej) kanë rënë dëshmorë luftëtarët e UÇK-së: **Jusuf Skënder Kelmendi** (1975) nga Peja dhe **Arben Tahir Hajdaraj** (1976) nga Shapteji.

Pjesëtari i MUP-it të Serbisë prej vitit 1997, **Branisllav Nikoliq** (1974), është vrarë më 11 gusht 1998 në rrethinën e Pejës; **Zoran Aniçiq** (1970), Prijepolje, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994, i vrarë më 16 gusht 1998 në afërsi të fshatit Lybeniq të Pejës. Në luftimet e zhvilluara në Voksh të Deçanit, më 15 gusht 1998, janë vrarë major **Millorad Ragjenoviq** (1962), pjesëtar i MUP-it të Verbasit, **Zdravko Miskin** (1957) oficer i MUP-it të Novi Sadit, kapiten **Dragolub Shukoviq** (1960) nga Kovina, pjesëtar i MUP-it të Pançevës dhe oficeri **Gojko Vojinoviq** (1958) nga Krushçiq, pjesëtar i MUP-it të Vrbasit; **Zenun Gashi** (1957) nga fshati Kosuriq i Pejës, oficer i stacionit të policisë së Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Serbisë në Pejë, prej 10 majit të vitit 1982 pjesëtar i MUP-it të Serbisë, i vrarë në luftime gjatë ofensivës serbe në muajin gusht 1998.

Në luftimet e zhvilluara në Loxhë, më 6 korrik 1998, janë vrarë pjesëtarët e MUP-it serb: **Srgjan Peroviq** (1962) nga Peja, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1981, **Mirko Radunoviq** (1962) nga Dashinoci i Deçanit, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1981, **Dejan Preleviq** (1974) nga Kovraga e Istogut, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994 dhe **Millorad Rajkoviq** (1957) nga Broliqi i Pejës,

pjesëtar rezervë i MUP-it të Serbisë prej vitit 1985 dhe janë plagosur nëntë të tjerë.²⁸ Ndërkaq, **Goran Petrovq** (1968), nga Beogradi, pjesëtar i Brigadës Speciale të Policisë prej vitit 1995, është vrarë më 15 gusht 1998 në luftimet e zhvilluara në Loxhë të Pejës.

Dihet mirëfilli se gjatë verës së vitit 1998, forcat serbe fshatin Loxhë të Pejës, e plaçkitën dhe e shkatërruan tërësisht deri në themele. Pa përmendur viktimat civile, nga ana e UÇK-së, në Loxhë kanë rënë dëshmorë: **Tahir (Sali) Shala** (1965) i rënë më 5 korrik 1998, eprori **Rrustem Beqir Bruçi** (1958), nga Isniqi, eprori **Lumni Musë Surdulli** (1969), nga Vushtrria, **Enver Tahir Alaj** (1975) nga Drenoci, **Xhavit Tahir Qufaj** (1969) nga Peja, të vrarë më 6 korrik 1998, **Rexhë Haxhi Morina** (1962), dhe **Selman Zhujë Morina** (1940), të dy nga Loxha, janë vrarë më 11 korrik 1998. Më 15 gusht '98, forcat serbe, prej orës 5.45 të mëngjesit deri në orën 6, Loxhën e bombarduan njëkohësisht me katër aeroplanë ushtarakë të tipit jugosllav "Orao" dhe me gjashtë helikopterë ushtarakë. Menjëherë më pas, nga shumë drejtime kanë vazhduar granatimet me artileri të rëndë, me tanke e blindat,* duke e mbajtur fshatin nën zjarr të pandërprerë

²⁸ Shih *Zloçini albanski...*, vep. e cit. më lartë, f. 55, 156; adresa në internet <http://www.mup.sr.gov.yu>.

* Është gjuajtur nga Bello Poja e Zagërma, nga lagjja Dardania e Pejës, nga Gorozhdeci dhe nga Podi i Gështenjave në Deçan. (KMDLNJ - Pejë, *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 43).

të artillerisë e të forcave të këmbësorisë së ushtrisë serbe.²⁹ Pothuajse tërë ditën njësitë e UÇK-së bëjnë rezistencë heroike. Nga ana e UÇK-së bien në fushën e nderit komandanti i vijës së frontit në Loxhë, **Skënder Haxhi Çeku** (1955), nga Çyshku i Pejës, **Ahmet Deli Shala** (1969) dhe **Valon Sokol Shala** (1977) të dy nga Loxha. Të njëjtën ditë në luftimet e zhvilluara në Graboc, vritet **Ahmet Bajram Krasniqi** (1966) nga Peja.

Organet e MUP-it serb pranojnë se në Rrafshin e Dukagjinit gjatë luftimeve janë vrarë edhe policët: **Dragolub Ristiq** (1955), polic i Brigadës së Policisë së Sekretariatit të Beogradit, i vrarë më 10 maj 1998 gjatë sulmit të ndërmarrë kundër vijave të frontit në Baballoç të Deçanit; **Nikola Jovanoviq** (1973), oficer, pjesëtar i MUP-it serb të Shabacit, prej vitit 1993, i vrarë më 24 maj 1998 gjatë sulmit të ndërmarrë kundër pozicioneve të UÇK-së në Baballoç së bashku me shefin e sektorit të kategorisë së I-rë të MUP-it të Shabacit, **Rade Popadiq** (1956). – Në këtë vijë të frontit nga ana e UÇK-së ka rënë dëshmor **Ramiz Sadik Botusha** (1974) nga Baballoçi, i vrarë më 25 maj 1998. **Nexhat Adem Humaj** (1977), nga Baballoçi, i vrarë më 11 gusht 1998 dhe **Zenun Mun Mataj** (1975), i plagosur rëndë në luftimet e zhvilluara në

²⁹ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb mbi popullatën shqiptare në regionin e Pejës*, vep. e cit. më lartë, f. 43.

Baballoç më 11 gusht. Ndërroi jetë më 25 gusht 1998, në Spitalin Ushtarak në Pagarushë.

Polic i serb **Dragolub Gjukiq** (1964) nga Peja, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1987, është vrarë në luftimet e zhvilluara në Strellc të Poshtëm, më 25 maj 1998. Të njëjtën ditë në pengim të depërtimit të forcave serbe në fshat, që kishin depërtuar në disa lagje të fshatit të cilave ua kishin vënë zjarrin, bie dëshmor luftëtari i UÇK-së **Ismet (Hazir) Ukaj** (1976) nga Strellci.

Dragan Bjelanoviq (1973) nga Peja, pjesëtar i MUP-it serb të Pejës prej vitit 1992, i vrarë më 29 maj 1998 në Çallapek gjatë ofensivës ndëshkimore të forcave serbe të ndërmarrë kundër fshatrave Vranoc, Baran e Çallapek të Pejës; **Dushan Urosheviq** (1967) nga Beogradi, pjesëtar i Brigadës Speciale të Policisë, i vrarë më 31 maj 1998 në luftimet e zhvilluara në Deçan; **Zhelko Shijan** (1960) nga Beogradi, pjesëtar i Brigadës Speciale të Policisë së Serbisë prej vitit 1993, i vrarë më 1 qershor 1998 në luftimet e zhvilluara në vijën e përfshirë në luftime Deçan – Carrabreg – Lloçan.

Dihet se forcat ushtarako-policore dhe paramilitare serbe, më 26 maj 1998, sulmuan qytezën e Deçanit, duke përdorur tërë makinerinë luftarake, ku luftëtarët e UÇK-së rezistuan për pesë ditë me radhë. Edhe në Deçan, si kudo tjetër në Kosovë, me theks të veçantë, u sulmua popullsia civile shqiptare. Pjesa më e madhe arritën të evakuhohen në zonat më të thella, ndërsa, fatkeqësisht, një pjesë u zunë

peng dhe u dërguan në Manastirin e Deçanit që nuk shërbente si tempull fetar, por si një kamp përqendrimi dhe komandë e forcave serbe. "Ky, manastir asnjëherë nuk u vu në mbrojtje të shqiptarëve dhe së paku të distancohet nga dhuna, terrori dhe politika gjenocidiale e pushtetit hegjemonist serb. Në fakt, shumë argumente dëshmojnë se para dhe gjatë luftës manastiri i Deçanit ishte çerdhe e forcave komanduese, paramilitarëve, madje edhe vend-strehim i disa kriminelëve. Vetë, disa nga personeli fetar i këtij manastiri, para se të ndodhin disa krime ndaj civilëve shqiptarë, nga dëshmitarët okularë është parë duke ushtruar me armë zjarri (automatikë dhe pistoleta) në vendin e quajtur "Lluga e Mark Gegës". Dhe më pastaj, në afërsi dhe rreth këtij Manastiri, vetëm gjatë majit të vitit 1998, janë vrarë 6 shqiptarë civilë nga komuna e Deçanit. Këto ngjarje, pastaj kanë shkaktuar urrejtje të arsyeshme, ngase aktorët e këtyre krimeve kishin për vendstrehim këtë objekt të "Shenjtërisë serbe". Sipas evidencës së KMDLNJ-së më 5 maj të vitit 1998, pasi që janë mbytur me torturë pleqtë Hajdar H. Kuqi dhe Bekë S. Cacaj nga Deçani, janë gjetur të ngulfatur në ujin e Lumit të Bardhë (ish-Bistrica e Deçanit) që rrjedhë në afërsi të këtij manastiri. Dy ditë më vonë, tek Laura, përkatësisht 200 m larg këtij objekti fetar është vrarë punëtori i hidrocentralit "Kozhnjer", Vehbi Mustafa (61), i cili në atë rast kthehej nga puna. Vrasjet kanë vazhduar në kontinuitet. Të nesërmën është vrarë edhe Haki D. Kamberaj (36) nga fshati Lëbushë. Ndërkaq, më 21 maj 1998, në afërsi të shtëpisë së tyre vriten edhe pleqtë nga Isniqi: Bajram O. Osdautaj dhe Rexhë S. Pajazitaj. Këto janë vetëm disa nga krimet që dëshmojnë

për "rolin fetar" dhe "human" të këtij manastiri dhe "shenjtërisë" së këtushme".³⁰

Në luftimet e zhvilluara në vijën e frontit Deçan - Carrabreg - Lloçan, nga ana e UÇK-së kanë rënë dëshmorë: **Nagip Muharrem Cacaj** (1959), **Brahim Zymer Mushkolaj** (1954), **Isa Lush Kuqi** (1955), **Bajram Rustem Gogaj** (1943), **Valdet Muzli Kuqi** (1969) të gjithë nga Deçani; **Blerim Ahmet Dervishaj** (1974) nga Irzniqi, **Lavdim Rexhep Likaj** (1978), nga Carrabregu, **Adem Zeqë Ukëhaxhaj** (1964), komandant i Shtabit të UÇK-së së fshatit Carrabreg, **Muharrem Rustem Lataj** (1976), **Faik Jahë Ukëhaxhaj** (1963), **Besim Bilall Ukëhaxhaj** (1962), **Tafil Brahimi Kasumaj** (1950), **Shaban Rexhë Kasumaj** (1954). Ndërsa më 13 korrik 1998, në vijën e frontit në Carrabreg kanë rënë dëshmorët **Rexhë Sadik Qorraj** (1961) dhe **Artan Nezir Qorraj** (1980), nga Carrabregu.

Polici serb **Nenad Remishtar** (1969), pjesëtar i MUP-it të Gjakovës, thuhet se është vrarë më 13 qershor 1998 në luftimet e zhvilluara në afërsi të Kpuzit në magjistralen Klinë-Gjakovë; **Dragan Stamenković** (1961) nga Nishi, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993, i vrarë më 14 qershor në luftimet e zhvilluara në Rakovinë; **Sasha Jovanović** (1966) nga Beogradi, pjesëtar i Brigadës Speciale të Policisë prej vitit 1985, i vrarë më 14 qershor 1998 në

³⁰ Letër e hapur e kryetarit të KMDLNJ-së në Deçan, Musa Berisha, drejtuar komandantit të KFOR-it në Kosovë, gjeneralit Skiaker, institucioneve të tjera ndërkombëtare dhe mjeteve të informimit. (Cit. sipas Hysen Ibrës, *UNESCO legalizoi përvetësimin e kishës (manastirit) shqiptare të Deçanit nga Serbia okupatore*, "Fokusi", nr. 72).

luftime të zhvilluara në rrethina të Pejës; pastaj, **Dejan Mihajloviq** (1971) Uzhicë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1992, i vrarë më 11 korrik 1998 në sulmin e ndërmarrë kundër vijës së frontit në fshatin Strellc; **Ivan Erakoviq** (1967), pjesëtar i Brigadës së Policisë nga Beogradi, i vrarë më 12 korrik 1998 gjatë sulmit të ndërmarrë kundër pozicioneve të UÇK-së në Carrabreg të Deçanit; **Bicok Zoltan** (1964) nga Crvenki, komuna Kula, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1983 dhe **Zoran Qeraniq** (1962) nga Peja, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993, të vrarë më 22 korrik 1998 në përleshjen e zhvilluar në paralagjen Dardania të qytetit të Pejës. – Në këtë përleshje, nga ana e UÇK-së kanë rënë dëshmorë **Hysen Ukë Komoni** (1980) nga lagjja Dardania e Pejës, **Demë Avdyll Shala** (1964) nga Graboci i Pejës dhe **Hajdin (Hamid) Vrenezi** (1946) nga Çyshku i Pejës.

Për **Mladen Batançevin** (1956) nga Novi Knezhevci, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993, thuhet se është vrarë më 23 korrik 1998 gjatë sulmit të ndërmarrë kundër pozicioneve të UÇK-së në Rastavicë; **Velibor Stojanoviq** (1974) nga Vranja, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994, i vrarë më 25 korrik 1998 në luftimet e zhvilluara në Junik.

Po më 25 korrik '98, në luftimet e zhvilluara në vijën e frontit Junik – Dobrosh vritet luftëtari i UÇK-së, **Vezir Hysen Ademaj** (1971), nga Sheremeti i Gjakovës. Më 27 korrik, bie luftëtari **Fetah Hasan Krasniqi** (1972), nga

Gjyrgjeviku i Klinës. Më 28 korrik, në Jasiq bien **Mirsat Idrizaj** (1976), nga Lubozhda e Istogut, **Avdyll Jasiqi** (1966), nga Jasiqi, **Arif Gjoci** (1965), nga Gjocjat, **Shkëlzen Gacaferi** (1971), nga Juniku, **Xhevdet Plava** (1959) nga Cermjani, etj. Më 6 gusht në Junik bie dëshmor **Bashkim Avdi Leku** (1972) nga Baica e Glllogocit. Më 10 gusht, në Junik, bien dëshmorë **Bedri Veli Shala** (1969), nga Negrovci, komuna e Glllogocit, komandant i Brigadës 134 të UÇK-së, eprori **Bekim Fazli Berisha** (1967), nga Graboci i Pejës, eprori **Përmet Ilir Vula** (1978), nga Gjakova, eprori **Elton Gëzim Zherka** (1979) nga Gjakova, etj.

Në luftimet e zhvilluara në komunën e Deçanit gjatë vitit 1998, po sipas burimeve serbe, thuhet se janë plagosur policët: Dragan Stojanac, polic i MUP-it të Mitrovicës së Sremit i plagosur më 30 maj 1998 në luftimet e zhvilluara në Strellc të Epërm; më 25 maj 1998, në luftimet e zhvilluara në vijën e frontit në Rastavicë plagoset Milladin Novakoviq, komandant i punktut të MUP-it serb në Junik. – Ndërkaq, më 26 maj, në vijën e parë të frontit në Rastavicë bie dëshmori **Arben Shaqë Qerimaj** (1976) nga Glllogjani dhe plagosen rëndë luftëtarët Shefqet e Agron Mustafaj, po nga Glllogjani.

Polic i Sllavko Tomasheviq, thuhet se është plagosur rëndë në luftimet e zhvilluara në Deçan, më 30 maj 1998. Policët e MUP-it serb të Deçanit Miloje Petroviq, Sllavko Ashanin, Branko Bullatoviq dhe Radule Sedllareviq, janë plagosur në përleshje me njësitë e UÇK-së në fshatin

Lëbushë, më 14 qershor 1998. Vidomir Shalipur, pjesëtar i MUP-it të Pejës, është plagosur, më 15 qershor 1998, në luftimet e zhvilluara në Drenoc të Deçanit. – Më 14 qershor 1998, në luftime me forcat serbe në Drenoc vriten pjesëtarët e UÇK-së, *Armend Tafil Kukleci* (1975) nga Peja dhe *Blerim Selman Lokaj* (1975), nga Prejlepi, të dy pjesëtarë të njësisë speciale si dhe *Tahir Rexhep Alaj* (1940), nga Drenoci.

Polici Marko Shkoriq, pjesëtar i MUP-it të Suboticës, thuhet se është plagosur më 22.6.1998 në Pobergjë, ndërsa Sasha Gjorgjeviq, pjesëtar i MUP-it të Smederevës, është plagosur në luftimet e zhvilluara në Voksh më 8 korrik 1998. – Gjatë kohës së luftimeve në Voksh, më 7 qershor 1998, zhduket nga forcat serbe derisa ishte në vëzhgim luftëtari i UÇK-së, *Isuf Camë Mazrekaj* (1938), nga Vokshi, ndërkaq më 7 korrik 1998, bie dëshmor *Agim Abaz Mazrekaj* (1970), nga Sllupi i Deçanit.

Novica Radojkoviq, pjesëtar i MUP-it të Smederevës, thuhet se është plagosur më 8 korrik 1998 në luftimet e zhvilluara në Rastavicë. Goran Stojanoviq, pjesëtar i MUP-it të Beogradit, i plagosur më 12 korrik 1998 në luftime në Strellc. Dragan Petroviq, pjesëtar i MUP-it të Somborit, i plagosur më 16 korrik 1998 në luftimet e zhvilluara në Isniq. Sadri Bahtiq, MUP-Novi Sad, i plagosur më 19 korrik 1998 në luftimet e zhvilluara në Carrabreg. Zdravko Mudriniq, MUP-Novi Sad, i plagosur në luftimet e zhvilluara në Pobergjë më 20 korrik 1998. Goran Çorto, MUP-Novi Sad, i plagosur më 22 korrik në luftime në Pobergjë.

Mladen Batanijev, MUP-Kikinda, i plagosur më 23 korrik 1998 në luftime në Drenoc. Millan Grçajiq, MUP-Novi Sad, i plagosur më 24 korrik 1998 në luftimet e zhvilluara në Voksh. Ivan Radeviq, MUP-Pejë, i plagosur më 27 korrik 1998 në luftime në Strellc të Epërm. Vetëm gjatë ofensivës së gushtit 1998 janë plagosur policët serbë Dragan Mitroviq, Mirko Kojda, Nebojsa Arsiq, Petar Kovaçeviq, Urosh Velimirov, pjesëtarë të MUP-it të Novi Sadit të plagosur në Hulaj; polici i MUP-it të Prishtinës Slobodan Velkoviq, polici i MUP-it të Novi Sadit Gjuro Lavrosh, të plagosur në Gllogjan; polici i MUP-it të Novi Sadit, Ranko Zhdrnja, i plagosur në Gramaçel; Gjoka Dimiq, pjesëtar i MUP-it të Sremski Karlovcit, i plagosur në Voksh; Zoran Nikoliq, pjesëtar i MUP-it të Malit të Zi, i plagosur rëndë në Baballoç; Radoica Perishiq, pjesëtar i MUP-it të Çukaricës, i plagosur në Carrabreg; Millan Domatenoviq, i plagosur në Junik etj.

Raportet serbe po ashtu dëshmojnë për plagosjen e një numri të konsiderueshëm të policëve serbë gjatë zhvillimit të luftimeve në vijën e frontit në Prejlep si p.sh.: policët Boban Velkoviq dhe Dushan Kovaçeviq, pjesëtarë të Brigadës së Policisë të MUP-it të Beogradit, të plagosur më 12 qershor 1998; Zoltan Tot, polic i MUP-it të Suboticës, i plagosur më 22 qershor; Vladimir Terzin, polic i MUP-it të Somborit, i plagosur më 2 korrik 1998; Sasha Jankelin, polic i MUP-it të Beogradit, i plagosur më 5 korrik 1998; Petar Bojciq, polic i MUP-it serb të Mitrovicës së Sremit, i

plagosur më 16 korrik 1998; Radoje Babiq, polic i MUP-it të Vershacit, i plagosur më 30 korrik 1998 në Prejlep etj.

Duhet vënë në dukje se gjatë luftës, në radhët e policisë serbe, sidomos të atyre nga Vojvodina, ndodhin edhe një varg vetëplagosjesh për të mos marrë pjesë në front. Kështu, sipas burimeve serbe, më 24 korrik 1998, në Rastavicë vetëplagoset polici **Zhivice Vlajiq**, pjesëtar i MUP-it serb të Pançevës; **Stevan Laliq**, MUP-Pançevë, i vetëplagosur më 25 korrik 1998 në Sllup; më 31 korrik 1998, në malin e Hereçit, vetëplagoset polici i MUP-it të Suboticës, **Bozhidar Radovanoviq**; më 4 gusht në Pobergjë vetëplagoset polici **Ivan Shashiq**, pjesëtar i MUP-it të Novi Sadit; **Miroslav Kazhaviq**, MUP-Gjakovë, i vetëplagosur më 4 gusht 1998 në Deçan; më 31 gusht 1998 në Prejlep vetëplagoset polici i MUP-it të Zrenjaninit **Jana Anin**; më 7 shtator 1998, në Baballoç, vetëplagoset polici i MUP-it serb të Suboticës **Dragan Boshkoviq** etj.³¹

³¹ Dokument i gjetur në stacionin policor të Deçanit, në korrik të vitit 1999.

HUMBJET NË LUFTIMET E ZHVILLUARA GJATË VITIT 1999

Ndërsa në luftimet e rrepta të zhvilluara në Zonën Operative të Dukagjinit gjatë vitit 1999, raportet e MUP-it serb tregojnë se janë vrarë policët: **Predrag Rakoviq** (1976) nga Gjakova, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1996, i vrarë më 29 janar 1999 në Rogovë të Hasit. Vrasja e tij është bërë gjatë aksionit për vrasjen dhe masakrimin në pritë të 20 pjesëtarëve të UÇK-së të ZOD të nisur për bartjen e të plagosurve në drejtim të Shqipërisë, dhe të 9 civilëve të fshatit Rogovë e Hasit. Ky polic, siç tregojnë dëshmitarët e gjallë, është vrarë nga komandanti Agim Zeneli - "Cergashi", i cili ka shtënë në të duke dalë nga kombi në të cilin gjendeshin të mbyllur të gjithë pjesëtarët e UÇK-së. Kjo ishte njëra ndër masakrat më çnjerëzore që kryen forcat serbe.*

Pastaj **Millan Stevanoviq** (1979) nga Gorazhdeci i Pejës, pjesëtar i MUP-it prej vitit 1998, i vrarë më 4 shkurt 1999 gjatë sulmit të zhvilluar kundër njësisë së UÇK-së në Piskotë të Gjakovës; **Sllavoljub Stanisavleniq** (1968) nga Nishi, pjesëtar i MUP-it serb prej vitit 1991 dhe **Zoran Sllavkoviq** (1963) nga Gjakova, pjesëtar i MUP-it të Serbisë

* Shih fotografitë e tmerrit në shtojcën *Faksimile e fotografi* në fund të librit.

prej vitit 1992 të rënë në fushë të minuar më 8 mars 1999 në fshatin Stubull të Gjakovës. Në raportet serbe thuhet se më 29 mars 1999, në Shishman të Gjakovës është vrarë polici **Radovan Jorgin** (1956) nga Novo Miloshevo, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1979. Të njëjtën ditë, në pritë të kurdisur nga forcat ushtarako-policore serbe dhe të të ashtuquajturës “polici lokale” e përbërë nga kolaboracionistë shqiptarë, në Shishman të Bokës vriten katërmbëdhjetë (14) luftëtarë të UÇK-së derisa po sillnin armatim nga Shqipëria: **Naim Shin Lata** (1977), nga Smolica e Gjakovës, epror i Brigadës 134, **Kadri Muhamet Berisha** (1966), nga Pozhari i Deçanit, pjesëtar i Brigadës 131, **Florim Elez Sejdiu** (1976), nga Smolica e Gjakovës, epror i Brigadës 134, **Besim Ali Rama** (1963), nga Batusha e Gjakovës, epror i Brigadës 134, **Ibrahim Kadri Asllani** (1973), nga Deva e Gjakovës, epror i Brigadës 134, **Jashar Zejnullah Jashari** – “*Duraku*” (1962), nga Strofci i Vushtrrisë, epror i ZO të Drenicës, **Armend Sefedin Qymyri** (1976), nga Gjakova, luftëtar i Brigadës 134, **Bujar Esat Sylaj** (1974), nga Gjakova, luftëtar i Brigadës 134, **Nuhi Haxhi Elezaj** (1981), nga Lubizhda e Prizrenit, luftëtar i ZO të Pashtrikut, **Mehdi Adem Zabeli** (1968), nga fshati Lum i Madh i Vushtrrisë, pjesëtar i ZO të Drenicës, **Jahja Rehan Danuza** (1971), nga Rahoveci, luftëtar i ZO të Pashtrikut, **Bujar Beqir Shala** (1979), nga Rashiqi i Pejës, luftëtar i Brigadës 135, **Xhemajl Idriz Avdullahu** (1964), nga Gjakova, luftëtar i Brigadës 134, dhe **Man Metë Maqi** (1978), nga Shishmani, luftëtar i

Brigadës 134 të UÇK-së. Trupat e tyre, forcat serbe i grumbullojnë në një vend dhe i djegin së bashku me armatimin dhe municionin që kishin me vete. Pas luftës, mbetjet e eshtrave të 14 vetave janë varrosur në një arkivol të përbashkët në varrezat e Gjakovës.

FUNDI I KRIMINELËVE FAMËKËQINJ VIDOMIR SHALIPUR E MILLUTIN PRASHÇEVIQ

Më 24 mars 1999 në luftimet e zhvilluara në fshatin Lubozhdë të Istogut janë vrarë policët e MUP-it të Istogut **Sinisha Ostojiq** (1971) nga Osojani dhe **Vukadin Petković** (1976) nga Istogu. - Në luftimet e zhvilluara në Lubozhdë, më 24 mars 1999, kanë rënë dëshmorë dy pjesëtarë të UÇK-së: vëllezërit **Afrim Qazim Meshi** (1964) dhe **Bashkim Qazim Meshi** (1966), nga i njëjti fshat.

Ndërkaq në luftimet e zhvilluara prej datës 27 mars deri më 2 prill të vitit 1999 në vijën e frontit Dashinoc – Lumbardh – Llukë e Poshtme – Pozhar, që njihet si Beteja e Pozharit, kanë rënë heroikisht luftëtarët **Elez Ramë Geci** (1951) nga Lluka e Poshtme e Deçanit dhe **Maxhun Brahim Berisha** (1962) nga Prapaçani i Deçanit, eprorë të Brigadës 131 “Jusuf Gërvalla”. Raportet serbe tregojnë se në këto

luftime janë vrarë policët: **Dragutin Stanimiroviq** (1957), pjesëtar i MUP-it serb prej vitit 1976; **Vujo Milanoviq** (1958) pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1979; **Miomir Vujosheviq** (1959) nga Carrabregu i Deçanit, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1985; **Milosh Lasica** (1976) nga Novi Sadi, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1988; **Nedelko Gjukiq** (1954) nga Novi Sadi, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1978; **Oskar Varadi** (1968), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1988 dhe **Sasha Salak** (1972) nga Zrenjanini, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993. Për policin **Selim Adroviq** (1948), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1971, thuhet se është vrarë më 3 prill 1999 në luftimet e zhvilluara në fshatin Tomoc të Istogut. - Më 3 prill 1999, gjatë luftimeve me forcat serbe në Dobrushë të Istogut është vrarë luftëtari i UÇK-së, **Blerim Halil Kelmendi** (1977), nga Llabjani i Pejës.

Për kriminelin famëkeq, **Vidomir Shalipur - "Munja"** (1970) nga Priboji, pjesëtar i MUP-it serb të Pejës prej vitit 1990, thuhet të jetë vrarë më 8 prill 1999, në fshatin Radavc të Pejës gjatë sulmit të ndërmarrë kundër njësive të UÇK-së. – Vidomir Shalipuri njihet si polic shumë represiv që ka rrahur dhe terrorizuar shqiptarët e qytetit të Pejës edhe para se të fillonin përleshjet e para në Kosovë dhe para se të shfaqej UÇK-ja. Fillimisht iu kishte bashkangjitur njësitet special të policisë serbe të quajtur *"Operativna Grupa (OPG)" (Grupi Operativ)* dhe ishte njëri prej kriminelëve

më mizorë të këtij grupi.³² Duke iu referuar burimeve nga policia serbe, Shalipuri pas një kohe e kishte lëshuar OPG-në për të vepruar në kuadër të formacionit policor *"Munja"*, *"për të pasur më tepër autonomi në operacione dhe për të qenë komandant"*.³³ *"Munja"* (*"Vetëtima"*) ishte njësi terroriste dhe njëkohë-sisht edhe kidnepues të paguar nga shteti. Njësia para-militare "Munja" (*"Vetëtima"*) ka qenë një mishërim i çuditshëm i policëve, kriminelëve dhe të vetëquajturve patriotë, të cilët nga serbët ishin konsideruar si legjendarë, për përleshjet e tyre që kishin zhvilluar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për sulmet e pamëshirshme mbi civilët shqiptarë.³⁴ Ndërsa Vidomir Shalipuri ishte truri militar i këtij grupi famëkeq dhe njëkohësisht komandant i tij. Aty bënë pjesë edhe kriminelë të shumtë si Nebojsa Miniq – "Mrtvi" (një kriminel i njohur dhe me një stazh të gjatë nëpër burgje, më vonë komandant i "Munja"-s, drejtues i masakrës mbi popullatën civile në Çyshk, Zahaç, Pavlan), pastaj Miqo Martinoviq, Gjuro Kastratoviq, Milan Kaljeviq, Obrad Rajiçeviq, etj.³⁵

Shumë militarë serbë janë dërguar në Kosovë drejt nga qelitë e burgjeve në Serbi. Disa prej këtyre militarëve që kanë luftuar në Kosovë i pranuan "American Radio

³² Shih adresën në internet <http://www.americanradioworks.org>; Fetnete Ramosaj – Faton Mehmetaj, artikull për Avni Elezajn, "24 Orë", Prishtinë, tetor 2002; Faton Mehmetaj, vep. *Veprimtaria kriminale e "Dorës së Zezë" serbe në trojet shqiptare*, "Anatema", Prishtinë, 2004, f. 375.

³³ Po ata, po aty.

³⁴ Po ata, po aty.

³⁵ Po ata, po aty.

Works"-it se ata ishin liruar nga vuajtja e dënimit në burg me kushtin e ardhjes për të luftuar në Kosovë. Një nga ta është Marko, një ish-i burgosur që tash jeton në Mal të Zi. Ai është një figurë tipike e njeriut nga nëntoka serbo-malazeze. *"Urdhërat që më jepeshin mua ishin që të arrestoja njerëzit dhe t'i fusja brenda"*, tregon Marko. *"Pastaj, ka pasur urdhra speciale për të kapur individë të veçantë dhe për t'i sjellur ata gjallë ose vdekur. I kam likuiduar pesë a gjashtë njerëz në këtë mënyrë. Arrestonim njerëz të rëndësishëm, politikanë, funksionarë. Për çmimin e lirisë sonë ne ishim në gjendje të bënim, thjeshtë, gjithçka"*.³⁶

"Munja" ("Vëtetima") ishte formuar në fillim të vitit 1998, si një njësit që do t'iu kundërpërgjigjej sulmeve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që sa vete e shtoheshin në rrethinën e Pejës. Njësitë ishte menduar për të qenë si një krah i **"Posebne Jedinice Policije - PJP"** ("Njësitë Speciale të Policisë") të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. "Munja" kishte marrë pjesë në disa përleshje të mëdha me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si në Voksh, Jabllanicë, Gllogjan, Irzniq etj. Pjesëtarët e "Munja"-s shkonin në vendet ku askush tjetër nuk dëshironte, "Munja" shkatërronte çdo gjë, thekson ndër të tjera American Radio Works, në studimin e saj, duke iu referuar burimeve nga policia serbe.³⁷ "Munja" ka pasur prej 30 deri në 50 luftëtarë dhe një numër të madh të automjeteve të blinduara, të cilat,

³⁶ Shih Raportin e "American Radio Works"-it, përkritazi me masakrën e Çyshkut.

³⁷ Po aty.

me fillimin e bombardimeve të NATO-s, ishin strehuar në barakat e "Armatës Jugosllave" në Pejë. Ky grup ka pasur lidhje të ngushta në Pejë me anëtarët e Partisë Radikale Serbe (SRS) të Vojislav Sheshelit dhe me zyrën e prefektit serb të Pejës, Jovo Popoviq, i cili gjatë luftës, ishte zëvendëskomandant i "Shtabit të Krizës" për Qarkun e Pejës, i emëruar nga "Armata Jugosllave".³⁸

Likuidimin e Shalipurit e bëri Avni Elezaj* (17) nga Jabllanica e Vogël, më 8 prill 1999, në Novosellë (afër fshatit Radavc) duke e goditur me mortajë krahu dhe duke e hedhur në erë automjetin me të cilin po udhëtonte me bashkëvepruesit e tij. *"Me vrasjen e Shalipurit në një pusi në afërsi të fshatit Radavc, në prill të vitit 1999, kishin filluar edhe ditët e vështira për "Munja"-n. Me vdekjen edhe të disa pjesëtarëve të tjerë të grupit, mendohet se numri i luftëtarëve ishte zvogëluar dhe se pak prej tyre kanë mbijetuar"*, shkruan American Radio Works.³⁹

Më 16 prill 1999, kur në mbrojtje të popullatës civile të strehuar në Malet e Dubočakës, në përleshje të rrepta me forcat serbe në Zhebel bien heroikisht komandanti për Operacione Luftarake i ZOD-it, *Shkëlzen Hilmi Haradinaj* (1970), me bashkëluftëtarët eprorë të Brigadës 131: *Fatmir Smajl Nimanaj* (1973), *Hasim Misin Halilaj* (1973) dhe

³⁸ Po aty.

* **A v n i (S m a j l) E l e z a j** (1981) është vrarë nga pusia, më 12 tetor 2002, në Pejë. Edhe babai i tij, Smajli, është vrarë më 16 mars 2004 në Pejë. Vrasjet e asnjërit prej tyre deri më tani nuk janë ndriçuar.

³⁹ F. Mehmetaj, *Vepimet kriminale e "Dorës së Zezë" serbe në trojet shqiptare*, vep. e cit. më lartë, f. 375.

Luan Islam Nimanaj (1978) të gjithë nga Glllogjani, si dhe *Hajdin Misin Haziri* (1968) nga Zhebeli i Gjakovës, në raportet e MUP-it serb thuhet se janë vrarë policët **Jelenko Buniq** (1976), nga Zrenjanini, **Zhelko Rauzhan** (1970), nga Mitrovica e Sremit dhe **Goran Sandiq** (1973), nga Kikinda; **Nikola Rakiq** (1947), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1998, thuhet se është vrarë më 18 prill 1999 në luftimet e zhvilluara në fshatin Drenoc i Madh, komuna e Klinës.

Për **Millutin Prashçeviqin** (1968) nga Vraniqi i Gjakovës, oficer i lartë i MUP-it serb në Gjakovë, kriminel në zë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1990, **Lubograd Llazareviqin** (1973) nga Klina, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1998, **Boban Llazoviqin** (1976) nga Peja, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1998, thuhet se janë vrarë më 21 prill 1999 në Mejë të Gjakovës.

Vetëm një javë më vonë Meja e Korenica do të bëhen kasaphanë e mbi 500 civilëve shqiptarë, nga ana e forcave serbe, mbetje eshtrash të të cilëve në grupe të vogla tash sa vjet po i kthejnë nga varrezat masive në Serbi. Sipas dëshmitarëve okularë, në masakrën e Mejës vetëm gruaja e Millutin Prashçeviqit, i ka ekzekutuar dhjetë civilë shqiptarë.

Serbia ka speculuar shumë se Masakra e Mejës dhe Korenicës – Golgota Shqiptare,* ka ndodhur në shenjë

* Më 27 prill 1999, brenda një dite, vetëm për disa orë, jo më shumë se brenda dy kilometrash distancë midis fshatrave Mejë dhe Korenicë, u zhdukën 500 civilë shqiptarë. (Engjëll I. Berisha, *Masakra e Mejës dhe e Korenicës*, botoi SHB “Gjon Nikollë Kazazi”, Gjakovë, 2001, f. 23).

hakmarrjeje për vrasjen e kryekriminelit Prashçeviq dhe bashkëvepruesve të tij. Një pohim i tillë assesi nuk mund të jetë i qëndrueshëm. Sepse, sipas mbamendjes historike, masakrat çnjerëzore serbe mbi popullatën civile shqiptare, ishin tragjedi të stërpërsëritura dhe se metodat e veprimit të politikës terroriste të Serbisë ndaj shqiptarëve janë të përcaktuara qartë në elaboratet serbe të Çubrilloviqit, Andriqit, Qosiqit e viqëve të tjerë. Vetëm në elaboratin* e Vasa Çubrilloviqit, kaptina të tëra i kushtohen rripit të “kufirit me atdhe” Kosovë - Shqipëri, pikërisht Rekës së Keqe. Këtu niset plani “**Patkua**”. Projekti saktëson mënyrën se si duhet dëbuar popullin, se si duhet djegur vendbanimet, se si duhet vrarë të rinjtë, se si duhet masakruar popullatën për të mos patur dëshirë kurrë më të kthehen në trojet e veta dhe si duhet të dëbohen përtej Bjeshkëve të Nemuna.⁴⁰ Për realizimin e kësaj platforme antishqiptare, pavarësisht nga mjetet dhe metodat që do të përdorëshin, ai që do ta zgjidhte me sukses çështjen e asgjësimit të shqiptarëve nën Jugosllavi “*do të bënte vepër të pavdekshme për popullin serb*”.⁴¹

Masakra e Mejës qëlloi shumë e vonshme, në destinacionin e krimit të paevitueshëm. Masakra kishte filluar më herët, shumë kohë para vrasjes së famëkeqit Prashçeviq. Më

* Shih gjerësisht Elaboratin e dr. Vasa Çubrilloviqit me titull *Shpërngulja e shqiptarëve*, të vitit 1937.

⁴⁰ Engjëll I. Berisha, *Masakra e Mejës dhe e Korenicës*, vep. e cit. më lartë, f. 44-45.

⁴¹ Shih gjerësisht F. Mehmetaj, *Vepërtaria kriminale e “Dorës së Zezë” serbe në trojet shqiptare*, vep. e cit., f. 277.

14 prill 1999, në Mejë e Bizhtazhin, kolona e cila largohej nga Gjakova drejt Shqipërisë, ndalohet nga policia serbe. I kamuflonjë kinse janë policë pasi që policët serbë hyjnë për një çast në mesin e tyre. Aeroplanët e NATO-s shtiejnë mbi këta civilë, duke menduar se janë policë dhe ushtarë serbë. Pastaj, policët serbë bëjnë vrasje të dyfishtë, duke qëlluar me armë nga të gjitha anët mbi ta. Nga ky organizim, vdesin në Meje e Bishtazhin afro 100 veta, të gjithë gra, fëmijë dhe meshkuj - civilë të pa armatosur.⁴²

Kishte më shumë se një vit që forcat ushtarako-policore e paramilitare serbe kryenin masakra çnjerëzore gjithandej Kosovës. Është paraqitur një sarkazmë publike e policisë terroriste serbe, që “arsyetohej” se masakra e Mejës është bërë në shenjë hakmarrjeje pas vrasjes së kryekriminelit Prashçeviq. Vrasja e Prashçeviqit i paska frymëzuar të shfrenohen, duke prerë dhe djegur shqiptarët e Meje - Korenicës. Gjatë masakrës është përmendur emri i Prashçeviqit, kanë këlthitur bishat gjakpirëse se si po hakmerreshin për të. Ata vërtet kishin pse të brengoseshin se s’dinte askush të urrente shqiptarët më shumë se Prashçeviqi. Por masakra nuk ka ndodhur për shkak të hakmarrjes për të. A kanë ndodhur vallë masakat në Prekaz, Qirez, Likoshan, Reçak, Abri, Çyshk, Pavlan, Zahaq, Krushë, Celinë, Bellacërkë, Lybeniq, Kralan... për shkak të Prashçeviqit?⁴³

⁴² Shih gjerësisht Engjëll I. Berisha, *Masakra e Mejës dhe e Korenicës*, f. 27, 43-44.

⁴³ Engjëll I. Berisha, *Masakra e Mejës...*, vep. e cit., f. 26.

Kështu, vetëm një muaj para kësaj masakre çnjerëzore, më 25 e 26 mars 1999, nga forcat serbe në Gjakovë, në krye të të cilave ndër më të tmerrshmit ishte vet Millutin Prashçeviqi, ekzekutohen 57 civilë. Ditën e parë të sul-meve të NATO-s, në shenjë hakmarrjeje, vriten 20 burra në Goden, 6 në Çarshinë e Vjetër, 17 në rrugën e Cërpanës dhe 9 në lagjen rrëzë Çabratit, ku i dogjën të gjitha shtëpitë e saj.⁴⁴ Më 25 mars, vritet atdhetari **Mark Malota**, derisa po dilte nga zyra e partisë politike ku vepronte. Po këtë ditë, në oborrin e shtëpisë së vet vritet edhe piktori **Shefqet Pruthi**. Vrasjet e tyre ishin “*vrasje me para-mendim*”, ngase shquheshin si intelektualë, si krijues të vetëdijes për liri kombëtare, ashtu siç ndodhi edhe me intelektualë të tjerë në qytete të ndryshme të Kosovës. Më 27 mars, vranë **dr. Izet Himën**. Shtatë të tjerë i vranë në Bllokun e Ri. Ua zhdukën kufomat e ua dogjën shtëpitë. Më 1 e 2 prill, 100 veta zhduken dhe vriten nëpër të gjitha rrugët e lagjes së Stacionit të Autobusëve, pastaj rrugës përreth Gjqit deri në rrugën “Asim Vokshi”.⁴⁵ Këso kohe masakra të tmerrshme me përmasa të gjëra ndodhin edhe në Kralan të Gjakovës, në Beleg të Deçanit, në Lybeniq të Pejës e gjetiu nëpër Kosovë.

Më 2 e 3 prill 1999, forcat serbe të cilat arritën të depërtojnë në Kralan, ku ishin tubuar mbi 30 mijë të zhvendosur nga komuna e Klinës, Mitrovicës, Skënderajt

⁴⁴ E. Berisha, *Masakra e Mejës...*, vep. e cit. më lartë, f. 26.

⁴⁵ Po ai, po aty.

etj. Ndanë nga familjet e tyre mbi 100 meshkuj të moshës 15 - 55 vjeçare, të cilët i ekzekutuan dhe masakruan në format më sadiste. Prej datës 19 deri më 24 prill 1999 forcat serbe në afërsi të Urës së Rakovinës dhe asaj të Meqes pandërprerë kanë djegur kufoma të cilat i sjellnin me traktorë nga Kralani e Kpuzi. Për pesë ditë me radhë, në ato vende bashkë me kufomat kanë djegur goma të automjeteve të ndryshme. Një gjë e tillë është bërë me qëllim që t'i zhdukim gjurmët e masakrës dhe viktimat t'i paraqesin si viktimat të sulmeve ajrore të NATO-s.

Në fshatin Kralan të komunës së Gjakovës, më 20 qershor 1999, janë zbuluar disa varre masive apo më mirë të themi krematoriume të tmerrshme, ku forcat serbe kanë ekzekutuar mbi 100 civilë shqiptarë, kufomat e të cilëve më pastaj i kanë djegur me vaj ushqimor për të humbur gjurmët e krimeve çnjerëzore. Vetëm në lagjen e Brahim Zenunëve të Kralanit, shihen gjurmët e 11 varreve masive, ku janë ekzekutuar nga 15-20 civilë shqiptarë. Gjurmë të tilla të kufomave të djegura, si kafka, eshtra gjymtyrësh, dhëmbë, rroba të djegura e gjurmë gjaku shihen kudo në vendet ku është bërë ekzekutimi i civilëve shqiptarë. Gjurmë të tilla ka në oborrin e shtëpisë së Shaban Kapllan Zenunit, në oborrin e shtëpisë së Brahim Isuf Zenunit, në shtëpinë e rrënuar të Muharrem Pajazitit, në shtëpinë e Sadri Xhemë Kadriaft, në livadhin e Kadri Metës, në dy vende në livadh të Muharrem Pajazitit, në njërin vend kufomat janë djegur me raki, pastaj në oborrin e shtëpisë së

Ramë Miftarit, në rrugicat e kësaj lagjeje, në bunarin e Brahim Zenunit, të Imer Pajazitit, të Muharrem Pajazitit etj.⁴⁶

Mujë Gërvalla (70) nga Duboviku, komuna e Deçanit, është masakruar nga forcat serbe gjatë ofensivës së muajit prill 1999 në oborrin e shtëpisë së tij. Kufoma e tij është gjetur më 21 maj 1999. I kishte të këputura me sopatë kokën, duart, këmbët e gjymtyrët tjera të trupit. Disa pjesë të trupit nuk iu gjetën fare.

Sylejman Dushi, 30-vjeçar nga Klina, baba i gjashtë fëmijëve, më 26 mars 1999, është ekzekutuar nga forcat serbe para syve të anëtarëve të familjes së vet. Duke i parë forcat serbe duke ia ekzekutuar të birin, vdiq në vend e ëma e tij, **Zyryfe Dushi**, 58-vjeçare.

Më poshtë do të përmendim masakrën makabre që kryen forcat serbe në shtëpinë e Mehdi Vejsës* dhe në familjen Haxhia në Gjakovë. Tmerri që ndodhi në bodrumin e shtëpisë së Mehdi Vejsës së ndjerë është dëshmia më autentike dhe më rrëqethëse. Përmasat makabre të kësaj masakre s'mund t'i përthekojë mendja e shëndoshë njerëzore. Aty ndodheshin: gruaja e Mehdiut, **Fetije Gashi-Vejsa** (60-vjeçare), gruaja e djalit të saj, Lulzimit, **Tringa Hani Hoxha-Vejsa** (30-vjeçare), e ëma e Tringës, **Shahindere Nushi-Hoxha** (55-vjeçare), motra e

⁴⁶ "Kosova Press", 20 qershor 1999.

* Shih fotografinë e kriminelëve serbë në krye me Millutin Prashçeviqin, në shtojcën **Faksimile e fotografi** në fund të këtij libri, të cilët, sipas dëshmitarëve, janë fotografuar pasi që kryen masakrën mbi familjen Vejsa, më 2 prill 1999.

Tringës, *Flaka Hani Hoxha* (15-vjeçare), fëmijët e Tringës, *Rita Lulzim Vejsa* (2-vjeçare), *Arlind Lulzim Vejsa* (5-vjeçar), *Marigona Lulzim Vejsa* (9-vjeçare), *Dorina Lulzim Vejsa* (11-vjeçare). Në bodrum ndodhej edhe vajza e Fetijes dhe Mehdi Vejsës, *Valbona*, (38-vjeçare), e martuar me Behar Haxhiavdinë me fëmijët: *Doruntinën* (3-vjeçare), *Egzonin* (5-vjeçar) dhe *Rinën* (7-vjeçare). Pos këtyre në bodrum ndodhej edhe *Valbona Valdet Byci-Caka* (34-vjeçare), gruaja e Ali Xhemil Cakës, me tri vajzat e saj *Dionën* (2-vjeçare), *Delvinën* (7-vjeçare), *Dalinën* (14-vjeçare) dhe djalin e saj *Drenin* (9-vjeçar), *Hysen Shaban Gashi* (53-vjeçar), *Mandushe Lutfi Nuqi* (52-vjeçare) dhe nëna e saj *Shirine Lama-Nuqi* (73-vjeçare). Gjithsejt në bodrum ndodheshin 21 veta: një mashkull i moshës madhore, 7 gra të moshave prej 30 - 73 vjeçare dhe 13 fëmijë prej moshës 2 - 15 vjeçare. Në të gjithë këtë masë fëmijësh dhe grash kanë shkrepur rafale automatikësh dhe pasi i kanë vrarë ia kanë futur flakën shtëpisë. Nëpër tym e flakë Dren Ali Caka (9-vjeçar, i plagosur me dy plumba në krahëror) ka arritur të dalë nëpër dritare dhe të shpëtojë, por nuk ka mundur ta nxjerrë prej aty edhe motrën e tij të vogël Dionën 2-vjeçare, e cila kërkonte ndihmë nga ai. Diona u dogj e gjallë. Është rrënçethës rrëfimi i Drenit të plagosur, i cili kur po dilte nëpër dritare e kishte lënë motrën e vogël duke kërkuar ndihmë nga ai: *“Bacë, merre çikën!”*.⁴⁷

⁴⁷ Kadrush Radogoshi, *Dëshmi për vrasjet e persekutimet dhe për djegien e Gjakovës në*

Sipas një statistike, asnjë fëmijë në botë nuk ka parë në një gjysmë ore më shumë vdekje se sa Dreni. Ai, në grumbullin e fëmijëve mbeti gjallë për fat, por edhe në saje të zgjuarsisë së tij. Me krah të plagosur bëri sikur kishte vdekur, kaloi përmes këmbëve të gjaksorëve të tërbuar, kapërceu dritaren dhe arriti te halla e tij. Të vdekura i la nënën Valbonën, motër Delvinën, Dalinën dhe Dionën...⁴⁸

Në masakrën e kryer më 2 prill 1999, në lagjen e Stacionit të Autobusëve në Gjakovë, në familjen Haxhia, forcat pushtuese serbe vranë vëllezërit *Hasan* (49-vjeçar) e *Adem* (46-vjeçar) *Ali Haxhia*, djemtë e Ademit, *Beratin* (17-vjeçar) e *Gëzim* (26-vjeçar) dhe gruan e Hasanit, *Myzafere Murat Haxhiun* (49-vjeçare). Ndërsa familja e *Januz Canës* (72-vjeçar) e përbërë nga gruaja e tij *Ganimete (Rexha) Cana* (60-vjeçare), vajza *Shpresa* (43-vjeçare) dhe djali *Fatmiri* (41-vjeçar). Pasi i masakruan i dogjën së bashku me shtëpinë. Kjo familje u zhduk pa lënë asnjë pasardhës. U vra *Afërdita Deda - Demjaha* me të birin *Ylberin*, të cilin e masakruan me thika në gjumë e pastaj e tërhoqën zvarrë dhe e varën në shtyllën elektrike. Për këtë masakër dëshmitari okular Agron Nagavci, ndër të tjera thotë:

“Natën kritike forca të shumta policore dhe para-militare (60 sish) kishin rrethuar lagjen tonë pas mesnatës në mes 1 e 2 prillit 1999. Ngjarjen e kam shikuar nga kati i dytë i shtëpisë sime, e cila

pranverën e vitit 1999, fejtton 1, “Zëri”, 17 janar 2005, f.19; Engjëll I. Berisha, *Masakra e Mejës...*, vep. e cit., f. 26.

⁴⁸ E. Berisha, po aty.

gjendet në këtë lagje. Aksioni ka filluar me sinjalizimin e bërë nga komandanti i policisë së Gjakovës, N. P., i cili e ka ndezur shkrepën. Posa e morën sinjalin, policët ndezën dritat e automjeteve për të ndriçuar terrenin. Ndezja e dritave më ka mundësuar t'i identifikoj pjesëmarrësit e krimeve të asaj nate. Ata ishin kryesisht banorë të kësaj lagjeje, ishin fqinjë tanë, disa prej tyre i kisha shokë të fëmijërisë me të cilët kisha raporte të mira deri atë natë. Ata nuk hezituan të vrisnin mbi 60 veta, të digjnin më shumë se 100 shtëpi dhe banorët e tyre t'i përzënin për në Shqipëri.”⁴⁹

Se civilët serbë kanë bërë krime edhe më të mëdha se armata terroriste serbe, u vërtetua menjëherë pas luftës, nga dëshmitë e të gjithë atyre shqiptarëve që kishin pësuar nga dora gjakatare serbe. Kudo që ka pasur masakër, familjarët përmendin emrat e fqinjëve të tyre serbë. Në bazë të shpjegimeve të familjeve të dëmtuara, më se 60 për qind të krimeve janë kryer nga serbët vendorë civilë. Ata u mobilizuan në bandat paramilitare.⁵⁰ Lagjja Brekoc, ishte e banuar me 10 për qind serbomalazezë. Me rastin e bombardimeve të NATO-s të gjithë u uniformuan. Po ashtu, Lagjja Piskotë, kishte të njëjtën pozitë dhe po ashtu të gjithë u bënë policë. Në policë u shndërruan po ashtu edhe të gjithë banorët serbë të lagjes së ashtuquajtur “Rruga e shkijeve”.⁵¹

⁴⁹ K. Radogoshi, *Dëshmi për vrasjet e persekutimet dhe për djegien e Gjakovës...*, fejtton, “Zëri”, 17 janar 2005, f.19.

⁵⁰ Engjëlli I. Berisha, *Masakra e Mejës dhe e Korenicës*, vep. e cit., f. 40.

⁵¹ E. Berisha, *Masakra e Mejës dhe e Korenicës*, vep. e cit., f. 40-41.

Pas masakrës së Meje-Korenicës, dëshmitarët ofrojnë prova konkrete dhe emra konkretë serbësh që deri atëherë ishin njohur në Gjakovë si qytetarë civilë, që do të thotë, të gjithë sa ishin nga Brekoci dhe Piskota, janë parë të veshur me uniforma paramilitarësh, madje as nuk janë maskuar fare. Më të vrullshëm ishin serbët nga Brekoci, pasi ata njihnin të gjitha qëndrimet politike të shqiptarëve të Meje-Korenicës, si dhe nga diku ishin informuar për hollësira të tjera, kështu që ata e dinin me përpikëri kush ku ndodhet. Ata kishin kryer “punën” me efikasitet, kishin njohuri të sakta për secilin, si dhe kishin komandë si të vepronin me akëcilën familje shqiptare. Meqë kishte komandë, vërtetohet se krimi ishte programuar diku “më lartë”. Nëse nuk dihen ata “më lartë” në Beograd, kriminelët “lokalë” serbë dihen me emër e mbiemër. Familjet e shqiptarëve të dëmtuar kanë deponuar emrat e kriminelëve, duke ofruar deklarata me shkrim në Këshillin për Mbrotjtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut.⁵²

Për policin **Dushan Karanoviq** (1965) nga Rajnovci, komuna e Bihaqit, pjesëtar rezerv i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994 thuhet se është vrarë më 1 maj 1999 në rrugën Jabllanicë – Raushiq –Pejë, afër fshatit Llugaxhi; **Dragan Kličković** (1964), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1984, i vrarë më 4 maj 1999 në luftime në Prapaçan të Deçanit; **Jovan Otasheviq** (1977) nga Plava, i vrarë më 4 maj 1999 në

⁵² Po ai, po aty.

luftimet e zhvilluara fshatin Savino-Vodë të Pejës. Ndërkaq në përleshje në mes të forcave policore serbe me njësitë e UÇK-së, **më 8 maj 1999**, në Baran të Poshtëm, të komunës së Pejës janë vrarë policët: **Momçillo Miçunoviq** (1945), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1981; **Stanisha Ristoviq** (1970), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1996; **Srgjan Cvetkoviq** (1973), pjesëtar rezervë i MUP-it të Serbisë prej vitit 1997; **Radosav Simonoviq** (1950), pjesëtar rezerv i MUP-it të Serbisë prej vitit 1998 dhe **Vitimir Popoviq** (1954), pjesëtar rezervë i MUP-it të Serbisë.

Polici **Goran Radeka** (1967) nga Zemuni, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1986 thuhet se është vrarë më 8 maj 1999 në luftimet e zhvilluara në fshatin Trubuhovc të Pejës. – Nga ana e UÇK-së në luftimet e zhvilluara në Trubuhovc kanë rënë dëshmorë: **Muharrem Sejdi Morina** (1941), **Ragip Qaush Morina** (1966), **Mustafë Tahir Shabani** (1960), **Bujar Rrahman Neziri** (1978), **Xhelal Zenun Morina** (1980), **Emin Mic Berisha** (1945), **Hysni Emin Berisha** (1979), **Afrim Isë Berisha** (1976), **Përparim Muhamet Berisha** (1981), **Ajet Rexhep Rrahmani** (1973), të gjithë nga fshati Trestenik i Pejës si dhe **Esat Ali Shabani** (1966), nga Sferka e Thatë, **Nexhat Adem Bajrami** (1968), nga Sferka e Thatë, **Muharrem Haxhi Gashi** (1977), nga Ruhoti, **Bekim Sefer Mavraj** (1977), nga Staradrani dhe **Ibish Daut Mavraj** (1963) nga Staradrani; Polici **Goran Jojiq** (1976) nga Novi Sadi, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1995 thuhet se është vrarë më 15 maj 1999 në Kralan të Gjakovës. – Nga

ana e UÇK-së, në luftimet e zhvilluara në Kralan, më 15 maj, ka rënë dëshmor **Sadri Rrustem Shala** (1972), nga Cermjani i Gjakovës, i goditur me predhë minahedhësi; Polici **Dragan Milenkoviq** (1964), Beograd, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1994, thuhet se është vrarë më 12 maj 1999 në Lugun e Zi të Klinës; **Dragan Rokvqi** (1972), Zrenjanin, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1993, i vrarë më 23 maj 1999 në afërsi të fshatit Zhebel të Gjakovës. – Të njëjtën ditë në këtë vijë të luftimeve (në Kralan), është vrarë pjesëtari i UÇK-së **Blerim Ali Ahmeti** (1981) nga Kralani i Gjakovës; Për policët **Dragan Shoshkiq** (1965), Kličinë, Pejë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1990, **Zvonimir Shoshkiq** (1953), Prishtinë, pjesëtar rezervë i MUP-it të Serbisë prej vitit 1988, **Jovan Stojanoviq** (1961), pjesëtar rezervë i MUP-it të Serbisë prej vitit 1998, thuhet se janë vrarë në luftimet e zhvilluara në Kličinë të Pejës, më 26 maj 1999; **Kosta Labus** (1961), pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1980, i vrarë më 30 maj 1999 në komunën e Deçanit; **Radovan Tanoviq** (1969), Gostil, Çajetina, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1991, i vrarë më 5 qershor 1999 në luftimet e zhvilluara në Jabllanicë të Gjakovës; **Bogdan Tiragiq** (1962), Banja Llukë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1981, i vrarë më 6 qershor 1999 në luftimet e zhvilluara në vijën e frontit në Irzniq të Deçanit.

Vetëm prej datës 24 maj 1999, në luftime me forcat serbe në vijat e para të frontit nga ana e UÇK-së kanë rënë dëshmorë dhjetëra luftëtarë të UÇK-së: më 24 maj 1999,

trekëndëshin kufitar Kosovë – Mal i Zi – Shqipëri, në Bjeshkë të Bogiqes, janë vrarë në pritën e ushtrisë jugosllave derisa po tranferonin për shërim disa të plagosur: *Përparim Ismet Ferizaj* (1979) nga Kodralia e Deçanit, *Valiant Nijazi Ferizaj* (1975) nga Kodralia, *Fehmi Nazif Demiqi* (1972), nga Abria e Epërme, *Përparim Qazim Shala* (1982) nga Prapaçani, *Nuredin Mehmet Gërvalla* (1977), nga Krysheci i Pejës, *Nazmi Osman Gradina* (1973), nga Dashinoci i Deçanit, *Islam Rexhep Krasniqi* (1957) nga Piskota e Gjakovës, *Xhavit Ramadan Islami* (1964) nga Piskota e Gjakovës, *Naim Halil Berisha* (1977) nga Sferka e Thatë, komuna e Pejës; *Limon Morina* nga Drenoci i Malishevës; janë vrarë edhe të plagosurit: *Hajrush Avdullah Demaj* (1974), nga Dobrusha e Istogut, *Metë Lush Krasniqi* (1972) nga Turjaka e Pejës, *Hysen Mon Mehmeti* (1967) nga Gjakova, *Nimon Bajram Musaj* (1953) nga Kodralia e Deçanit. Shumica prej atyre që kishin mbetur gjallë janë ekzekutuar në afërsi nga forcat serbe, të cilat më vonë i kanë grumbulluar dhe djegur kufomat e tyre.* Këtu ishin plagosur edhe disa luftëtarë të tjerë, në mesin e të cilëve *Sali Muhamet Ferizaj* (1980) nga Kodralia e Deçanit.

Salihu i plagosur arrin të kthehet prapa. Pas gjashtë ditë rrugëtimi, pa ndihmën e askujt, arrin deri në fshatin Strellec të Poshtëm ku bie në kthetrat e policisë serbe të Stacionit

* Mbetje të eshtrave të këtyre të vrarëve janë gjetur në varrezën masive në Petrovo Sello të Serbisë. Eshtrat e disave janë kthyer dhe varrosur në Kosovë gjatë viteve 2003-2004, por jo të gjithë.

Policor të Deçanit. Vinko Armush, inspektor i MUP-it serb bashkë me suitën e tij vrastare, e mbysin me torturë. Atij ia kishin vënë një qese najloni në kokë dhe e kishin hedhur në një bunar të Strellecit të Poshtëm, duke ia gjuajtur përmbi mbi 100 blloka të çimentos.⁵³ Trupi i Salihut u gjet në fund të muajit korrik 1999 dhe u varros në vendlindjen e tij në Kodrali.

Më 25 maj 1999, në vendluftimin në Kodër të Gllavicës, mes fshatrave Vranoc e Buçan janë vrarë pjesëtarët e UÇK-së: *Muharrem Sadri Kelmendi* (1950) nga Peja, *Ardian Xhemajl Kelmendi* (1980) nga Kosuriqi, *Islam Sali Berisha* (1978) nga Çallapeku dhe *Fetah Adem Selca* (1971), nga Barani i Pejës; në Bjeshkë të Haxhiajve janë vrarë *Hilmi Osman Bërdynaj* (1966) dhe *Avdi Smajl Bërdynaj* (1955); Më 26 maj 1999, në afërsi të fshatit Shaptej në pritën e forcave serbe derisa po bënin transferimin e të plagosurve janë vrarë pjesëtarët e UÇK-së: *Luan Isuf Qerimaj* (1980), nga Glllogjani i Deçanit, epror i Brigadës 131, *Rexhep Ali Tafa* (1973), nga Beci i Gjakovës, epror i Brigadës 132, *Haki Ali Krasniqi* (1959), nga Vranoci i Pejës dhe *Bislim Muharrem Aliaj* (1970), nga Dujaka e Gjakovës; Më 27 maj 1999, janë vrarë luftëtarët: *Hajrush Mehmet Elezaj* (1973) nga Radavci i Pejës, *Feriz Hasan Blakaj* (1964), nga Vrella e Istogut, të vrarë në Vrellë. Më maj 1999 janë vrarë edhe luftëtarët *Hamdi Bilall Çeta* (1972), nga Trubuhoci i

⁵³ Deklaratë e familjarëve të Sali Ferizajt.

Istogut, i vrarë në fshatin Kashicë dhe *Menhend Osman Dervishaj* (1974), nga Zabllaqi, i vrarë në fshatin Osdrim të Pejës; *Arsim Hamdi Përgjegjaj* (1976), nga Lumbardhi, i vrarë në Lumbardh të Deçanit; Më 28 maj 1999, në luftimet e zhvilluara në Dashinoc të Deçanit, është vrarë *Sinan Haradin Morina* (1968), nga Rigjeva e Klinës; Më 1 qershor, në përleshje me forcat serbe në Lumbardh të Deçanit janë vrarë *Patriot Dan Berisha* (1982), nga Piskota e Gjakovës dhe *Arton Adem Lekaj* (1983), nga Lumbardhi; Më 3 qershor, në luftime në Gërgoc është vrarë luftëtari *Selim Qerim Salihu* (1963) nga Gërgoci; Më 5 qershor, në vijën e frontit Dashinoc-Lumbardh vritet luftëtari *Jeton Idriz Dedushaj* (1975) nga Peja; Më 6 qershor, në vijën e parë të frontit Ratishë – Dashinoc bien dëshmorë *Burim Sadik Mustafaj* (1977) dhe *Shpend Zeqë Malaj* (1969) nga Gllogjani, eprorë të Brigadës 131. Ndërkaq, më 7 qershor, vdes nga plagët e marra tri ditë më parë në luftime me forcat serbe në Dashinoc, *Enver Malë Dobraj* (1968), nga Carrabregu.

Polici **Millorad Bullatoviq** (1969), nga Llukavci i Begut, komuna e Istogut, pjesëtar i MUP-it të Serbisë, thuhet se është vrarë në qershor të 1999 në fshatin Savino-Vodë, komuna e Pejës; ndërkaq **Radomir Bukumirov** (1958), Cigë, Pejë, pjesëtar i MUP-it të Serbisë prej vitit 1981, i vrarë në qershor të vitit 1999 gjatë luftimeve të zhvilluara në fshatin Radavc të Pejës, etj.

Të dhënat e mësipërme për humbjet e forcave policore serbe, të paraqitura në këtë publikim, u referohen raporteve të MUP-it serb të Deçanit, Pejës e Gjakovës drejtuar organeve më të larta të MUP-it serb në Prishtinë e Beograd, të botuara por edhe të lansuara në adresa interneti. Prandaj, si të tilla ato përmbledhin vetëm rastet e vrasjeve e plagosjeve në radhët e policisë serbe, pa përfshirë humbjet në radhët e UJ-së dhe njësive paramilitare serbe, që kanë marrë pjesë gjatë tërë kohës në të gjitha luftimet.

PJESA E DYTË

KRIMET QË KA BËRË VET, SERBIA UA MVESHË “TERRORISTËVE SHQIPTARË”

“Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencës sonë natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive”

Dobrica Qosiq

Serbia edhe më tutje vazhdon me manipulime. Çdo krim që ka kryer në Kosovë është përkujdesur t’ia adreson UÇK-së, ndërkaq në raste të tjera është përkujdesur të trumbetojë se krimi apo krimet të jenë bërë gjithsesi për shkak të saj (UÇK-së). Për t’i fshehur krimet e veta, mohon edhe vrasjet e civilëve që i ka vrarë vetë. Në këtë drejtim, para së gjithash, është orientuar në vrasjet e civilëve që janë të varrosur në Kosovë, duke dashur t’ua hudhë fajin shqiptarëve për të hequr përgjegjësinë e vet.

Çuditërisht, edhe pse e vërteta e këtyre vrasjeve dihet botërisht, fabrikimet, shpifjet dhe trillimet e tilla kanë mjaftuar të bëhen lëndë për kriminalizimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Megjithëse pa asnjë bazë qëndrueshmërie, “argumentet” e milicisë serbe janë bërë “brum” i mirë për dosje kundër pjesëtarëve të UÇK-së. Këtë

mision e ka edhe faqja zyrtare në internet e Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme, njëra nga segmentet e krimit shtetëror serb në Kosovë. Prandaj, mirë ka thënë Dobrica Qosiqi se *“rrena është bazë e filozofisë serbe të suksesit”*. Esenca e kësaj filozofie shihet qartë edhe në adresën në internet <http://www.mup.sr.gov.yu>.

Është karakteristikë se, pas luftës në Kosovë, më së shumti janë diskutuar “krimet” që nga qarqe të caktuara i janë mveshur UÇK-së. Madje, dëshmitë kundër saj, janë stimuluar në mënyra nga më të ndryshmet, ndërsa krimet serbe është tentuar dhe po tentohet të lihen në harresë.

Në kohën kur nga bashkësia ndërkombëtare janë identifikuar vendet e varrezave masive të shqiptarëve, të zhvarrosur e të rivarrosur shumë herë, propaganda serbe, për t’i fshehur gjurmët e krimit, tenton të krijojë paralelizma të tilla te shqiptarët dhe në mungesë faktike të varrezave masive serbe të gjenden individë të cilët do të akuzoheshin për krime lufte. Aq më tepër kur shumica e shqiptarëve të akuzuar inkriminohen për “krime” të kryera ndaj bashkëkombasve të vet.⁵⁴

Fatkeqësisht, në grackën e shpifjeve e manipulimeve serbe ka rënë edhe një pjesë e bashkëkombasve tanë që, edhe nëpërmjet komisioneve të ngritura kundër UÇK-së, edhe nëpërmjet shpifjeve shpeshherë të paguara me çmime

⁵⁴ Mr. sc. Muhamet Malaj, *UNMIK-u ndërmjet të sotmes dhe të ardhmes së Kosovës*, “Fokusi”, 2 prill 2004, f. 19.

tepër të larta, kanë bërë punën e Serbisë, duke punuar kundër vetvetes.

Qarqe të caktuara, që nga përfundimi i luftës, por edhe gjatë saj, janë përfshirë në fushatë denigruese, me tendenca të hapura politike kundër UÇK-së, dhe nuk kanë bërë asgjë tjetër, pos që, me çdo kusht janë përpjekur të rrënojnë çdo gjë, të denoncojnë e të shpifin tmerrësisht kundër çdo pjesëtari të saj. Në saje të këtyre shpifjeve, burgjet e Kosovës janë mbushur me ish-pjesëtarë të UÇK-së. Në bankat e të akuzuarve, në vend të kriminelëve, janë djemtë e UÇK-së, të cilët janë akuzuar, janë gjykuar e janë dënuar pa arritur të argumentohen nga gjykatat ndërkombëtare as “faktet” më elementare të akuzave që u ngarkohen. Dhe kjo bëhet thuajse UÇK-ja duhet të përgji-gjet për krimet dhe gjenocidin e makinerisë serbe të bërë në Kosovë. Janë farsa thëniet e stërpërsëritura se këto aktgjykime janë të organizuara kundër individëve e jo kundër UÇK-së. E vërteta qëndron ndryshe. Po akuzohet e gjykohet tërë UÇK-ja, po gjykohen edhe të rënë, edhe të gjallët, po gjykohet çdo shqiptar që ka bërë sadopak për lirinë e vendit të vet, po gjykohet edhe aleatja e saj – NATO-ja, që ishte krah i UÇK-së në luftën për liri të Kosovës. Jo rastësisht po tentohet të tërhiqen paralele për bashkëpërgjegjësi për luftën e zhvilluar në Kosovë, të tërhiqen paralele ndërmjet regjimit gjakatar pushtues serb (duke përfshirë këtu policinë, ushtrinë, paramilitarët e civilët e armatosur serbë), nën dhunën e të cilit populli i Kosovës përjetoi të gjithë

rrathët e ferrit dantesk. Pasojat e këtyre tendencave janë tepër të rënda dhe të kushtueshme si për të sotmen, ashtu edhe për të ardhmen e Kosovës.

Krimet dhe gjenocidi serb i ushtruar në Kosovë nuk janë të djeshme as të sotme. Ato janë shtresuar tash e më se një shekull, në format më të egra e më barbare. Por, përballë tyre, populli shqiptar bëri një qëndresë vigane në luftë për mbrojtje të ekzistencës, edhe pse secili regjim serb ishte më gjakatar se tjetri. Si rezultat i rezistencës shekullore mbarëshqiptare, u arrit që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të jetë organizimi ushtarak më i suksesshëm i shqiptarëve tash e dy mijë vjet, duke krijuar një realitet të ri historik e kombëtar, duke përfutur edhe përkrahjen e aleatëve të NATO-s, për ta shpëtuar popullin e vet nga zhdukja fizike dhe Kosovën nga zhbërja gjeografike. Ky realitet për dikë edhe më tutje duket të jetë i papranueshëm. Edhe më tutje po tentohet që Kosova të mbetet përdhunisht brenda krijesës artificiale të mbetjes jugosllave, të ashtuquajturit Unioni Serbi-Mal i Zi (SMZ).

Deri më tani, asnjë serb nuk është përgjigjur për vrasjet dhe masakrimet e rreth 20 000 qytetarëve të Kosovës; askush nuk është përgjigjur për mijëra dhunime; askush nuk është përgjigjur për qindra-mijëra djegie e shkatërrime; askush nuk është përgjigjur për dhunën, terrorin, gjenocidin dhe dëbimin masiv të popullit të Kosovës. Madje, askush nuk denjoi as të kërkojë falje për të bëmat mizore në Kosovë.

SI TENTON TË “SHFAJËSOHET” REGJIMI SERB PËR KRIMET E BËRA?

Po të shikohet në aspektin historik, vërtetohet se tradicionalisht për krijimin e “Serbisë së Madhe” është ndjekur politika e mbështetur në trillime, gënjeshtër e dyfytërsi, në njërën anë, krahas ushtrimit të dhunës, terrorit e gjenocidit të pashembullt, në anën tjetër. Sipas dokumenteve historike, vërtetohet se vetëm gjatë viteve 1876-1877, prej Sanxhakut të Nishit janë barbarizuar dhe janë dëbuar me masakra 350 mijë shqiptarë. 35 mijë janë mbytur mizorisht gjatë dëbimit nga serbët. Grabitjet në Sanxhakun shqiptar të Nishit kapin shumën prej 40 miliardë dollarësh.⁵⁵ Masakrat dhe dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit u kthyen në traditë lakmuese për politikanët e ardhshëm serbë, që e provuan në vitet e mëvonshme. Së fundi edhe në vitet 1998-1999.⁵⁶ Knjaz Obranoviqi, kur përgatiti ushtrinë serbe për batërdi në viset shqiptare të Sanxhakut të Nishit, publikoi parullën: “*Çdo shqiptar i vrarë është meritë patriotike për ushtarin serb*”. Ndërkaq, kryetari i Serbisë, Slobodan Millosheviqi, në prag

⁵⁵ Shih librin e historianit Bilal Shimshir, *Rumelien Greqleri I-II*, Istambul. (Cit. sipas S. Krasniqit, *Akademikët serbë - piromanë të Ballkanit*, pun. i cit më lartë).

⁵⁶ S. Krasniqi, po aty.

të shekullit XXI urdhëroi terroristët shtetërorë serbë për batërdinë në Kosovë: *“Vetëm shqiptarët e vdekur janë të mirë për Serbinë”*.⁵⁷ Kjo u pa qartë edhe në luftërat dhjetëvjeçare që u zhvilluan në tërë hapësirën e ish-Jugosllavisë, të cilat i shkaktoi Serbia.

Mbi pohimet absurde dhe të pabaza se *“Kosova është djep i shtetit dhe i kulturës serbe”, “Kosova është Serbi e vjetër”, “Kosova është e drejta jonë historike”* etj., u zhvillua shovenizmi i shfrenuar serb e, së bashku me të edhe tendenca e mistifikimit dhe e gënjimit vetëm për t’i realizuar qëllimet shoveniste ndaj zhvillimit kombëtar shqiptar. Këtë, çuditërisht, e ka thënë aq bukur akademiku Dobrica Qosiq,* ish-kryetar i Jugosllavisë, njëri ndër shovenistët më të tërbuar serbë dhe frymëzues i *“Memoran-dumit”* të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë (1986), në mbështetje të të cilit deri në ditët tona u zhvillua e po zhvillohet politika serbe, kur thotë: *“Gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe dëshmi e inteligjencës sonë*

⁵⁷ Po ai, po aty.

* **Dobrica Qosiqi**, më 1974 u ngrit kundër Kushtetutës jugosllave vetëm pse u jepte disa të drejta shqiptarëve të Kosovës, për çka u përjashtua nga Partia komuniste. Në fillim të viteve '80-të, u mbushën libraritë në tërë Serbinë me libra antishqiptarë të shkruara dhe të botuara nga Akademia e Shkencave të Serbisë me autorë: Qosiqin, Batakoviqin, Bogdanoviqin, Gjuretiqin e të tjerë. Në vjeshtën e 1981-shit, nën udhëheqjen e Dobrica Qosiqit shumë aktivistë serbë shkruan një peticion kundër Kushtetutës së vitit 1974. Më 1989, nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të Serbisë u përpilua një raport me shpifje kundër shqiptarëve të Kosovës. (Shih S. Krasniqi, *Akademikët serbë - piromanë të Ballkanit*, pun. i cit.).

natyrore. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, fantastike, inventive”.⁵⁸

Për ta argumentuar faktin se Serbia me çdo kusht krimet që i ka bërë vet në Kosovë është përpjekur t’ia mveshë UÇK-së, do të ndriçojmë disa prej rasteve të shumta, kur qytetarët shqiptarë janë vrarë e masakruar nga forcat pushtuese serbe, ndërsa autorësinë e tyre organet e MUP-it serb, nëpërmjet propagandës dhe agjitacionit të servuar për agjenturat ndërkombëtare, madje edhe me materiale të fabrikuara, të dorëzuara zyrtarisht në gjykatat e UNMIK-ut në Kosovë, e në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës, sipas praktikës tashmë të njohur, ia vënë në barrë UÇK-së. Një gjë e tillë bëhet edhe në publikimet e tyre *“Zloçini albanskijh terorista (1995-1998)”*, (*“Krimet e terroristëve shqiptarë 1995-1998”*) botim i “Jedinstvo”-s, Prishtinë, janar 1999; në adresën zyrtare të MUP-it të Serbisë <http://www.mup.sr.gov.yu> dhe në një varg publikimesh tjera.

Në faqen zyrtare në internet të MUP-it të Serbisë, emri i *Nexhmedin Elshanit*, nga Osdrimi i Pejës, figuron si viktimë e “terroristëve shqiptarë”. Ndërkaq, e vërteta është ndryshe. Nexhmendin (Adem) Elshani, i lindur më 1964, ka qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prej pranverës së vitit 1998, menjëherë pas luftimeve të zhvilluara në marsin e atij viti në Drenicë e Dukagjin, kur u

⁵⁸ Dr. Ramiz Abdyli, *Politika serbe e gjenocidi ndaj Kosovës dhe shqiptarëve*, “Kosova”, nr.2, 1994, f. 24; F. Mehmetaj, *Vepimet kriminale e “Dorës së Zezë” serbe...*, vep. e cit., f. 24.

kthye nga Zvicra dhe filloi stërvitjen e të rinjve të familjes së gjerë Elshani për luftë. Ndërkaq, prej qershorit gjendet në radhët e UÇK-së, në Shtabin Operativ të Rrafshit të Dukagjinit në Gllogjan, kur disa herë kalon kufirin shqiptaro-shqiptar, për të siguruar armë. Merr pjesë edhe në Betejën e Logjës. Pas kësaj, një kontribut të jashtëzakonshëm dha në përcjelljen e ushtarëve dhe të civilëve nga zonat e Dukagjinit për në rajonin e Rugovës. Në një detyrë të tillë, hetohet nga forcat serbe, në pritën e të cilave vritet më 28 gusht 1998, në Baicë të Burimit (ish-Istogut). Nexhmedin Elshani* është dëshmor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shefqet Zukaj (1945), nga fshati Beleg i Deçanit, në listat e MUP-it të Serbisë dhe në publikimin "*Zloçini albanskih terorista (1995-1998)*", botim i "*Jedinstvo*"-s, po ashtu figuron si "viktimë e terroristëve shqiptarë".⁵⁹

Shefqet (Curr) Zukaj ishte njëri ndër ushtarët më të rregullt të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në vijën e parë të frontit në Beleg, i cili që prej angazhimit në radhët e UÇK-së, në prill të vitit 1998, e deri në rënje nuk e lëshoi pushkën nga dora, i bindur se me çdo kusht lufta duhet të fitohet. Ai luftoi e qëndroi i paepur deri në ofensivën e shtatorit 1998, kur u vra në përleshje me forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe, pikërisht me datën 8 të atij muaji, në

* Pas luftës nga dora e zgjatur serbe, Nexhmedin Elshanit, i janë vrarë edhe vëllai Isuf Elshani me të birin Virgjilin, të dy ish-luftëtarë të UÇK-së. Vrasjet e tyre ende nuk janë ndriçuar.

⁵⁹ Shih librin *Zloçini...*, f.117, ku figuron si **Shefqet Zekaj**.

Beleg. Trupi i tij u gjet një javë më vonë. Nga familjarët e bashkëfshatarët u varros në varrezat e fshatit të lindjes. Është dëshmor i UÇK-së.

Çuditërisht, edhe mësuesi e luftëtari i UÇK-së **Gaspër Karaqi** (1961), nga fshati Ujzë i Gjakovës, gjendet në listën e MUP-it serb si "viktimë e terroristëve shqiptarë". Dihet se Gaspër (Ndue) Karaqi është vrarë nga forcat serbe më 28 janar 1999, në afërsi të fshatit Bishtazhin, derisa po kthehej nga rruga pas përcjelljes që ua kishte bërë luftëtarëve të lirisë, të cilët po shkonin në Shqipëri për t'i dërguar në kurim disa luftëtarë të plagosur dhe për të sjellë armatim. Gaspri ishte i angazhuar në sektorin e logjistikës të UÇK-së, së bashku me vëllezërit Lleshi nga Vraniqi. Pikërisht për këtë ai vritet nga forcat serbe. MUP-i i Serbisë harron se vetëm gjatë tri ditëve, 27-29 janar 1999, bashkë me Gaspër Karaqin janë vrarë edhe 29 shqiptarë të tjerë në Bishtazhin, Goden e Rogovë të Hasit, prej tyre edhe njëzet luftëtarë të UÇK-së dhe nëntë civilë, banorë të Rogovës së Hasit, kufomat e të cilëve janë masakruar çmendurisht dhe çnjerëzisht po nga forcat serbe.

Disa prej banorëve të Rogovës janë marrë nga shtrati, derisa ishin në gjumë, dhe janë ekzekutuar.⁶⁰

Njëkohësisht me Gaspër Karaqin janë vrarë: **Agron Osman Rama** (1973) Smolicë - Gjakovë; **Agim Bardh Zeneli** (1962), Jabllanicë - Gjakovë; **Agush Asllan Gjoci** (1971)

⁶⁰ Art. *Dëshmi rrëqethëse për masakrën në Rogovë të Hasit*, "Kosova Sot", 2 shkurt 1999.

Rashiq - Pejë; *Hamdi Ibish Berisha* (1977) Ruhot - Pejë; *Kasim Rexhep Shala* (1981), Ruhot - Pejë; *Sejdi Avdyll Rama* (1965) Smolicë - Gjakovë; *Luan Avdi Smajli* (1978), Jabllanicë - Gjakovë; *Valon Muharrem Gashi* (1977) Buçan - Pejë; *Naim Xhafer Gashi* (1978) Sferkë - Klinë; *Daut Idriz Kelmendi* (1971) Drenjë - Istog; *Bahtiar Avdyll Morina* (1975) Lubizhdë - Malishevë; *Haxhi Hajdar Kleçka* (1976) Kleçkë - Lipjan; *Memë Zef Lleshi* (1973) Vraniq - Gjakovë; *Prend Zef Lleshi* (1964) Vraniq - Gjakovë; *Gëzim Qazim Ademaj* (1961) Ratishë - Deçan; *Emrush Qaush Çeta* (1972) Trubuhovc - Istog; *Naim Halil Dreshaj* (1970) Prigodë - Istog; *Sahit Abdurrahman Krasniqi* (1975) Ratkoc - Rahovec; *Vesel Sejdi Avdyli* (1978) Drenoc - Klinë (kufomën e tij forcat serbe nuk lejuan që ta marrë familja), *Ilir Rexhep Merturi* (1970) Klinë, i zhdukur pa gjurmë. Janë vrarë edhe banorët e Rogovës së Hasit: *Rrustem S. Morina* me tre djemtë: *Selmanin, Muhametin e Nusretin, Ibrahim Kryeziu, Xhevdet Berisha, Zyber Shala, Adem Shala e Rifat Shala*.

Kur jemi këtu, MUP-i serb harron të përmendë se në Bishtazhin, më 28 janar, u zu rob nga policia serbe, *Gani Shala** nga Ruhoti i Pejës, i plagosur rëndë. Sapo e zunë, policët serbë filluan ta rrahin e maltretojnë. E qëlluan edhe me tre plumba në këmbën e djathtë, duke kërkuar nga ai që të pranonte sa serbë ka vrarë, sa herë ka qenë në Shqipëri etj., derisa ia humbën vetëdijen, për të përfunduar në spitalin e Gjakovës, i lidhur me praga për krevati, nën përkujdesin e

* Shih fotografinë e Gani Shalës në shtojcën *Faksimile e fotografi* në fund të librit.

rreptë të policëve serbë. Maltretimet dhe torturat çnjerëzore që ushtroi policia serbe mbi Gani Shalën* në spitalin e Gjakovës, edhe në prani të vëzhguesve të OSBE-së, atëbotë tronditën mbarë opinionin vendor e ndërkombëtar. Ganiu u torturua sërish në Burgun e Pejës, të Pozharevcit, të Dubravës, por torturat më mizore iu bënë në Spitalin e Burgut Qendror (CZ) në Beograd, ku, së pari e konvertuan me dhunë në fenë ortodokse dhe e pagëzuan me emrin “*Llazar*”. Dymbë-dhjetë muaj e gjysmë e kanë detyruar me dhunë të bartë kryqin sllav. Kryqin ia kishin vizatuar edhe në gjoks.⁶¹

Për dy civilët shqiptarë *Hajdar Kuqi* (77) dhe *Bekë Shabanaj - Caca* (70), në librin “*Zloçini albanskijh terorista...*”, thuhet: “Në orët e mëngjesit të 6 majit, në shtratin Bistrica e Deçanit, që rrjedh nëpër vetë qendrën e Deçanit, policia ka gjetur kufomën e Bekë Shabanaj – Caca (70) dhe atë të Hajdar Kuqit (77). Të dhënat e ekspertizës gjyqësore flasin se këta pleq ishin të munduar e të keqtrajtuar para se të vriteshin. Sipas rrëfimeve të familjeve të tyre, ata një ditë më parë kishin shkuar t’i ruanin kafshët kah fshati i afërm Prejlep. Atje u humb çdo gjurmë, prandaj familjet e tyre i paraqesin këto raste në polici”.⁶² Ndërkaq, në faqet e internetit të MUP-it të Serbisë nuk ngurrojnë që t’i paraqesin ata edhe si “*qytetarë lojalë të*

* **Gani Shala** pas vuajtjes së dënimit prej katërmëdhjetë muaj e gjysmë nëpër kazamatet serbe, dymbëdhjetë muaj e gjysmë prej të cilave i kaloi në Spitalin Qendror (CZ) në Beograd, u lirua më 7 prill 2000, nga burgu i Pozharevcit, në një gjendje tepër të rëndë shëndetësore.

⁶¹ Fetnete Ramosaj, *Njeriu që di sa herë mbijetoi vdekjen (bisedë me Gani Shalën)*, “Fokusi”, nr. 62.

⁶² *Zloçini albanskijh terorista...*, vep. e cit., f. 37-38.

Serbisë" ('lojalne gradjane Republike Srbije'), të vrarë nga "separatistët shqiptarë". Sipas dëshmitarëve, familjarëve të viktimave dhe të dhënave të KMDLNJ-së, e vërteta qëndron ndryshe. Pleqtë Bekë Shabanaj dhe Hajdar Kuqi, edhe pse të shtyrë në moshë, më 5 maj '98, derisa ishin duke kullotur bagëtinë në fushat e tyre në Deçan, rrëmbehen nga serbët, keqtrajtohen dhe vriten barbarisht në afërsi të Manastirit të Deçanit. Gjatë ditës, në vendin ku janë gjetur të vrarë, vazhdimisht ka pasur lëvizje të civilëve serbë, ndërsa katër ditë para vrasjes barbare të tyre është raportuar për stacionimin e një numri të madh të paramilitarëve serbë në Manastirin e Deçanit, e bashkë me ta edhe njësisia paramilitare "Beretat e kuqe". Atyre nuk u kanë humbur gjurmët afër fshatit Prejlep, ku as më parë, por as sot e kësaj dite banorët e familjeve Kuqi dhe Shabanaj (Cacaj) nuk e dërgojnë bagëtinë në kullosë. Pra, vendi i vrasjes së këtyre civilëve shqiptarë (mbi magjistralen Deçan - Pejë, në afërsi të manastirit) ka qenë nën kontrollin e plotë të forcave serbe dhe UÇK-ja nuk ka pasur asnjë qasje.⁶³

Lidhur me vrasjen e *Rifat Shalës*, nga Barani i Pejës, dhe plagosjen e të vëllait, Smajlit, në librin "*Zloqini...*", thuhet: "*Të njëjtën ditë terroristët shtijnë me armë te fshati Baran, ndërmjet Pejës e Deçanit, në automobilin ku gjendeshin Rifat dhe Ismail Shala. Në sulm është vrarë vëllai më i vjetër Rifati, ndërsa Ismaili kaloi pa lëndime*".⁶⁴ Ndërkaq, në raportin e KMDLNJ-

⁶³ Të dhëna të KMDLNJ-së – Deçan; Informacion i QIK-ut, i dt. 7 maj 1998.

⁶⁴ Shih *Zloqini...*, vep. e cit., f. 38.

së në Pejë, lidhur me rastin në fjalë, thuhet: "*Më 6 maj 1998, rreth orës 00.30 nga një pritë afër fshatit Buçan vritet Rifat Sadik Shala*" (30) nga Barani, student dhe plagoset rëndë vëllau Smajli profesor i Gjimnazit në Pejë dhe kryetar i nëndegës së LDK-së në Baran. Rifati vdes në vend ndërsa Smajli dërgohet në spitalin e Pejës e pastaj në Prishtinë."⁶⁵

Së pari, Rifat Shala ishte vëllai më i ri, e jo më i vjetër siç thuhet në burimet serbe. Së dyti, Smajl Shala nuk kishte kaluar pa lëndime, por ishte lënduar rëndë. Dhe së treti, ky akt barbar është kryer nga ana e forcave policore serbe e jo nga ana e "terroristëve" të UÇK-së. Sipas shumë burimeve, vrasja e Rifat Shalës dhe plagosja e të vëllait Smajlit, nga ana e forcave policore serbe, u bë për të shkaktuar përçarje dhe për ta penguar masovizimin e luftës dhe shtrirjen e njësive të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në rajonin e Lugut të Baranit, pasi që vëllezërit Shala për këtë qëllim, veç kishin vënë kontaktet me njësitë e UÇK-së në Jabllanicë.

Edhe emri i *Zymer Berishës*, nga Krysheci i Pejës, sipas MUP-it serb gjendet në "listat" e të vrarëve nga "terroristët shqiptarë". Përdërisa dëshmitë e palës shqiptare, përkatësisht të KMDLNJ-së, vërtetojnë se Zymer (Hysen) Berisha* nga Krysheci i Pejës, 72 vjeç, baba i pesë fëmijëve, derisa

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Rifat Shala është i radhitur me numrin rendor 3. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit. më lartë, f. 114).

⁶⁵ KMDLNJ – Pejë, *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 21.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Zymer Berisha, është i radhitur me numrin rendor 21. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 114).

shkonte te bagëtia, është plagosur nga forcat serbe afër shtëpisë së tij, e më pas është arrestuar, ditën e ndërmarjes së sulmit të forcave serbe kundër fshatrave të Lugut të Baranit, më 29 maj 1998. Pra, edhe ditën e sulmit të forcave serbe kundër fshatit Kryshec.⁶⁶ Sulmin ndaj këtij fshati, forcat serbe e kishin filluar që në orët e mëngjesit, duke e granatuar fshatin Kryshec, e veçanërisht lagjen Gërvallaj⁶⁷ për të sulmuar pastaj me makineri të rëndë e këmbësori. Zymerin, të plagosur e tërheqin zvarrë dhe e fusin në automjetin e tyre. Kufoma e tij u gjet më 4 qershor, dy kilometra mbi Pejë, në shtratin e Bistricës së Pejës, në drejtim të Rugovës dhe u dërgua në morgun e spitalit të Pejës, prej nga e mori policia serbe dhe i detyroi disa romë që ta varrosin në varrezat e qytetit të Pejës.⁶⁸ Autorët serbë “harrojnë” të përmendin krimet që bënë të njëjtën ditë në fshatin Vranoc, po më 29 maj 1998, kur fillimisht bënë granatimin e fshatit e pastaj depërtuan me këmbësori, me ç’rast plaçkitën dhe dogjën 18 shtëpi, si dhe shkollën e xhaminë e fshatit. Forcave të shumta sulmuese serbe, që erdhën nga Peja, iu bashkua edhe policia e Stacionit Policor të Çallapekut. Në këtë sulm i ekzekutuan *Halit Zeqë Krasniqin, Beqir Rrustem Krasniqin e Faze Krasniqin,*

⁶⁶ KMDLJ – Pejë, *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f.29, 31.

⁶⁷ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës (mars-qershor 1999)*, vep. e cit., f. 46.

⁶⁸ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 66.

ndërsa *Imer Elez Ukaj*, mbytet me granatë. Kufomat e të gjithëve i dogjën në zjarrin e shtëpive të tyre.⁶⁹

Ish-gjykatat serbe të instaluar në Kosovë, që edhe më tutje si të tilla e vazhdojnë aktivitetin e tyre nëpër vende të ndryshme të Serbisë, duke përfshirë këtu edhe ish-gjykatën serbe të Qarkut të Pejës (kjo e fundit, pas luftës, e vendosur në Nish), kanë bërë përpunimin e një varg dokumenteve të falsifikuara, që i kanë adresuar në adresa diplomatike, në internet dhe në shtypin serb, por edhe në atë ndërkombëtar, me përmbajtje kundër UÇK-së. Njëko-hësisht duke tentuar që kësaj të fundit t’ia mveshin krimet e bëra nga vetë aparati shtetëror serb, të cilit i kanë takuar.

Si civil shqiptar, i vrarë nga “terroristët shqiptarë”, në burimet e MUP-it serb figuron edhe emri i qytetarit *Vehbi Mustafa* (1956) nga Peja, i vrarë më 7 maj 1998 në rrugën Kozjerr-Deçan.⁷⁰ Mirëpo, sipas të dhënave të KMDLJ-së⁷¹ dhe familjarëve të të ndjerit mësohet se Vehbiu,* i cili ishte punëtor i “Elektrodistribucionit” të Pejës, pas shkallëzimit të luftës me forcat serbe, në gjysmën e dytë të muajit prill 1998, kishte refuzuar ta vazhdojë punën dhe me kohë i kishte njoftuar organet përkatëse për dorëheqjen e tij. Në mëngjes të datës 7 maj 1998, një grup serbësh (të njohur për

⁶⁹ *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 46; *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 29-30.

⁷⁰ *Zloçini...*, vep. e cit., f. 116.

⁷¹ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 65.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Vehbi Mustafa është i radhitur me numrin rendor 4. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 114).

familjarët e tij) shkojnë dhe e marrin me dhunë nga shtëpia për ta dërguar në vendin e punës, në Hidrocentralin e Deçanit. Të njëjtën ditë, duke u kthyer nga puna, Vehbi Mustafën e vrasin në automjetin e “Elektrodistribucionit” të Pejës. Mbase kjo vrasje është bërë për shkak të refuzimit të daljes në punë. Është me rëndësi të theksohet se terreni (vendi) në të cilin është vrarë Vehbi Mustafa ka qenë nën kontrollin e plotë të forcave policoro-ushtarake e paramilitare serbe, prandaj misterin e kësaj vrasjeje ato e dijnë më së miri. UÇK për asnjë moment që nga fillimi deri në përfundim të luftës nuk e ka pasë atë pjesë nën kontroll.

Qytetarin pejan **Sadri (Metë) Komoni** (1933), i vrarë ndërmjet datës 25 e 26 maj ‘98 nga pushtuesit serbë, organet serbe fillimisht e cilësojnë si “qytetar lojal të Republikës së Serbisë”, për të thënë më pas se është vrarë nga “terroristët shqiptarë”.⁷² Duke iu referuar të dhënave të KMDLNJ-së në Pejë, rezulton se Sadri Komoni* është vrarë më 25 maj 1998, rreth orës 24, nga pjesëtarë të forcave serbe, të cilët natën kritike në Sadriun kanë shtënë nga një veturë “Lladë” me ngjyrë të kuqe, duke hyrë në shtëpinë e tij, në rrugën afër Kombinatit të Lëkurë-Këpucëve, kur po kthehej nga fqiu i tij. Vrasja e Sadriut, ndodhi vetëm disa orë, pas masakrës që

⁷² Shih adresën në internet <http://www.mup.sr.gov.yu; Zloçini...>, vep. e cit., f. 116.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Sadri Komoni është i radhitur me numrin rendor 16. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit. më lartë, f. 114).

forcat policore serbe kryen mbi familjen Hamzaj në fshatin Lybeniq dhe u tërhoqën në drejtim të Pejës.⁷³

Edhe vëllezërit **Adem e Bakir Gjukaj** nga Peja në burimet e lartëcekura serbe paraqiten si “qytetarë civilë të pakicës shqiptare” të vrarë nga “terroristët shqiptarë”.⁷⁴ Vëllezërit Adem dhe Bakir Muhamet Gjukaj, nga lagjja Karagaç e Pejës, janë ekzekutuar nga forcat serbe më 24 korrik 1998, afër shtëpisë së tyre, te parku i qytetit.* Ata u gjetën të nesërmen në mëngjes të vrarë e të masakruar në veturën e tyre, në rrugë, afër Kombinatit Bujqësor në Pejë.⁷⁵ Duhet theksuar se Ademi dhe Bakiri që në ditët e para të shpërthimit të luftës frontale vazhdimisht kanë furnizuar me medikamente dhe ushqim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Dukagjinit në Gllogjan e në vende të tjera. Siç duket, forcat serbe i kishin rënë në gjurmë aktivitetit të tyre, ndaj për këtë i ekzekutuan në mënyrën më barbare. Vëllezërit Bakir (1967) e Adem Gjukaj (1971), me profesion automekanikë, u varrosën më 25 korrik në varrezat e qytetit në Pejë. Pas përfundimit të luftës është ngritur kallëzim penal kundër dy serbëve, pjesëmarrës në vrasjen e vëllezërve Bakir e Adem Gjukaj.

⁷³ Shih *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 28, 66.

⁷⁴ Shih adresën në internet <http://www.mup.sr.gov.yu; Zloçini...>, vep. e cit., f. 116.

* Këso kohe në Parkun “Karagaç” të qytetit të Pejës ishin të stacionuara Njësitë Speciale Policore serbe të OPG-së dhe të “Munja”-s. Shih foton ilustrative në shtojcën *Faksimile e fotografi*.

⁷⁵ Shih *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 40-41, 67.

SERBËT, PASI E VRASIN PLAKËN 75- VJEÇARE, KRIMIN E SHPALLIN VEPËR TË "TERRORISTËVE SHQIPTARË"

Në publikimin e "Jedinstvo"-s, "*Zloçini albanskih terorista (1995-1998)*" për plakën shtatëdhjetë e pesë vjeçare Gjyle Hajdari thuhet: "Në fshatin Drenoc të Klinës, më 16 shtator 1998 është gjetur e vdekur Gjyle Hajdari (75), të cilën e vranë terroristët. Plaka ka jetuar vetëm në shtëpi dhe nuk ka dashur ta lëshojë fshatin e shtëpinë nën presionin e terroristëve, të cilët trupin e saj, për ta fshehur krimin, e kanë hedhur në bunar".⁷⁶ E vërteta është se *Gjyle (Islam) Hajdari**, nga Drenoci i Klinës, është vrarë ditën e ndërmarrjes së ofensivës së forcave serbe kundër banorëve të këtij fshati, më 28 - 29 qershor 1998, kur në luftime për mbrojtjen e popullatës bien edhe dy dëshmorë të lirisë: *Jakup Sokol Agushi* (1963) dhe *Skënder Ymer Ademi* (1947). Eshtrat e Skënder Ademit në janar të vitit 2005 janë kthyer në Kosovë, pasi u gjetën në varrezat masive në Serbi. Në sulmin kundër Drenocit u mobilizuan edhe civilët serbë. Plaka Gjyle Hajdari nuk kishte mundur të largohet nga

⁷⁶ *Zloçini...*, vep. e cit., f. 81, 117.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Gjyle Hajdari, është e radhitur me numrin rendor 41. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 115).

shtëpia. Banorët e këtij fshati dëshmojnë se ajo është vrarë e masakruar nga kriminelët serbë Goran Markoviq dhe Milovan Stepiq nga Drenoci, e pastaj është hedhur në bunarin (pusin) e shtëpisë së vet. Kufoma e saj në pus ka qëndruar deri më 18 shtator të atij viti, kur është varrosur në varrezat e qytetit të Pejës. Rasti i vrasjes dhe i masakrimit të Gjyle Hajdarit nuk është i vetmi. Janë me qindra raste anekënd Kosovës, të vrasjeve e masakrimeve të pleqve, madje edhe të atyre të paralizuar kudo që kanë hyrë forcat serbe, të cilat, pasi i kanë ekzekutuar, disave ua kanë djegur kufomat në zjarr, disa i kanë hedhur në puse, disa i kanë lënë të digjen për së gjalli në zjarret e shtëpive të tyre.

Edhe emri i *Halil Berishës* nga fshati Irzniq, komuna e Deçanit, në publikimet e MUP-it serb figuron si "qytetar i pakicës shqiptare" i rrëmbyer dhe i vrarë nga "terroristët shqiptarë".⁷⁷ Mirëpo, një gjë e tillë nuk qëndron.

Halil (Sadik) Berisha, i lindur më 12 dhjetor të vitit 1941, që pas shpërthimit të luftës frontale në rajonin e Rrafshit të Dukagjinit, më 24 mars 1998, në Glllogjan, së bashku me banorët e tjerë të fshatit masovikisht i janë përgjigjur kushtimit të luftës. Të gjithë banorët me një kompaktësi të veçantë kanë ndihmuar luftën në të gjitha drejtimet, si në vijat e para të frontit ashtu edhe në prapavijë. Në këtë mes duhet theksuar se Spitali Ushtarak i Zonës Operative të Dukagjinit të UÇK-së ishte i vendosur pikërisht në shtëpinë

⁷⁷ Shih librin *Zloçini...*, vep. e cit., f. 127, dhe adresën zyrtare të MUP-it serb në internet.

e Halil Berishës. E gjithë familja e gjerë Berisha ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm sa i përket kujdesit ndaj të plagosurve dhe në mbarëvajtjen e punëve në spital, pa kursyer asgjë. Edhe Halil Berisha ka dhënë kontribut të çmuar në këtë drejtim, por edhe duke qenë ushtar-rojë në Spitalin Ushtarak që nga muaji maj deri më 11 gusht 1998. Vritet nga forcat serbe ditën e fundit të ofensivës së gjerë, e ndërmarrë kundër Gllogjanit dhe fshatrave të tjera përreth, më 12 gusht 1998, derisa ishte duke vëzhguar shtëpinë-spital. Kufoma e tij është gjetur pas më se një muaji në vendin e vrasjes, pikërisht më 17 shtator 1998.

Dinë Çekajn, nga Irzniqi i Deçanit, MUP-i serb e paraqet si “viktimë të terroristëve shqiptarë”. E vërteta është se profesori i kimisë **Dinë (Miftar) Çekaj**, i lindur më 13.3.1951, ka qenë pjesëtar i UÇK-së, i angazhuar në Shtabin lokal të fshatit Irzniq, prej 24 prillit '98 deri më 10 gusht të atij viti, kur pasoi ofensiva më e rreptë e forcave serbe. Dinë Çekaj është vrarë nga forcat policore-paramilitare serbe, më 23 shtator 1998, ndërmjet fshatrave Dujakë e Skivjan, derisa po kthehej në Irzniq. Paraprakisht ishte ndaluar në punktin e tyre në vendin e lartëcekur.

Edhe pse shpifjet dhe gënjeshttrat, duke i përsëritur vazhdimisht, duke i lansuar në drejtime të ndryshme, tentojnë t'i paraqesin si të vërteta, një gjë e tillë nuk mund të qëndrojë. Prandaj, nuk thuhet kot se e vërteta është një dhe e pamohueshme.

KRIMI MAKABËR NË RAKOVINË

Në adresën zyrtare të MUP-it të Serbisë (<http://www.mup.sr.gov.yu>) edhe për qytetarin **Sylë Qufaj** (1922), nga Prejlepi i Deçanit, thuhet se është vrarë nga “terroristët shqiptarë”, që nuk është e vërtetë. Plaku Sylë (Pajazit) Qufaj është ekzekutuar nga forcat pushtuese serbe më 11 gusht 1998, gjatë ofensivës së gjerë të ndërmarrë nga forcat serbe.⁷⁸ Kufoma e tij është gjetur më 4 tetor 1998, me kokë të prerë, koka në oborr e trupi brenda në shtëpi.

Edhe për **Nimon Idrizajn**⁷⁹ nga Strellci i Epërm, komuna e Deçanit, në burimet e lartëcekura serbe thuhet se është vrarë me armë zjarri nga “terroristët shqiptarë” dhe se trupi i tij është gjetur më 29 dhjetor 1998, rreth orës 8.15 min në afërsi të ndërmarrjes “Molika” në Raushiq. As ky lansim i MUP-it dhe i mediave serbe për këtë vrasje makabre nuk qëndron, për arsye se pikërisht në kohën dhe vendin ku është vrarë Nimon Idrizaj ka qenë i vendosur njëri prej postblloqeve më famëkëqija të policisë e paramilitarëve serbë, ku janë vrarë, torturuar e arrestuar dhjetëra shqiptarë. Nimon (Hasan) Idrizaj (1943) është ekzekutuar më 29 dhjetor 1998 nga policia serbe, pikërisht në punktin e saj në Raushiq të Pejës.

⁷⁸ Të dhëna të KMDLNJ-së në Deçan dhe të familjarëve të Sylë Qufajt.

⁷⁹ Në librin **Zlogini...** është i paraqitur si **Hasan Idrizaj**, f. 118.

Veton Kelmendi, nga fshati Pavlan i Pejës, thuhet se është vrarë “me armë zjarri nga terroristët shqiptarë”. Ndërkaq, duke iu referuar burimeve në terren dhe atyre të KMDLNJ-së në Pejë, del qartë se Veton (Zymer) Kelmendi* (1969), nga fshati Pavlan i Pejës, më 2 janar 1999, është ekzekutuar nga forcat policore serbe, të cilat pas krimit kufomën e tij e kanë hedhur në fshatin Gllaviçicë, përbri rrugës magjistrale Pejë-Prishtinë.⁸⁰

Në faqen zyrtare të MUP-it serb, vrasjen makabre të të riut **Blerim Balaj**, nga fshati Strelci i Poshtëm, ia adresojnë UÇK-së. Aty thuhet se Blerimi është vrarë “me armë zjarri nga terroristët shqiptarë”. E vërteta rreth këtij rasti është se Blerim (Avdi) Balaj (1972) nga Strelci i Poshtëm, komuna e Deçanit, është ekzekutuar nga policia serbe më 6 janar 1999, në punktin policor në Zall të Strelcit. Fillimisht, policët serbë të veshur në rroba të bardha, pasi ia kishin rrethuar shtëpinë, arrijnë ta zënë të gjallë dhe e marrin me vete para syve të nënës së tij, duke e dërguar në punktin e policisë serbe, që atëbotë ishte i vendosur në pompën e benzinës në Strelci, bri rrugës magjistrale Deçan-Pejë, vetëm disa dhjetëra metra nga shtëpia e Blerimit, ku e ekzekutojnë barbarisht. Blerimi ishte nga ata të rinj shqiptarë që refuzoi t’i përgjigjet thirrjes për të shkuar në shërbimin ushtarak të

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Veton Kelmendi është i radhitur me numrin rendor 308. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 125).

⁸⁰ Shih *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, f. 63; *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 82.

të ashtuquajturës A(P)J, prej nga çdo ditë ktheheshin në arkivole të rinjtë shqiptarë. Para luftës ishte ndër aktivistët e dalluar në fshatin e tij, për ç’gjë shpeshherë u kërkua dhe u përdoq nga policia serbe. Ishte student i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës. Ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i angazhuar në shtabin lokal të fshatit të tij prej 25 majit 1998 deri më 7 shtator 1998, kur dorëzimin e armëve te forcat pushtuese serbe, të organizuar në atë kohë, e kundërshtoi me tërë qenien. Udhëtoi edhe në Shqipëri, për t’i sjellë armët e lirisë. Blerim Balaj ishte kthyer në shtëpi për të rënë në kontakt me bashkëluftëtarët, për t’iu bashkuar shokëve të tij në frontet e luftës, por kthimit të tij i kishte rënë në gjurmë policia serbe, e cila e ekzekutoi barbarisht.

Vrasjen e studentit **Osman Gashi**, nga Barani i Pejës, MUP-i serb ua adreson “terroristëve shqiptarë”. Mirëpo e vërteta është se Osman (Brahim) Gashi (1976), student i Universitetit të Prishtinës, është vrarë më 31 janar 1999 nga shpërthimi i bombës, të cilën policët serbë e aktivizuan brenda në çebaptoren “Beqa” në Prishtinë, rast ky i bërë publik nga media shqiptare dhe ato ndërkombëtare.

Për qytetarin **Musa Molliqaj**, në adresën e lartëcekur (adresën zyrtare të MUP-it serb <http://www.mup.sr.gov.yu>) thuhet se është vrarë me armë zjarri nga “terroristët shqiptarë”. Mirëpo e vërteta qëndron krejtësisht ndryshe. Musa Molliqaj (1947), nga fshati Llukë e Epërme është vrarë nga policia serbe më 25 janar 1999, rreth orës 19, në Llukë të

Epërme, ndërsa është plagosur rëndë i biri, Skënderi (1974), përderisa me veturë po ktheheshin nga Lluka e Poshtme për në shtëpinë e tyre. Edhe vëzhguesit e OSBE-së kishin dalë në vendin e ngjarjes.⁸¹

Edhe vrasja e trefishtë e kryer nga policia serbe ndaj tre civilëve shqiptarë: *Albert Sejdiqaj*, *Fazli Morina* dhe *Ali Pajazitaj* u vëhet në barrë “terroristëve shqiptarë”. Mirëpo, dihet fare qartë se Albert (Demë) Sejdiqaj (1973), nga fshati Lëbushë i Deçanit, Fazli Morina (1969), nga Graboci i Pejës dhe Ali (Asllan) Pajazitaj (1972), nga Isniqi i Deçanit, më 5 shkurt 1999, janë vrarë nga policia serbe që kishte zënë pusi tek “Ura e Haxhinjve”, në mes të fshatrave Isniq e Llukë e Epërme, përderisa nga Isniqi po udhëtonin me veturën e tyre në drejtim të fshatit Llukë e Epërme.⁸²

Aparatura e ish-pushtuesve serbë, edhe krimin e rëndë të kryer mbi pesë civilë shqiptarë në Rakovinë, në rrugën magjistrale Gjakovë-Klinë, ku forcat policore serbe vranë *Shaban Kelmendin*, *Hysen Kurtin*, *Sanije Kurtin*, *Besim Kelmendin* dhe *Haxhi Kelmendin*, në mesin e të cilëve dy fëmijë të mitur dhe një grua, krim ky makabër i kryer vetëm nëntë ditë pas masakrës së Reçakut, përpiqet t’ia vërë në barrë UÇK-së apo siç i quajnë ata “terroristëve shqiptarë”, edhe pse e vërteta e këtij rasti, që tronditi mbarë opinionin shqiptar e ndërkombëtar, dihet botërisht.

⁸¹ Informatë e transmetuar në Radion “Kosova e Lirë”, më 27 janar 1999; të dhëna të KMDLNJ-së.

⁸² Informatë e transmetuar në Radion “Kosova e Lirë” më 7 shkurt 1999.

Dihe se civilët shqiptarë *Shaban (Tafë) Kelmendi* (1953), nga Rakovina, me fëmijët *Besim (Shaban) Kelmendi* (12) e *Haxhi (Shaban) Kelmendi* (11) dhe *Hysen Kurti* (1959), nga Cermjani, dhe gruaja e tij, *Sanije Kurti* (1964), janë vrarë e masakruar nga policia serbe më 24 janar 1999, rreth orës 19, afër urës së Rakovinës, përderisa ishin duke udhëtuar me traktor (me rimorkio të mbushur me tallë) prej Rakovinës për në Cermjan tek familja e Hysenit. Ata u goditën me armatim të rëndë të kalibrave 12.7 mm dhe 7.62 mm, por me këtë nuk u mjaftuan xhelatët serbë. Trupat e viktimave ishin të goditur edhe me mjete të mprehta nga afërsia. Dihet se postblloku i Kramovikut ka qenë i njohur për mizoritë mbi popullatën e kësaj ane. Të nesërmen, më 25 janar, në vendin e krimit kishin dalë edhe vëzhguesit e OSBE-së, ndërsa forcat serbe të njëjtën ditë u tërhoqën nga vendi i krimit. Duhet theksuar se ata janë vrarë në një kohë kur nuk kishte luftime, kur viktimat nuk sulmuan askë, kur viktimat nuk ishin të armatosur, por që iu nënshtruan vdekjes mizore për fajin e vetëm – pse ishin shqiptarë.

Vrasjen tek Ura e Rakovinës, Misioni Verifikues i OSBE-së, e cilësoi si “një akt kriminal dhe mizor që nuk mund të tolerohet”. “*Verifikuesit e KVM-së që shkuan në vendin ku ndodhi ky incident i tmerrshëm u tronditën nga mizoria e pakuptimtë që është shfaqur aty. Duket se mbi viktimat është shtënë me më shumë se 200 fishekë*”. Ky ishte një akt i qëllimshëm për të frikësuar njerëzit dhe për të minuar përpjekjet e atyre “që po mundohen të arrijnë një zgjidhje të

qëndrueshme politike të konfliktit” në Kosovë, thuhet, ndër të tjera, në kumtesën për shtyp të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë.⁸³ Ndërkaq, ministri serb, vrasjen e pesëfishtë në Rakovinë përpigj ta mbulonte me një gënjeshtër të pakripë se ishte fjala për një “*aksident trafiku*”!⁸⁴

Pushtuesit serbë, pos organizimit dhe likuidimit të njerëzve me influencë, pos vrasjeve në pabesi të luftë-tarëve të lirisë, të intelektualëve, sa herë që iu dha rasti bënë edhe vrasje masive, pa marrë parasysh faktin se a ishin kundërshtarë apo përkrahës të tyre, vetëm pse ishin shqiptarë. Zhdukën fshatra të tëra duke mos kursyer as pleqtë e fëmijët, duke aplikuar format më barbare të shfarosjes masive.

“Serbët nuk kishin luftuar vetëm kundër atyre që i quanin “terroristë të organizatës së vetëquajtur UÇK”, por edhe kundër civilëve të paarmatosur dhe të pambrojtur. Për këtë janë vërtetuar dhe tashmë dëshmojnë edhe të gjithë hetuesit ndërkombëtarë që kanë punuar dhe punojnë në Kosovë. Ata janë të bindur se skuadronet serbe të vdekjes kanë vrarë dhe masakruar civilë që nuk kanë pasur kurrfarë lidhesh dhe UÇK-në”.⁸⁵

Gjatë luftës së fundit, ku gjurmët e barbarisë serbe në Kosovë ende janë të freskëta, kur plagët ende kullojnë gjak,

⁸³ Shih gjerësisht <http://www.kosova.com>, QIK, Informatori ditor nr. 2315, i datës 19 janar 1999: *MVK: Vrasja në Rakovinë “akt kriminal e mizor”*.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Shih gjerësisht raportin e *American Radio Works*-it, përkitazi me masakrën e Çyshkut.

ashtu sikurse edhe gjatë luftës, edhe pas saj, ish-pushtuesit serbë kanë vënë në shërbim të gjitha mjetet e metodat për njollosjen e luftës çlirimtare të popullit të Kosovës që e zhvilloi në krye me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për t’u çliruar nga robëria serbe, me tendenca të hapta për mohimin e karakterit çlirimtar të saj, duke mos mundur të pajtohen me pavarësinë e Kosovës dhe shkëputjen e saj nga Serbia, edhe pse tashmë ekziston si realitet.

Radha e emrave të civilëve shqiptarë të vrarë gjatë luftës në Kosovë në forma të ndryshme nga forcat pushtuese serbe, të ushqyera skajshmërisht ndër kohëra me nacionalshovenizëm serbomad, me pikësynim - formimin e Serbisë së Madhe (ëndërr e serbëve që nga koha e Dushanit), është e gjatë. Është karakteristike se asnjëherë nuk zgjodhën mjete dhe metoda për realizimin e këtij qëllimi. Edhe më tutje, vrasësit, bëmat e tyre famëkëqia dhe krimet mizore përpigjën t’ia vënë në barrë UÇK-së.

Fatkeqësisht shpifjet e tilla të ish-pushtuesve serbë kanë dhënë rezultate, kur është fjala për ndëshkimet që po u bëhen çlirimtarëve të Kosovës në emër të drejtësisë.

Në adresën zyrtare të MUP-it të Serbisë (<http://www.mup.sr.gov.yu>) edhe qytetari **Emin Basha** nga Peja para-qitet si viktimë e “terroristëve shqiptarë”. Mirëpo, sipas burimeve shqiptare, duke iu referuar edhe dëshmive të

KMDLNJ-së, del se Emin (Faik) Basha* (1962), nga lagjja Sahat Kullë e Pejës, është kidnapuar nga forcat policore serbe në Pejë dhe është vrarë me armë zjarri nga policia serbe, më 31 janar 1999, në fshatin Ramun të Pejës.⁸⁶

Për qytetarin **Çaush Çesta** në publikimet e MUP-it serb thuhet se është vrarë nga “terroristët shqiptarë”. Ndërkaq dihet se Çaush Çesta (1965), nga Juniku, komuna e Deçanit, u plagos rëndë nga forcat serbe më 2 qershor 1998 derisa bashkë me familje po udhëtonte me qerre në drejtim të fshatit Batushë. Atë të plagosur rëndë e dërgojnë në spitalin e Gjakovës, ku të nesërmen vdes nga plagët e marra, nën mbikëqyrje të rreptë të forcave të shumta të policisë serbe.

Emri i qytetarit **Ekrem Binakajt** (1958), nga Peja, figuron në listat e MUP-it të Serbisë, si “viktimë e terroristëve shqiptarë”.⁸⁷ Mirëpo e vërteta është se Ekrem Binakaj është vrarë nga forcat serbe në fshatin Kryshec të Pejës në fund të majit të vitit 1998, pikërisht pas datës 29 maj, gjatë ditëve të ofensivës së forcave serbe kundër fshatrave të Lugut të Baranit (Kryshec, Vranoc etj.). Kufoma e tij, ashtu sikurse edhe kufomat e shumë qytetarëve të tjerë shqiptarë, mbeti mbi dhe për muaj të tërë, deri në shtator të vitit 1998, kur varroset në varrezat e qytetit të Pejës.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Emin Basha është i radhitur me numrin rendor 76. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 118).

⁸⁶ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 82.

⁸⁷ *Zloçini...*, vep. e cit., f. 127; adresa zyrtare e MUP-it serb në internet <http://www.mup.sr.gov.yu>.

Për plakën **Nazmije Hoti**, nga Peja, në librin e botuar nga “Jedinstvo” thuhet se “është vrarë nga terroristët shqiptarë”, dhe se “trupi i saj është gjetur më 7 korrik 1998, në lagjen Berzhenikë (Dardania 1), përkaj rrugës magjistrale Pejë -Deçan”.⁸⁸ E vërteta është se plakën 70-vjeçare, Nazmije Hoti*, forcat serbe e kanë vrarë në shtëpinë e vet, gjatë kthimit për në Pejë, pas humbjeve që kishin pësuar në betejën e zhvilluar më 6 korrik 1998, në Loxhë.⁸⁹ Të rikujtojmë se të njëjtën ditë, duke iu referuar dëshmime të KMDLNJ-së në Pejë, vetëm në lagjet Dardania I, II, III, forcat serbe dëbuan nga shtëpitë e tyre rreth 12 000 banorë shqiptarë. E bashkë me ta edhe rreth 6 000 refugjatë të ikur nga vatrat e luftës nga komuna e Deçanit. Të njëjtën ditë, forcat serbe kanë plaçkitur shumë shtëpi, kanë rrahur e maltretuar qindra qytetarë. Kanë djegur disa shtëpi e kanë granatuar mbi 20 të tjera.⁹⁰ Ndërsa gjatë vitit 1999 këto lagje pësuan rëndë nga terrori dhe masakrat barbare që kryen forcat policore-ushtarake e paramilitare serbe mbi popullatën civile, ku shumica prej të ekzekutuarve edhe sot e kësaj dite kufomat i kanë të zhdukura.

Për plakun **Ukë Haxhia** nga fshati Brovinë, komuna e Gjakovës, në publikimet serbe thuhet se është vrarë nga “terroristët shqiptarë”. Mirëpo, një gënjeshtër e tillë nuk

⁸⁸ *Zloçini albanskih terorista (1995-1998)*, vep. e cit., f.116.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Nazmije Hoti është i radhitur me numrin rendor 26. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 114).

⁸⁹ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 66.

⁹⁰ Po aty, f. 37.

qëndron. Pasi që plaku Ukë Haxhia kishte mbetur pa u larguar nga shtëpia për shkak të sëmundjes së rëndë dhe pleqërisë së thellë, edhe pas ofensivës së forcave serbe dhe zhvillimit të luftimeve të rrepta në rajonin e Rekës së Keqe. Si shumë plaka e pleq të tjerë, Uka mbytet nga forcat serbe. Kufoma e tij gjendet tek në muajin tetor 1998, kur në Kosovë ishin të pranishëm edhe vëzhguesit ndërkombëtarë.

Në publikimin e MUP-it të Serbisë në internet thuhet se “*Haçim Koçan (1943)* (bëhet fjalë për Halime Koçanin, me kombësi boshnjake - v. jonë) nga Zllapeku, komuna e Pejës, është zhdukur nga terroristët shqiptarë më 9 mars 1999, në orën 6.” Ndërkaq e vërteta është se *Halime (Zahto) Koçan** (56) është vrarë nga forcat serbe gjatë sulmit që ndërmorën këto të fundit kundër fshatit Dardan (ish Zllapek), më 9 mars 1999.⁹¹

Në publikimin e “*Jedinstvo*”-s, edhe për qytetarin *Qelë Deskaj*, nga Adriani (ish Kliçina) thuhet se është vrarë nga “terroristët shqiptarë” më 24 prill 1998, edhe përkundër faktit se dihet botërisht rasti i vrasjes së tij, vrasje kjo e bërë në pikë të ditës.

Më 24 prill të vitit 1998, rreth orës 12, mbi njëqind policë serbë, me automjete të ndryshme kishin hyrë në fshatrat e

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë periudhës janar-qershor 1999*, ku Halime Koçan është e radhitur me numrin rendor 202. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit. më lartë, f. 122).

⁹¹ Shih për këtë gjerësisht librin *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës mars-qershor 1999*, vep. e cit. f. 55.

Lugut të Leshanit: Kliçinë, Jabllanicë e Leshanit, Rosujë, Potërq e fshatra të tjera të kësaj ane, duke shtënë me armë zjarri nëpër rrugët e këtyre fshatrave. Gjatë këtij operacioni kishin hyrë edhe nëpër shumë shtëpi të fshatit Kliçinë, ku rrahën e maltretuan shumë qytetarë. Me atë rast policia serb vrau Qelë (Shaban) Deskajn⁹² (1941), nga Kliçina, baba i pesë fëmijëve, i cili sapo kishte dëgjuar të shtënat kishte dalë nga shtëpia për të parë se ç’po ngjet me fëmijët të cilët ishin në shkollë. Aty u plagosën edhe nxënësit Afrim H. Berisha (17) dhe Afrim A. Berisha (17) nga Kliçina. Ndërsa në Jabllanicë u rrahën e maltretuan mizorisht Naim (22) e Jeton Abazi (17). Kurse Fekë Hatashit i shkaktuan lëndime të rënda, duke e rrahur e maltretuar para anëtarëve të familjes së tij. Edhe në ditën e varrimit të Qelë Deskajt, disa civilë serbë të fshatrave Babiq e Gorozhdec, disa qytetarëve të fshatrave Dobërdol e Kërstovc, iu kërcënuan se do t’i vrasin me armë zjarri, pse po shkonin për të marrë pjesë në varrimin e Qelë Desku, me ç’rast e rrahën dhe e keqtrajtuan rëndë Isuf Kastratin nga Dobërdoli.⁹³

Në “listat” e viktimave për vrasjen e të cilëve MUP-i serb akuzon “terroristët shqiptarë” gjendet edhe emri i *dr. Nuredin Zejnullahut*⁹⁴ (49), internist në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Duke iu referuar dëshmime të buri-

⁹² Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Qelë Desku është i radhitur me numrin rendor 2. (Libri *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 114).

⁹³ Shih *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb ...*, vep. e cit., f. 19.

⁹⁴ Shih listat e MUP-it serb në adresën në internet; “*Zloçini...*”, vep. e cit., f. 96, 117.

meve shqiptare, dihet se internisti i njohur dr. Nuredin Zejnullahu*, është vrarë nga forcat serbe, të cilat e sul-muan në shtëpinë e tij, në mbrëmjen e 18 nëntorit të vitit 1998, me ç'rast plagosën lehtë edhe vajzën e tij 17-vjeçare. Dr. Nuredini nuk u rezistoi dot plagëve vdekjeprurëse. Ndërroi jetë, pas disa orësh, gjatë rrugës për në spitalin e Prishtinës.⁹⁵

Edhe për të riun shqiptar **Rifat Blakaj** (1979), nga fshati Trubuhovc, komuna e Burimit (ish Istogut), në faqen zyrtare të MUP-it serb, thuhet se është vrarë me armë zjarri nga "terroristët shqiptarë". Duke iu referuar burimeve të KMDLNJ-së, del se njëzetvjeçari Rifat Blakaj, më 7 janar 1999, ishte nisur nga fshati i tij për në Istog për të rregulluar biçikletën. Biçikleta e tij është gjetur në fshatin Prekallë (fshat ky i njohur për numrin e madh të krimine-lëve serbë), bri rrugës Gurrakoc-Pejë. Rifati ishte rrëmbyer nga forcat serbe në Prekallë, të cilat e dërguan dhe e vranë me armë zjarri në fshatin Drenoc të Klinës, ku, në atë kohë, ka banuar vetëm popullata serbe, pasi që popullata shqiptare ishte dëbuar me dhunë nga shtëpitë e veta që nga 28 qershori i vitit 1998. Kufoma e tij u gjet të nesërmen, më 8 janar 1999, në vendin e ekzekutimit, në Drenoc.

Edhe për luftëtaren e dalluar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, **Mervete (Sali) Maksutaj** (20), e cila ra hero-i kisht

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë vitit 1998*, ku Nuredin Zejnullahu është i radhitur me numrin rendor 42. (Libri "*Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*", vep. e cit., f. 115).

⁹⁵ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 57.

më 4 dhjetor 1998, në krye të aksionit për shpëtimin e bashkëlufëtareve të plagosur nga kthetrat e xhelatëve serbë, që mbaheshin nën kontrollin e rreptë të policisë serbe në spitalin e Pejës, thuhet se është vrarë nga "terroristët shqiptarë". Ndër të tjera në librin "*Zloqini...*" thuhet: "...Me këtë rast sulmuesi e vrau edhe terroristen që kishte ardhur me të dhe që e kishte hedhur bombën, Mervete Maksutajn (20) nga fshati Orrobërdë i Istogut. Tek ajo janë gjetur pllakat me shenjat "UÇK" dhe data e hyrjes në atë organizatë terroriste si dhe dy bomba dore dhe një revole".⁹⁶

Ky rast nuk do koment! Gënjeshtria nuk ka brirë! Mervete Maksutaj, dëshmore e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është vrarë nga njësia e snajperistëve serbë, që ishin të pozicionuar në ndërtesat përreth spitalit të Pejës.

Krimineli Sllobodan Millosheviq gjatë gjykimit në Tribunalin e Hagës, siç është parë, gjithnjë përpiqet që krimet e kryera nga forcat pushtuese serbe t'ua ngarkojë "terroristëve" të UÇK-së. E njëri nga rastet e tilla të shumta, është edhe rasti i vrasjeve të kryera në Jabllanicë të Leshanit, mbi fëmijët **Gentrit Sheqeri**, 4-vjeçar, dhe **Bukurie Morina**, 15-vjeçare.

E vërteta është krejtësisht ndryshe. Në mëngjesin e 29 marsit të vitit 1999, kur forcat serbe, si të tërbuara, në mbarë Kosovën po vrisnin, masakronin, digjnin e dëbonin me dhunë, duke bërë spastrime etnike, ndërmarrin një ofensivë

⁹⁶ *Zloqini...*, vep. e cit., f. 103.

të gjërë edhe kundër fshatrave të Lugut të Leshanit. Dhe, siç dihet nga të gjithë ata që e kanë përje-tuar luftën, spastrimeve të këmbësorisë gjithnjë u prinin granatimet e fuqishme. Në Jabllanicë kishte të strehuar banorë edhe të fshatrave tjera të komunës së Klinës. Me të filluar bombardimet nga forcat serbe, banorët e Jabllanicës së Leshanit, kush si mundet, nisin të largohen nga fshati, për t'i shpëtuar asgjësimit serb, duke u futur në zonat më të thella. Pjesëtarët e familjeve Sheqeri, Morina e Bardheci, me t'i dëgjuar granatimet dhe urdhërin e prerë të forcave serbe për ta lëshuar fshatin, ashtu siç qëllonë hipin në rimorkion e traktorit, për t'u larguar nga fshati. Në ndërkohë një granatë e forcave serbe qëllon rimorkion e tyre, me ç'rast vriten *Gentrit Demë Sheqeri* (4), nga Adriani (ish-Kliçina) dhe *Bukurie Rexhep Morina* (15), nga Rigjeva e Klinës. Ndërkaq, plagosen edhe *Resmije Rexhep Morina* (11), nga Rigjeva; *Kosovare Demë Sheqeri* (11), nga Kliçina; *Kumrije Bardheci* (12) nga Fushëlumi (ish-Grabanica) dhe *Zize Malë Sheqeri* (70), nga Adriani (ish-Kliçina).⁹⁷

Ata detyrohen që të gjallë e të vdekur të zbresin nga rimorkio e traktorit. Të marrin një qerre me kalë, dhe ashtu nëpër predhat e artilerisë serbe, nëpër mot të lig, duke i rrahur shiu gjatë tërë rrugës, të nisen drejt fshatrave më të thella të Dushkajës. Pasi arrijnë në Jabllanicë të Gjakovës, që kontrollohej nga UÇK-ja, të plagosurve u jepet ndihma e

⁹⁷ "Kosova Press", 29 mars 1999. Shih edhe librin e KMDLNJ-së, *Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*, vep. e cit., f. 75.

parë ndërsa të vrarët (Gentriti dhe Bukuria) varrosen nga fshatarët dhe pjesëtarët e UÇK-së, pranë xhamisë së fshatit. Plaka Zize Sheqeri kishte bërë kilome-tra të tëra, e plagosur në këmbë, por nuk i ndiente plagët, nuk e ndiente dhembjen kur shihte nipin e mbesën e saj të vrarë barbarisht nga serbët. Familjarët Morina, ishin kushërinj të afërm të Sinan Morinës nga Rigjeva, luftëtar i dalluar i UÇK-së, i cili pak ditë më vonë bie heroikisht në përleshje me forcat serbe në frontin e luftës në Dashinoc të Deçanit.

LOJA ME KARTËN E PËRÇARJES FETARE

Në publikimin e "Jedinstvo"-s, "Zloçini..." dhe në atë të MUP-it të Serbisë, si civilë të vrarë nga "terroristët shqiptarë" figurojnë edhe emrat e *Prenë* (1931) e *Mire* (1934) *Merturit* dhe *Prekë* (1932) e *Prende* (1935) *Krasniqit* - të gjithë shqiptarë nga fshati Meqe i Gjakovës. Ata, vetëm pse janë të besimit katolik, organet e MUP-it serb nuk i paraqesin as si shqiptarë, por si "*qytetarë të bashkësive tjera nacionale, civilë, të vrarë nga terroristët shqiptarë*".⁹⁸

Mirëpo, as akuza e vënë në barrë të UÇK-së për vrasjen e *Pren S. Merturit* (1933), *Mire K. Merturit* (1934), *Prekë Sh. Krasniqit* (1935) dhe *Prene M. Krasniqit* (1932) nuk

⁹⁸ *Zloçini...*, vep. e cit., f.119.

qëndron. Që të katërt së bashku edhe me dy bashkëfshatarë të tjerë, **Zef (Gjon) Krasniqi** (1940) dhe **Pjetër T. Krasniqi** (1935), janë vrarë e masakruar nga forcat pushtuese serbe në Meqe, gjatë ofensivës që ndërmorën kundër këtij fshati, më 2 gusht të vitit 1998. Madje, Zef Krasniqi që në fillim të muajit korrik 1998 ishte i armatosur dhe i kyqur në kuadër të mbrojtjes së fshatit. U vra derisa po bënte tërheqjen e familjes nga fshati.

Edhe emri i mjekut dr. Xhevdet* Gashit (1953), nga Peja, figuron si “person i vrarë nga terroristët shqiptarë”. Mirëpo, siç bëjnë të ditur burimet e KMDLNJ-së, **dr. Xhevdet (Sylë) Gashi** është kidnapuar nga forcat serbe më 20 janar 1999 në Pejë dhe është gjetur i vrarë të nesërmen (më 21 janar), në fshatin Prekallë të komunës së Istogut.⁹⁹

Edhe emri i qytetarit **Muharrem Bytyqi**, nga Sferka e Pejës, figuron në “listat” serbe si qytetar i vrarë nga “terroristët shqiptarë”. Mirëpo, burimet shqiptare, përfshirë edhe ato të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), vërtetojnë se Muharrem (Ukë) Bytyqi* (43), nga fshati Sferkë, është vrarë më 11 janar 1999

* Në listat serbe figuron si **Xhevat**.

⁹⁹ *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb mbi popullatën shqiptare në regjionin e Pejës gjatë vitit 1998*, vep. e cit., f. 82.

* Shih *Listën e popullatës civile të vrarë në komunën e Pejës nga forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe gjatë periudhës janar-qershor 1999*, ku Muharrem Bytyqi është i radhitur me numrin rendor 363. (Libri “*Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*”, vep. e cit., f. 127).

nga pjesëtarë të organizatës terroriste serbe “Dora e Zezë”, afër fshatit Ramun.¹⁰⁰

VRASËSIT E AGANIT, SIPAS DANICA MARINKOVIQIT, KISHIN “KRYER ME NDER PUNËN E VET”

Është trumbetuar nga mediat serbe, nga organet e MUP-it serb dhe ato “të drejtësisë” se politikani dhe sociologu i njohur **Fehmi Agani** është vrarë nga pjesëtarët e UÇK-së. Mirëpo, siç dihet, profesor Agani është vrarë nga forcat policore serbe më 6 maj 1999. Profesori i Universitetit të Prishtinës, dr. Fehmi Agani, nënkryetar i atëhershëm i LDK-së, pjesëmarrës në Konferencën e Rambujesë, ka paraqitur rrezik dhe pengesa për zhvillimet e mëtejshme për palën serbe, edhe për vetë faktin se ka qenë i përgatitur në shkallën superiore profesionale dhe se i ka takuar një familjeje të njohur atdhetare, si nip i luftëtarit të devotshëm, prijësit të njohur të çetave kaçake Mulla Aganit, i njohur jo vetëm në rajonin e Plavës e Gucisë, por edhe më gjerë. Dhe, njëkohësisht, vrasjen e Aganit kanë dashur t’ia “lënë në derë” UÇK-së, edhe pse është kryer në një terren

¹⁰⁰ “*Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës...*”, vep. e cit., f. 76; *Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb...*, vep. e cit., f. 82.

që nuk ka qenë nën kontrollin e kësaj të fundit dhe ku asgjë nuk ka të bëjë me të. Një gjë të tillë e ka pranuar dhe publikuar edhe Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH), përkatësisht kryetarja e këtij fondi, Natasha Kandiç, duke precizuar edhe emrat e policëve vrasës: **Predrag Nikoliq** dhe **Zoran Gjeletoviq**.

Siç është bërë publike më herët edhe nga mediat kosovare, për këtë çështje gjykatësja Danica Marinkoviq,* ish-gjykatëse hetuese e Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, e dalluar për një dekadë të tërë për dënimet drakonike të shqiptuara ndaj të arrestuarve shqiptarë, bashkëpjesëmarrëse në shumë krime që regjimi i Millosheviqit kreu në Kosovë, FDH-në dhe Natasha Kandiçin i akuzon për gënjeshtër. Sipas gjykatëses Marinkoviq, policët serbë, Predrag Nikoliq dhe Zoran Gjeletoviq, e kanë “kryer me nder punën e vet” - dhe se “vrasjen e kanë bërë pjesëtarët e UÇK-së”.¹⁰¹

Ndërkaq, Natasha Kandiç, duke iu përgjigjur reagimit të Danica Marinkoviqit, thotë: “Me qëllim të ndriçimit të vrasjes së Fehmi Aganit po i publikoj faktet që pamohueshëm zbulojnë të vërtetën se si “e kanë kryer me nder punën e vet” në Kosovë policët e përmendur. Të njëjtët pjesëtarë të policisë, Predrag Nikoliq dhe Zoran Gjeletoviq, të njëjtën ditë kur është vrarë z. Agani, më 6 maj 1999 në hekurudhën Lipjan - Fushë-Kosovë,

* Danica Marinkoviq edhe më tutje kryen të njëjtin funksion në të njëjtën gjykatë, të zhvendosur pas luftës në Nish të Serbisë.

¹⁰¹ Natasha Kandiç, *Gjyqtarja urdhëroi vrasjen e të plagosurve në Likoshan*, “Koha”, 8 mars 2002; “Kosova e Lirë”, 8 mars 2002.

kanë vrarë pesë anëtarë të familjes Blakqorri: Miradijen (54), Fehmiun (60) dhe të birin e tyre Labinotin (14), Mahmutin (56) dhe bashkëshorten e tij Sabilen (50). Kundër policëve të përmendur, sikur edhe kundër Ivan Ivanovit, po ashtu pjesëtar i policisë nga Fushë-Kosova, SPB-ja në Prishtinë, më 27 maj 1999, ka ngritur padi penale (Ku.nr.546/99). Dokumentacioni përcjellës, përfshirë kërkesën e prokurorisë për kryerjen e hetimeve, vendimin për hetim dhe paraburgim, është transferuar në Serbi apo është shkatërruar. Gjykatësja Danica Marinkoviq e paraqet veten si mbrojtëse të viktimave dhe të policisë serbe. Ky manipulim i saj me opinionin publik është betejë e humbur për të. Brenda po asaj policie dihet e vërteta rreth vrasjes së Fehmi Aganit. Dihet se kush çka ka bërë në Kosovë, kush ka shtënë, kush i ka mënjeluar kufomat, kush e ka marrë me kamionë pronën e huaj, kush i ka marrë personalisht urdhëresat beogradase dhe i ka përcjellë mirënjohjet dhe përkrahjen e presidentit. Ata që kanë marrë pjesë në krim dhe fshehjen e autorëve, në emër të mbrojtjes së Serbisë nga bombardimet e NATO-s dhe në emër të popullit serb, sot përpilojnë listat e tradhtarëve nga radhët e tyre dhe organizojnë përcjelljen e tyre. Gjykatësit që kanë qenë anëtarë të shtabeve të krizës përpiquen t'i shlyejnë gjurmët që tregojnë se kanë qenë prezentë në mbledhjet e shtabeve. Disa gjykatës, prokurorë dhe shefa të policisë po i shkatërrojnë dokumentet e mbetura që mund t'i zbulojnë ata, po i falsifikojnë dokumentet dhe po e provojnë fuqinë e heshtjes kosovare”, thekson ndër të tjera Kandiç, për të shtuar: “Muri i heshtjes është çarë seriozisht. Ka çdo ditë më shumë policë që flasin rreth asaj se çka ka ndodhur në

Kosovë. Nga ata kam dëgjuar që urdhëresat për likuidim nuk i kanë dhënë vetëm komandantët e njësiteve policore dhe ushtarake. Ata më kanë thënë se **personalisht Danica Marinković ka urdhëruar likuidimin e disa meshkujve të plagosur të familjes Ahmeti, më 28 shkurt 1998 në fshatin Likoshan.** Në hetimet në vendin e ngjarjes ajo ka ardhur në përcjellje të zëvendësit të prokurorit publik të qarkut, Jovica Jovanović, dhe punëtorëve të policisë kriminalistike. Para shtëpisë së familjes Ahmeti gjendej turma e kufomave. Disa meshkuj jepnin shenja jete. Në praninë e rreth 30 pjesëtarëve të njësiteve speciale antiterroriste, gjykatësja hetuese Danica Marinković thuhet se ka thënë: **“Unë këta nuk i marr, vrisni”.** Atyre u është dhënë fundi me hekler. Hetimi në vendin e ngjarjes nuk është bërë. Më 1 mars 1998, katërmëdhjetë kufoma janë transferuar në spitalin e Prishtinës. Gjykatësja hetuese nuk ka dhënë urdhër për obduksion, kështu që kufomat, pas identifikimit, u janë dorëzuar familjes. **Pjesëtarët e policisë, pjesëmarrës të aksionit në Likoshan, thonë se pushkët dhe bombat janë vendosur më vonë pranë kufomave të të vrarëve dhe se ky falsifikim ka shërbyer për informimin e opinionit.”** Natasha Kandiç sqaron edhe rreth ndalimit të saj në punktin e policisë serbe në Lipjan më 27 maj 1999, ditën kur është publikuar aktakuza kundër Slobodan Millosheviqit, kur policët e kërcënojnë me akuzën për spiunim. “Gjatë kohës së bombardimeve, derisa qëndroja në Kosovë, më së shumti u jam frikësuar policisë serbe, formacioneve paramilitare dhe mbrojtësve të tillë të serbëve çfarë është Danica Marinković. Në heshtjen e

cila mbretëronte në Serbi dhe në Kosovë, secili që do të përpiqej t’u ndihmonte shqiptarëve ishte armik, spiun dhe tradhtar. Policia dhe serbët e Kosovës ishin të dehur me lejen e pushtetit që Serbinë ta mbrojnë me të gjitha mjetet. Në një atmosferë të tillë shumë më pak i jam frikësuar kalimit të urave sesa policëve që i shihja prapa kolonave të refugjatëve, pranë shtëpive të djegura apo në punktet e kontrollit. Secilën herë kur kaloja pranë tyre pa kontrollim të dokumenteve ndjehesha si një fatlume e madhe. Por, më 27 maj 1999, në ditën kur është publikuar aktakuza kundër Slobodan Millosheviqit, policia më ndaloi në punktin në Lipjan. Isha nisur për në Prizren që të nxjerr bashkëshorten dhe fëmijën e redaktorit të “Kohës ditore”. Së pari m’i kërkuan dokumentet personale, më pas e bastisën automjetin, në bagazh gjetën raportet e FDH-së rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe menjëherë e thirrën Sigurimin Shtetëror. Në një shtëpi, ku ishte e vendosur policia, dy inspektorë më kanë marrë në pyetje disa orë. Vozitësin tim e mbanin të ndarë nën kërcënimin se do ta vrasin sikur edhe secilin person tjetër që flet anglisht. Kur u kam treguar se ku jam nisur dhe pse, filluan të bërtasin se jam spiune, tradhtarë dhe se nuk do të më lejojnë që të transferoj shqiptarë. Më kanë kërcënuar me akuzën për spiunim. **Më frikësonin se do të më gëlltis terri, dhe se ata do të publikojnë se jam zhdukur në territorin e UÇK-së.** I pyeta të mendojnë rreth asaj se sa do të ishte bindës lajmi për zhdukjen e një aktivisteje për të drejtat e njeriut në ditën e publikimit të aktakuzës kundër Millosheviqit. M’i kërkonin të hollat që kisha me vete. Refuzova, duke i udhëzuar që mund të m’i marrin sikur që bëjnë me shqiptarët.

Nuk e bënë atë, edhe pse kanë mundur. Drejtpërsëdrejti u thashë se nuk do të hesht rreth asaj që ka ndodhur në Kosovë dhe se tashmë publikisht kam thënë se policia e ka vrarë Fehmi Aganin. Në përmendjen e Aganit, njëri inspektor tha se ky ishte "gabim", por se pranoi që policët serbë e kanë vrarë Aganin. Isha krejtësisht e pajtuar me mundësinë që do të zhdukem sikur edhe shumë të tjerë ato ditë në Kosovë. Nuk u kam borxh falënderim që nuk më kanë vrarë. Më kanë lëshuar vonë në mbrëmje, kur është paraqitur inspektori i tretë me vendimin nga Beogradi se nuk jam rast i tyre",¹⁰² përfundon Kandiq.

Shembuj të shumtë se si Serbia përpiqet t'i mbulojë krimet duke mohuar krimet që i ka bërë vetë, madje edhe duke ua mvëshur shqiptarëve, përkatësisht UÇK-së, pos burimeve të lartëcekura, gjenden edhe në një libër tashmë të botuar, por pa autor dhe të lansuar edhe në internet në çirilicë (në PDF). Në të janë dhënë emrat e qytetarëve të vrarë në pjesën e parë dhe emrat e të kidnepuarve dhe të humburve në pjesën e dytë. Në pjesën e parë të këtij libri, ku flitet për shqiptarët e vrarë (1.1.2 Albanci) jepet sqarimi se "për të dhënat në kapitullin 1.1.2 dhe 2.1.2 janë shfrytëzuar materialet e MUP-it serb". Pra, nga kjo mund të shihet qartë se jo vetëm burim i informacionit, por edhe përpilues i këtij libri pa autor është kreatorja e krimeve serbe në Kosovë – vetë MUP-i serb.¹⁰³ Në vazhden e falsifikimeve të shumta të

¹⁰² N. Kandiq, *Gjyqtarja urdhëroi vrasjen e të plagosurve në Likoshan*, "Koha", 8 mars 2002; "Kosova e Lirë", 8 mars 2002.

¹⁰³ Bedri Halimi, *Kështu po spekulon MUP-i serb me 9 shqiptarët e vrarë në masakrën e Tususit*, "Fokusi", 2 prill 2004, f. 9.

MUP-it serb lidhur me vrasjet e civilëve shqiptarë janë edhe spekulimet me nëntë (9) shqiptarët e vrarë nga forcat serbe në masakrën e Tususit në Prizren, për të cilët thuhet: "**Abdulmezit Behar** nga Prizreni, rr. e Rugovës 6, i lindur më 1980, nga babai Sami, është vrarë në paralagjen e qytetit "Tusus" në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 27 (dëshmia 485/99-70, 485/99-81); **Abdulgjegjit Rafet**, nga Prizreni, rr. e Rugovës 6, i lindur më 22.11.1947, nga babai Vahid, është vrarë në paralagjen e qytetit "Tusus" në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr.24 (dëshmia: 485/99-22, 485/99-70, 485/99-77, 485/99-81, 288/00-5); **Abdulgjegjit Sami** nga Prizreni, rr. e Rugovës 6, i lindur më 11.04.1951, nga babai Vahid, është vrarë në paralagjen e qytetit "Tusus" në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 23 (dëshmia: 485/99-22, 485/99-70, 485/99-77, 485/99-81, 288/00-5); **Abdulgjegjit Shefik** nga Prizreni, rr. e Rugovës 6, i lindur më 1978, nga babai Samiu, është vrarë në paralagjen e qytetit "Tusus" në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 21. (dëshmia: 485/99-22, 485/99-70, 485/99-81, 288/00-5); **Arifi Ajrim** nga Prizreni, rr. e Sllovenisë 2, i lindur më 27.07.1977 nga babai Rahmani, është vrarë në paralagjen e qytetit "Tusus" në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 10 (dëshmia: 485/99-22, 485/99-70,

485/99-77, 485/99-81, 485/99-82, 288/00-5); **Osmani Mirsad** nga Prizreni, rr. e Dedinjes, p.n, i lindur më 1977, nga babai Isak, është vrarë në paralagjen e qytetit “Tusus” në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 22 (dëshmia: 485/99-22, 485/99-70, 485/99-77, 485/99-81, 288/00-5); **Sulejmani Hurmesh** nga Prizreni, rr. e Dedinjes p.n, i lindur më 1967, nga babai Nijaz, është vrarë në paralagjen e qytetit “Tusus” në Prizren me rastin e sulmeve terroriste në pjesëtarët e policisë. Kufoma është shënuar me nr. 25 (dëshmia: 485/99-70, 485/99-81); **Çengaj Bislim** nga Prizreni, rr. e Dedinjes 23, i lindur më 2.03.1921, në fshatin Plajnik, komuna e Dragashit nga babai Nebi, trupi i të cilit është gjetur më 29.05.1999 në rrugën e Dedinjes nr.23 në katin përdhesë me dëmtime të dukshme në pjesën e kokës. Janë konstatuar dëmtimet vdekjeprurëse të shkaktuara nga armët e zjarrit me rastin e pushkatimit (dëshmia: 485/99-22, 485/99-78, 485/99-79, 485/99-81); **Çengaj Selvinas**, nga Prizreni, rr. e Dedinjes 23, i lindur më 7.06.1923, në fshatin Bresanë, komuna e Prizrenit nga babai Isljam, trupi i të cilës është gjetur më 29.05.1999 në rrugën e Dedinjes nr.23 në katin përdhesë me dëmtime të dukshme në pjesën e kokës. Janë konstatuar dëmtimet vdekjeprurëse të shkaktuara nga armët e zjarrit me rastin e pushkatimit (dëshmia: 485/99-22, 485/99-78, 485/99-79, 485/99-81).¹⁰⁴

¹⁰⁴ B. Halimi, *Kështu po spekulon MUP-i serb...*, pun. i cit. më lartë.

Me këtë rast serbët përpos gënjeshtreve se i kanë vrarë shqiptarët, kanë bërë edhe falsifikime të tjera si në biografi, vit të lindjes, vend të lindjes etj., ndonëse qartë bëhet fjalë për persona të njëjtë. Kështu, te **Behar Abdylmegjiti**, që mban numrin rendor 1 edhe në këtë libër, është ndryshuar mbiemri nga Abdylmegjiti në Abdylmezit si dhe viti i lindjes nga 1981 në vitin 1980. Ka qenë nxënës; te **Rafet Abdylmegjiti** që në këtë libër mban numrin rendor 2, mbiemri shkruhet në rregull por është ndryshuar viti i lindjes nga 1948 në 1947. Nuk thuhet se ka lindur në Bresanë të komunës së Dragashit, baba i katër fëmijëve, vritet në masakrën e “Tusushit” nga paramilitarët serbë së bashku me vëllain Samiun dhe djemtë e vëllait: Beharin e Shefkijun, kushëririn e parë Hyrmet Sylejmanin dhe djalin e dajës Mirsat Osmanin; te **Sami Abdylmegjiti** që në këtë libër mban numrin rendor 3, nuk thuhet se e ka kryer Shkollën e Lartë Ekonomike në Pejë dhe se është i lindur në fshatin Bresanë të Dragashit, me vendbanim në Prizren; **Shefik Abdylmegjiti** ishte student, i cili pasi ishte dërguar me dhunë për të punuar në hapjen e istikameve në Sharr, pas një muaji lirohet, dhe pas katër ditësh ekzekutohet më 26 maj në Tusus; **Ajrim Arifi** nga fshati Kuk, komuna e Dragashit me vendbanim në Prizren, student i historisë, ekzekutohet në shtëpinë e tij në ditën e masakrës së Tusushit. Në këtë libër mban numrin rendor 16; **Mirsat Osmanit** që në libër mban numrin rendor 158, nga fshati Kuk komuna e Dragashit me vendbanim në Prizren, i është ndryshuar

edhe viti i lindjes nga 1975 në 1977. Edhe ky një muaj para se të vritej në masakrën e Tususit është shfrytëzuar me dhunë për hapjen e istikameve në Sharr për forcat serbe; *Hyrmet Sylejmani*, i cili në këtë libër mban numrin rendor 192, përpos që i është ndryshuar viti i lindjes nga 1964 në 1967, i është ndryshuar edhe emri nga Hyrmet në Hurmesh. Ishte i lindur në Bresanë të Dragashit, me vendbanim në Prizren, baba i dy fëmijëve. Në prill të vitit 1999 merret nga policia serbe dhe dërgohet në Sharr për të hapur istikame. Pas një muaji e lirojnë dhe vendos që të qëndrojnë në shtëpi. Më 26 maj, pasi ia djegin shtëpinë e pushkatojnë në oborrin e shtëpisë së Vahit Abdylmegjinit së bashku me kushërinjtë e vet: Rafetin, Samiun, djemtë e Samiut, Shefkion e Beharin si dhe djalë e dajës Mirsatin në masakrën e Tususit; *Bislim Çengaj* nga Pllajniku i Dragashit, që në libër e mban numrin rendor 224 ka jetuar në Prizren, nuk kishte pranuar që të shpërngulej në Shqipëri, ka qëndruar në shtëpi bashkë me të shoqen Selvinazen, e cila në këtë libër mban numrin rendor 225. Në ditën e masakrës së Tususit, më 26 maj 1999, pasi është plaçkitur, është ekzekutuar në shtëpi të vet bashkë me të shoqen Selvinazen.¹⁰⁵

Për masakrën e Tususit ende nuk është marrë askush në përgjegjësi, madje as nga Tribunali i Hagës.¹⁰⁶

¹⁰⁵ B. Halimi, po aty.

¹⁰⁶ Po ai, po aty.

MBULIMI I KRIMEVE TË KRYERA NË KOSOVË, SHKATËRRIMI DHE ZHDUKJA E DËSHMIVE

Dëshmitë për krimet dhe mizoritë serbe të kryera gjatë luftës së fundit në Kosovë janë publikuar nga agjensi të shumta vendore e ndërkombëtare. Megjithatë, qeveria serbe është përkujdesur që të bën “demantime zyrtare” për shumicën e rasteve të vrasjeve dhe masakrave mbi shqiptarët. Karakteristikë e të gjitha këtyre “demanteve” është e pavërteta, gënjeshtër, shpifja, trillimi, falsifikimi.

Në mars të vitit 1998, në Prekaz të Drenicës, familja Jashari me gjakun, qëndresën dhe sakrificën e saj po shkruante historinë e pashembullt. Atëherë kur forcat serbe po vrisnin e masakronin dhe me artileri të rëndë po e digjinin flakë Prekazin, nga Beogradi si gjithnjë, paturpësisht e në mënyrë cinike lansoheshin gënjeshtër tradicionale se viktimat (gratë, pleqtë e fëmijët) nuk po i vrisnin forcat serbe, por po i vriste vetë “terroristi” Adem Jashari (!).

Janë tepër skandaloze dhe absurde pohimet se masakrën e Reçakut e kryen “terroristët” e UÇK-së, apo se e “montoi” ambasadori Uoker; se masakra në Burgun e Dubravës ku u ekzekutuan mizorisht nga forcat serbe rreth 200 të burgosur

shqiptarë nuk ishte masakër por një “shfaqje horror” që iu montua Serbisë; se krimin të Ura e Rakovinës e kryen “terroristët” e UÇK-së, apo se ishte fjala për një “aksident trafiku” (!), për të mos përmendur edhe një mori rastesh tjera të vrasjeve e masakrave masive e individuale. Prej tyre, edhe shumë emra të ish-luftëtarëve të UÇK-së.

Pos pjesëtarëve të UÇK-së, të përmendur më herët në këtë publikim, edhe emrat e *Hyzri Tallës, Ilir Durmishit, Afrim Maliqit*, humanistit të njohur *Shpëtim Robajt*,¹⁰⁷ e dhjetëra të tjerëve, figurojnë në listat serbe si “*qytetarë të pakicës shqiptare, civilë, të vrarë nga ‘terroristët shqiptarë’*”(!).

Por, kështu nuk mund të demantohen krimet serbe. Edhe pse tradicionalisht janë përpjekur ta bëjnë një gjë të tillë. Ato janë tepër të vërteta, makabre, trishtuese sa nuk mund të fshehen.

Kur në muajin dhjetor 2004, në Gjyqin e Hagës u paraqit historiani serb Sllavenko Tërziq në mbrojtje të kriminelit Slllobodan Millosheviq, katërcipërisht mohoi masakrat e kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë. Prokurori i Hagës i përkujtoi dëshmitë e gjeneralëve Uesli Klark dhe Klaus Nauman, të cilëve Millosheviqi në vitin 1998 u kishte thënë: “Do të tuboj e të vras të gjithë shqiptarët, ashtu siç është vepruar në vitin 1945/46 nga Aleksandër Rankoviqi”. Terziqi mohoi: “Kjo deklaratë është gënjeshtër. Në fund të Luftës së Dytë

¹⁰⁷ Shih librin “*Zloçini albanski...*”, e cit. më parë, f. 117; adresën zyrtare të MUP-it serb <http://www.mup.sr.gov.yu>.

Botërore nuk është ekzekutuar në Kosovë asnjë shqiptar” (!). Pikërisht në atë kohë janë të dokumentuar 70 mijë shqiptarë të vrarë e të masakruar.¹⁰⁸

“Qeveria e përparshme e Republikës së Serbisë është detyruar të pranon ekzistimin e varrezave masive sekrete në Serbi me kufoma shqiptarësh të Kosovës dhe ka urdhëruar zhvarrimin (ekshumimin), që ka përfunduar në dhjetor të vitit 2002. Deri në fund të vitit 2004 Republika e Serbisë ia ka dorëzuar UNMIK-ut 374 kufoma të identifikuar nga 834, sa janë zhvarrosur nga shtatë varreza masive. Asnjë procedurë penale nuk është hapur rreth krimeve ndaj shqiptarëve të Kosovës, trupat e pajetë të të cilëve janë gjetur në varrezat masive në Serbi, dhe zhvendosjes së kufomave në Serbi”.¹⁰⁹

Deri më sot, Serbia ka dorëzuar të mbeturat e vetëm 374 shqiptarëve nga Kosova, të gjetur në varrezat masive në Batajnicë, Petrovo Selo dhe Peruqac.¹¹⁰ Sipas Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore, prej se autoritetet serbe kanë filluar të kthejnë në Kosovë mbetjet mortore të shqiptarëve të viktimizuar gjatë luftës, të ekshumuar nga varrezat masive në Serbi, afro 10 për qind të këtyre eshtrave kanë ardhur të pakompletuara. Për më keq, në shumë raste në një thes plastmasi me mbetje

¹⁰⁸ S. Krasniqi, *Akademikët serbë - piromanë të Ballkanit*, pun. i cit. më lartë.

¹⁰⁹ Komunikatë e Fondit për të Drejtën Humanitare, *FDH kërkon hetime për krimet në Kosovë dhe për varrezat e tjera masive në Serbi*, “Zëri”, 25 dhjetor 2004, f. 5.

¹¹⁰ *FDH: Zyrtarët shtetërorë të Serbisë po pengojnë zbulimin e së vërtetës për djegien e trupave të shqiptarëve të Kosovës*, “Zëri”, 4 shkurt 2005, f. 5.

mortore ka pasur përmbajtje të eshtrave nga disa persona, gjë që ka vështirësuar shumë punën rreth identifikimit të tyre.¹¹¹ *“Më e keqja është kur në një qese ka 2 koka apo 3 këmbë!”*¹¹²

Fshehja e krimeve të luftës, të kryera në Kosovë, gjatë vitit 1998 dhe gjatë bombardimeve të NATO-s, para së gjithash ka qenë vepër e policisë, të cilën e kanë kryer njerëzit më të besueshëm të ministrit të ndjerë të policisë **Vlajko Stoilkoviq**, ish-kryeministrit serb **Nikola Shainoviq**, kryeshefit të Sigurimit Publik të MPB-së, **Vlastimir Gjorgjeviq** dhe ish-kryeshefit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, **Rade Markoviq**,¹¹³ thekson drejtoresha e FDH-së, Natasha Kandiq. Në jug të Serbisë person i besueshëm ka qenë **Dragomir Tomiq**, zyrtar i lartë i Qeverisë dhe Parlamentit të Serbisë në kohën e Millosheviqit, sot pronar i kompanisë “Simpò”, me mirëkuptimin dhe përkrahjen e të cilës është organizuar transporti i kufomave nga Kosova në rajonin e Vranjës dhe Surdullicës. Ndërsa në zbatimin e kësaj “detyre patriotike”, nga Kosova përmes Bujanocit, ishin angazhuar pjesëtarët e Njësitit për Operacione Speciale, kryeshefat lokalë dhe shefat e Sigurimit Shtetëror dhe drejtori i fabrikës “Maçkatica”, në Surdullicë”.¹¹⁴

¹¹¹ Art. *Sipas Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore: Afro 10 për qind të eshtrave të kthyer nga Serbia vijnë të pakompletuar!*, “Zëri” 7 shkurt 2005, f. 2.

¹¹² Po aty.

¹¹³ Komunikatë e FDH-së, *UDB dhe “Beretat e Kuqe” i kanë djegur kufomat e shqiptarëve në Surdulicë*, “Koha Ditore”, 25 dhjetor 2004, f. 1.

¹¹⁴ Po aty.

Gjatë bombardimeve të NATO-s trupat e pajetë nga Kosova, ndër të tjera, janë transportuar edhe përmes Bujanocit. Kufomat janë varrosur nëpër shpella në lokacione të cilat nuk kanë qasje në potezin Bujanoc – Vranjë ose janë djegur në fabrika dhe xeherore në furrat që zhvillojnë temperaturë të nevojshme për shkatërrimin e plotë të dëshmvive. Përmenden dërgesat e kufomave në shkritoren e Borit, hekurandën e Smederevës, pastaj djegia e kufomave në minierën e Trepçës dhe në termocentralet e Obiliqit në Kosovë. Informatat e fundit, që i kanë arritur FDH-së, zbulojnë se gjatë majit të vitit 1999, në dy raste të ndara, në organizim të shërbimit lokal të Sigurimit Shtetëror, janë djegur kufomat në fabrikën “Maçkatica” në Surdullicë (vend jo larg Vranjës).¹¹⁵

Alarmin për djegien e kufomave të shqiptarëve në Termocentralet e Obiliqit dhe në minierën e Trepçës e kishte dhënë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) me seli në Prishtinë, që në verën e vitit 1999, por në këtë drejtim nuk është ndërmarrë asgjë.

Vendimi për shfrytëzimin e fabrikës “Maçkatica” për djegien e kufomave është marrë pas zbulimit të frigoriferit me kufoma afër Klladovës, në prill të vitit 1999. Në atë kohë organizatorët e “*sanimit të terrenit*” kanë tërhequr urdhërin për groposjen e kufomave të bartura nga Kosova nëpërmjet

¹¹⁵ *FDH kërkon hetime për krimet në Kosovë dhe për varrezat e tjera masive në Serbi*, art. i cit., “Zëri”, 25 dhjetor 2004, f. 5.

Bujanocit, dhe kanë vendosur për teknikë të re të zhdukjes së gjurmëve me anë të djegies së kufomave.¹¹⁶

Mbulimi i krimeve të kryera në Kosovë është organizuar pikërisht nga **Njësitë Speciale të Policisë (Posebne Jedinice Policije - PJP)** dhe grupet e saj operative prej 3 deri në 10 pjesëtarë. Të gjitha këtyre grupeve, detyrat u janë caktuar nga ish-shëfi serb për Siguri Publike, **Sreten Lukiq**, ish-komandanti i Xhandarmërisë, **Goran Radosavleviq**, dhe koloneli **Novica Zdravkoviq**, i cili ishte shëf i policisë në Bujanoc, ndërkaq tani është këshilltar i Ministrisë të Brendshme serbe.¹¹⁷

Detashmenti i 37-të i PJP-ve, në përbërje të policëve nga Nishi, Leskovci, Vranja dhe Surdullica, kishte për detyrë mbledhjen dhe transportimin e kufomave nga Kosova në drejtim të Serbisë, përmes Bujanocit. Pak para hyrjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë, Detashmenti i 37-të është urdhëruar që të kthehet në Serbi dhe është ngarkuar me detyrën e shkatërrimit dhe zhdukjes së kufomave nga Kosova. Ky detashment ishte i stacionuar në Petrovo Selo, ku ndodhej edhe selia e Goran Radosavleviqit.¹¹⁸

Sipas urdhërit të Shërbimit për Siguri Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, i kanë marrë kufomat e shqiptarëve nga Kosova dhe i kanë

¹¹⁶ Komunikatë e FDH-së, *UDB dhe "Beretat e Kuqe" i kanë djegur kufomat e shqiptarëve...*, art. i cit. më lartë, "Koha Ditore", 25 dhjetor 2004, f. 2.

¹¹⁷ *FDH: Zyrtarët shtetërorë të Serbisë po pengojnë zbulimin e së vërtetës për djegien e trupave të shqiptarëve të Kosovës*, art. i cit., "Zëri", 4 shkurt 2005, f. 5.

¹¹⁸ Po aty, "Zëri" 4 shkurt 2005, f. 5.

transportuar ato në bazën ushtarake Batajnica, në afërsi të Beogradit.¹¹⁹ Fabrika e Maçkaticës ka katër furra të mëdha elektrike dhe shtatë të tjera më të vogla, për shkrirjen e hekurishteve.¹²⁰ *"Në Surdullicë të gjithë e dinë se në këtë fabrikë, gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s, janë djegur kufomat nga Kosova, mirëpo askush nuk merr guximin të flasë, sepse ende janë në pushtet të gjithë ata të cilët kanë marrë pjesë në këtë."*¹²¹

Sipas dëshmimeve të Fondit për të Drejtën Humanitare, të marra nga shumë burime të pavarura, djegia e kufomave në Fabrikën "Maçkatica" është bërë dy herë, më 16 dhe 24 maj, pas mesnatës nën sigurimin e **"Beretave të Kuqe"**, të cilat në atë kohë e kishin bazën në fshatin Bele Vode, afër Vranjës. **Millorad Lukoviq – LEGIJA**, komandant i atëherëshëm i "Beretave të Kuqe" sipas këtyre shënimeve, personalisht e ka përcjellë një pjesë të kufomave dhe ishte prezent gjatë djegies. Kufomat janë djegur në furrat 4 dhe 5. Gjykuar sipas komenteve në Sigurimin Shtetëror, menjëherë pas djegies së pjesës së parë të kufomave, në mesin e viktimave kishte edhe fëmijë.¹²²

Pranimin dhe organizimin e djegies së kufomave e kanë kryer **Zoran Stoshiq**, në atë kohë kryeshef i Sigurimit Shtetëror për Qarkun e Pcinjit, tash inspektor i përgjithshëm i MPB të Serbisë për Vranjë, Leskovc, Nish dhe

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ Po aty.

¹²¹ "Koha Ditore", 25 dhjetor 2004, f. 1.

¹²² Po aty.

Prokuple, **Bratisllav Milenković**, shef i Agjencisë Informative të Sigurimit (BIA) për Vladačin Han, Surdullicë dhe Bosilgrad, **Dragan Stanković**, shef i Aradhës së Punëve të Brendshme (OUP) në Surdullicë nga viti 1993, **Miroslav Antić**, shef i BIA-s në Vranjë, **Dragan Llakićević**, ish-drejtor i “Maçkaticës”, sot pronar i kësaj fabrike dhe zëvendësi i tij, **Aca Gjorgjević**.¹²³ “Në kohën e arritjes së automjeteve ushtarake TAM 110 me kufoma, **Bratislav Milenković** dhe **Dragan Stanković** e kanë larguar sigurimin e rregullt të fabrikës dhe e kanë vendosur sigurimin policor, nën komandën e **Dragan N. Stankovićit**, **Dragosllav Dikićit**, punëtor i Sigurimit Shtetëror në Surdullicë dhe **Tomislav Velićkovićit**, komandant i policisë në Surdullicë”.¹²⁴

Zyrtarët shtetërorë të Serbisë po pengojnë zbulimin e së vërtetës për djegien e trupave të shqiptarëve të Kosovës, konstaton Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH). Ministri serb i Punëve të Brendshme, **Dragan Jokić** dhe drejtori i Agjencisë së Shërbimit Informativ (BIA) **Rade Bulatović**, janë duke mbrojtur shefat e policisë dhe të BIA-s në Kosovë dhe duke penguar zbulimin e së vërtetës për djegien e trupave të shqiptarëve të Kosovës në fabrikat dhe minierat e Serbisë.¹²⁵ Inspektori i përgjithshëm i Ministrisë së

¹²³ *FDH kërkon hetime për krimet në Kosovë dhe për varrezat e tjera masive në Serbi*, art. i cit., “Zëri” 25 dhjetor 2004, f. 5; *UDB dhe “Beretat e Kuqe” i kanë djegur kufomat e shqiptarëve...*, art. i cit., “Koha Ditore”, 25 dhjetor 2004, f. 2.

¹²⁴ Po aty.

¹²⁵ *FDH: Zyrtarët shtetërorë të Serbisë po pengojnë zbulimin e së vërtetës për djegien e trupave të shqiptarëve të Kosovës*, art. i cit., “Zëri”, 4 shkurt 2005, f. 5.

Brendshme, **Vladimir Bozhović**, ka ndalur procedurën për zbulimin e fakteve rreth Maçkaticës.¹²⁶ Zyrtarëve policorë dhe të BIA-s, për të cilët llogaritet se mund të “flasín”, u është thënë se ata do të ndiqen penalisht “në rast se tradhëtojnë sekretet shtetërore”.¹²⁷

Të humburit dhe të zhdukurit nga Kosova u lanë të trajtohen si “çështje teknike”. Beogradi edhe më tutje vazhdon t’i përdorë për presione politike.

Sipas të dhënave të UNMIK-ut, të publikuara në dhjetor të vitit 2004, 3 192 persona evidentohen të zhdukur, nga të cilët 2 460 janë shqiptarë të Kosovës, 529 serbë dhe 203 persona të grupeve të tjera etnike.¹²⁸ Lidhur me këtë çështje, duke iu referuar burimeve të KMDLNJ-së, del se të zhdukurit në Kosovë kanë dy kategori. Ata që u zhdukën gjatë luftës dhe ata që u zhdukën dhe po zhduken pas luftës. Derisa për kategorinë e parë po negociohet me Beogradin, për të zhdukurit e pasluftës, nuk ekziston një statistikë e saktë. Ka një fryrje të të zhdukurve pas luftës, krahasuar me listën që disponon Këshilli, për personat e minoritetit serb të paraqitur si të zhdukur. Është tepër e vështirë të verifikohet saktësia e informatave të rasteve të të zhdukurve pas lufte, sidomos kur është fjala për serbët.¹²⁹ “Ka lëvizje të tilla të serbëve të cilët posa vendo-sen dikund

¹²⁶ Po aty.

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ *FDH kërkon hetime për krimet në Kosovë dhe për varrezat e tjera masive në Serbi*, art. i cit. më lartë, “Zëri”, 25 dhjetor 2004, f. 5.

¹²⁹ Art. “*Të zhdukur*” dhe *të zhdukur*, “Kosova Sot”, 23 mars 2005, f. 5.

në Serbi, veten e shpallin këtu si të zhdukur”, spikatë KMDLNJ-ja, e bindur se këtë në rastet më të shpeshta e bëjnë ata njerëz të cilët mund të ndiqen një ditë penalisht si të dyshuar për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.¹³⁰ Ekziston një lidhje e mirë koordinimi mes ndonjë instance e cila i informon serbët e krimeve me alarmin e rrezikut ndaj tyre dhe ata posa braktisin Kosovën, shpallen të zhdukur.¹³¹

¹³⁰ Po aty.

¹³¹ Po aty.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT - DËSHMI TË VERIFIKUARA

Përderisa në periudhën pushtuese të Sllobodan Millosheviqit, Perëndimi udhëhiqej nga politika si reagim ndaj veprimeve millosheviqiane, tani realisht ballafaqohet me problemin e formulimit të politikës së vet në Kosovë. Mirëpo, në bërjen e kësaj politike, UNMIK-u ka bërë dhe po bën gabime që reflektojnë porosi dhe pasoja negative. Një nga gabimet më aktuale dhe më me pasoja është përpjekja politike, e cila konsiston në afrimin e palëve të armiqësuar, duke ndarë fajin për luftën në një mënyrë tepër të barabartë. Në favor të këtij formulimi shkojnë edhe arrestimet e bëra nga ndërkombëtarët ndaj aleatëve të vet të dikurshëm, pjesëtarëve të UÇK-së, tani forcë e transformuar në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK), me akuza të cilësuar si “krime lufte”.¹³²

Përpjekjet për një barazim të tillë mes krimeve shtetërore të okupatorëve serbë dhe forcave çlirimtare të UÇK-së, aleate besnike e NATO-s, duhet të kundërshtohen jo vetëm nga skena politike kosovare, por edhe nga UNMIK-u. Kjo duhet të bëhet, nëse jo për shkak të shqiptarëve, për faktin

¹³² Mr.sc. Muhamet Malaj, *UNMIK-u ndërmjet të sotmes dhe të ardhmes së Kosovës*, pun. i cit., “Fokusi”, 2 prill 2004, f. 19.

se serbët po e kultivojnë opinionin se lufta e tyre ishte e drejtë dhe se ata kanë të drejtë që përsëri të kthehen në Kosovë si forcë ushtarake e pushtetore.¹³³

Përpyjekjet për asgjësimin e provave, në njërin anë, dhe shpifjet e gënjeshtërave të ish-pushtuesve serbë, në anën tjetër, janë të përsëritura, jo vetëm në rastin e luftës së fundit, por edhe në kohët e mëhershme. Në njërin anë pushtuesit serbë gjithnjë kanë përdorur pabesinë, shpifjet, gënjeshtërave të trillimet, ndërsa në anën tjetër dhunën, vrasjet, terrorin e gjenocidin. Në shumicën e rasteve vetëm pse kanë qenë shqiptarë, pa marrë parasysh se a kanë qenë kundërshtarë apo përkrahës të tyre. Për ta *“shqiptar i mirë”* konsiderohej vetëm *“shqiptari i vdekur”*.

Për përpjekjet e serbëve për asgjësimin e provave dëshmojnë edhe vlerësimet e disa organizatave ndërkombëtare, kur theksojnë se “shumica dërmuese e krimeve të luftës të kryera në Kosovë gjatë luftës mes UÇK-së dhe forcave serbe dhe jugosllave në periudhën 1998-1999, nuk janë gjykuar ende. Vetëm në periudhën mars-qershor 1999, 90 për qind e shqiptarëve të Kosovës u larguan nga shtëpitë e tyre dhe 850 000 veta u larguan me dhunë nga Kosova. Rreth 40 për qind e shtëpive të civilëve u dëmtuan rëndë ose u shkatërruan plotësisht. Numri total i viktimave të vrara në periudhën mars-qershor 1999 mbetet i paqartë - pjesërisht për shkak të përpjekjeve të qëllimshme të qeverisë jugosllave për t'i agjësuat provat”.

¹³³ Mr.sc. Muhamet Malaj, po aty.

Përpyjekjet e tilla i dëshmon edhe më tutje numri i 3 500 shqiptarëve të zhdukur. Dëshmi e kësaj janë edhe mbetjet e eshtrave të shqiptarëve të masakruar nga forcat serbe që pjesërisht në grupe të vogla po i kthejnë nga varrezat masive në Serbi. Shtrohet pyetja: - Ku janë të tjerët?!

Rastet e trajtuara në këtë publikim janë vetëm disa nga qindra raste të tilla. Prandaj është detyrë e institucioneve dhe organeve kompetente të Kosovës që të merren seriozisht me trajtimin e këtyre çështjeve. Me fakte e të dhëna konkrete t'i kundërvihen propagandës së zezë serbe, në grackën e të cilës jo rrallëherë kanë rënë (me dëshirë apo pa të, me vetëdije apo pa të) edhe disa mediume kosovare.

Çuditërisht, në rastin e Serbisë nuk aplikohen trajtimet që u aplikuan ndaj agresorëve humbës në Luftën e Dytë Botërore. Për shembull, Gjermania hitleriane u nda në dy pjesë – zona e interesit perëndimor anglo-amerikan dhe zona lindore ruse, pra me dy sisteme shoqërore për më shumë se 45 vjet. Ndërkaq, Serbia nuk po trajtohet si palë fajtoresh për nxitjen, nisjen dhe luftën gjenocidiale në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë, por po përkëdhelet si palë ndërluftuese, nga e cila dikush pret paqen (!).¹³⁴

Politika aktuale serbe ndaj Kosovës është e njëjtë me politikën e periudhës së Millosheviqit me dallim që mungon represioni direkt fizik i forcave serbe në pjesën më të madhe të Kosovës. Në pjesën veriore të Kosovës prania e

¹³⁴ Mr.sc. Muhamet Malaj, po aty.

pushtetit paramilitar e policor serb ekziston fuqimisht, i ledhatuar nga UNMIK-u dhe nga bashkësia ndërkombëtare në përgjithësi.¹³⁵ Megjithatë, duhet theksu-ar se shumica e personelit të OKB-së, që veprojnë në Kosovë, në poste të larta, nuk kanë njohuri të duhura për të kaluarën e rajonit, për raportet midis shqiptarëve etnikë dhe elementit kolonial serb në Kosovë, e kjo bën që ata të mos kenë ide, vizion dhe njohuri për të ardhmen e Kosovës.¹³⁶ Duhet të thuhet qartë se politika e UNMIK-ut për Kosovën duhet të formulohet në kombinim me interesat vitale të banorëve të saj, e jo në kërkesa e lutje drejtuar Beogradit që të ndikojë konstruktivisht në proce-set politike në Kosovë, sepse Beogradi këtë të drejtë po e shfrytëzon për destruktivitet edhe ndaj vetë UNMIK-ut dhe Kosovës në përgjithësi.¹³⁷ Kosova sot nuk ka nevojë për pajtime fiktive, por ka nevojë për hapa të vendosur që do ta ndanin atë nga e kaluara e hidhur, pa emocione të nostalgjisë historike dhe pa diskutime të gjata shterpe.¹³⁸

Mbi të gjitha, Kosova ka nevojë për DREJTËSI.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Po aty.

¹³⁷ Po aty.

¹³⁸ Po aty.

FAKSIMILE E FOTOGRAFI

1 SUP Beograd PHONE NO. 1 42020 Feb. 04 1998 10:58AM P1

РЕПУБЛИКА СРБИЈА
МИНИСТАРСТВО УНУТРАШЊИХ ПОСЛОВА
СЕКРЕТАРИЈАТ УНУТРАШЊИХ ПОСЛОВА У БЕОГРАДУ
Одсек за унутрашње послове Полицеја
Београд
Датум 04.02.1998. год.
Београд

СЕКРЕТАРИЈАТ УНУТРАШЊИХ ПОСЛОВА У БЕОГРАДУ
Упутило: 20.02.1998. год.
Одсек за унутрашње послове Полицеја

БЕОГРАД

ПРЕДМЕТ: Службено пријављено ППЈ СУП Београд
које се упућују на посебни податак из интер. деловне Бр. 1998.
од 29.01.1998. године.

На Посебни податак из СУП-а Београда упућују се следећи радници из тог:
22 ОДРЕДА 2 ЧИТА 3 ПОД

ред.бр.	презиво и име	формацијско место	чврн	ЈМБГ
1	Вукотић Драгана	Комунална	ст. наставник	26999014005
2	Адиновић Радослав	Комунална	наставник	96997710057
3	Ђурић Драгана	Комунална	наставник	58097230079
4	Ђурић Драгана	Комунална	наставник	11097537006
5	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	06197572004
6	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	76017791008
7	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	30097011000
8	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	20097011000
9	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	16097011000
10	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	08097011000
11	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	12097011000
12	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	01297011000
13	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	16097011000
14	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	03097011000
15	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	16097011000
16	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	03097011000
17	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
18	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
19	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
20	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
21	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
22	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
23	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
24	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000
25	Тодоровић Драгана	Комунална	наставник	13097011000

Упутило се радницима Бр. 24 (презиво и име).

Поздрављајући Вас,
Жељко Милић
Одсек за унутрашње послове Полицеја

КОМАНДИР ППЈ
Београд

Faksimil i dokumentit intern të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, i datës 4 shkurt 1998, për dërgimin e pjesëtarëve të Njësisë së Veçantë të Policisë (Posebne Jedinice Policije) – PJP nga Beogradi për veprim në komunën e Deçanit

3. ВОД 4 ЧЕТЕ 123 ИНТЕРВЕНТНЕ БРИГАДЕ ППЈ


ЈЕВТИЋ МИЛАН КОМАНДИР ВОДА НАСЕЉЕ ЈУНИК

ПРЕЗИМЕ И ИМЕ	ФОРМАЦИЈСКО МЕСТО	АДРЕСА
1. ПЕРОВИЋ МИЛАН	КОМАНДИР ЧЕТЕ	БЕЛО ПОЉЕ - ГЕТ
2. ТОШИЋ ДРАГО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
3. РАДОШЕВИЋ СТАНИША	ГЕТ	ДЕЧАНИ
4. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	ГЕТ "Р. БАНДЕРИЋА"
5. ТУШИЋ ИГОР	АУТОМАТИЧАР	ГЕТ ВОЈВОДЕ ЈУГОСЛАВИЈЕ
6. ТОШИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	ОПРЕД. Т. 87-272
7. ВУЈАСИЋ ВЕСКО	АУТОМАТИЧАР	ГЕТ
8. ТУШИЋ СТАНИША	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
9. РАДОШЕВИЋ СТАНИША	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807

КОМАНДИР ЧЕТЕ

ПРЕЗИМЕ И ИМЕ	ФОРМАЦИЈСКО МЕСТО	АДРЕСА
1. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	ГОРАЖДЕВАЦ Т. 87-348
2. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	ДЕЧАНИ
3. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
4. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
5. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
6. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
7. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
8. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807
9. РАДОШЕВИЋ РАТКО	АУТОМАТИЧАР	БЕЛО ПОЉЕ Т. 34-807


Faksimil i dokumentit intern të Brigadës Intervenuese 123 të PJP-së, e dislokuar nga Beogradi në Deçan, në fillimshkurtin e vitit 1998




Faksimil i dokumentit intern të MUP-it të Beogradit, i datës 4 shkurt 1998
 ,për dërgimin e përforsimeve policore në Kosovë, përkatësisht në Deçan




Faksimil i regjistrat të pjesëtarëve të Brigadës së Njësisë të Veçanta të Policisë (Posebne Jedinice Policije), të distokuar nga Beogradi në Baballoç të Deçanit, në maj të vitit 1998




Faksimil i "depushës" interne të MUP-it serb të Deçanit, mbase i vetmi i këtij lloji, ku pranohet se pjesëtarë të MUP-it serb, Slobodan Jovanović, më 7.8.1998, ka ekzekutuar në banesën e tyre në qendër të Deçanit, katër civilë shqiptarë: Ajne Zymeraj, Shaban Osaj, Çauš Bajraktari dhe Time Bajraktari. Për këtë vrasje të katërfishtë Jovanović ishte paraburgosur vetëm tri ditë



Faksimil i dokumentit të cilësuar "strogo poverljivo", i KOMANDËS 125 të Brigadave të Motorizuara të Serbisë, i datës 11 gusht 1998, lidhur me veprimet ushtarake të Brigadës së Tretë në Prejlep të Deçanit




Faksimil i dokumentit të cilësuar "strogo poverljivo", i KOMANDËS 125 të Brigadave të Motorizuara të Serbisë, i datës 12 gusht 1998, lidhur me veprimet ushtarake të Brigadës së Tretë në drejtimin Prejlep – Irzniq të Deçanit dhe të Brigadës së Dytë në drejtim të Junikut




Faksimil i "depushës" së MUP-it serb të Deçanit, me informacione të seleksionuara. Nuk lejohet të përcillet "më lart" informacioni i parë në të cilin thuhet se njësitë e PJP-së, të stacionuara në vendbanimin e kolonëve serbomalazezë në Baballoç, kanë hapur zjarr në "terroristët"



Faksimil në dorëshkrim i njësisë terroriste të Vidomir Shalipuri



Faksimil i njësisë terroriste të PJP-së, nënshkruar nga komandanti Vidomir Shalipuri



Faksimil i njësisë policore serbe në Pejë

ЗАДУЖЕЊЕ ЧЛАНОВА КОМИСИЈЕ ЗА ПРАЋЕЊЕ РАДА ЛОКАЛНОГ ОБЕЗБЕЂЕЊА ПО ОКРУЗИМА	
ПЕЋКИ ОКРУГ -	1. Момчило Станојевић 2. Џафер Тука 3. Мухарем Ибро
ПРИЗРЕНСКИ ОКРУГ -	1. Момчило Станојевић 2. Рефик Сенадовић 3. Адем Кохи
КОС. ПОМОРАВСКИ -	1. Милорад Самаринић 2. Веско Пирић 3. Фуад Хоџа
МИТРОВАЧКИ -	1. Ратко Јочић 2. Михајло Недић 3. Зоран Братић
КОСОВСКИ -	1. Милорад Самаринић 2. Пешић Благоје 3. Петрит Костари 4. Михајло Недић
Комисија за формирање локалног обезбеђења	
ПРЕДСЕДНИК Момчило Станојевић	

Faksimil i dokumentit serb me të cilin emërohet Komisioni për formimin e të ashtuquajturës "Policë Lokale" (Lokalno Obezbedjenje) në Kosovë



Librezë e Miodrag Jokiçit- Draganit, kryetar i Lidhjes së Luftëtarëve të Serbisë për Qarkun e Pejës



Falënderim i Korpusit të Likës, dedikuar Miodrag Jokiçit dhe bashkëluftëtarëve të tij, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Bosnjë, gjegjësisht në Republikën e Krainës Serbe

od 30 I / 1993

SPISAK BORACA
KOSMETSKO - TOPLIČKOG DOBROVOLJAČKOG ODREDA

ŠTAB

COMANDANT - Sečević Ratko Kapetan - Prokuplje.
Članik Komandanta - Miletić Mile Kapetan I kl. Priština.
Načelnik Štaba - Damjanović Dragan Kapetan Priština
Pomoćnik načelnika Štaba-Operativac - Đorđević Aleksandar Kap. Prokup
Pom. komandanta za bezbed. i obavešt. - poslova Đabišević Radun kap.
Pom. kom. za posadinu - Čurčić Radovan- Čare Prokuplje.
Oficir za vezu - Marković Milorad Kapetan - Priština.
Operativac Štaba - Marinković Stevan Potporučnik - Priština.
Referent za informacije i adm. poslove - Adamović Katarina-Priština.

PRVI VOD

Komandir - Minić Zeljko Priština
Komandir odeljenja - Krtić Tomo Kosovo Polje
 2. Miletić Božo Priština Kos. Polje
 3. Kovačević Miško Priština Kos. Polje
 4. Vukadinović Goran Priština - " -
 5. Filipović Milovan Priština - " -
 6. Bojić Branko Priština - " -
 7. Milošević Novica Priština - " -
 8. Blagić Biniša Priština - " -
 9. Stojanovska Gordana Priština - " -

DRUGO ODELJENJE 1/2

Komandir odeljenja - Andrić Božidar Priština
 2. Jugović Boško Priština
 3. Jugović Ilija Priština
 4. Jugović Predrag Priština
 5. Ovatković Živorad Priština
 6. Nikčević Branislav Priština
 7. Anđelković Momir Priština
 8. Slavković Vidan Priština
 9. Jovanović Milorad Kos. Polje Priština
 10. Celarić Stanislav Priština
 11. Slavković Milorad Priština
 12. Celarić Damir Priština

- 2 -		
TREĆE ODELJENJE I/3		
LAKEN	Komandir odeljenja - Savić Dragutin	Lipljan
	2. Kostić Goran	Lipljan
	3. Debeljković Nebojša	Lipljan
	4. Mihačević Ljubisa	Lipljan
	5. Lalić Miloš	Lipljan
	6. Lazić Dejan	Lipljan
	7. Stolić Slavisa	Lipljan
	8. Vučković Momčilo	Lipljan
	9. Đikić Milica	Lipljan
ČETVRTO ODELJENJE I/4		
LAKEN	Komandir odeljenja - Avramović Branko	Priština
	2. Smiljić Vasilav	Priština
	3. Petrović Dragisa	Priština
	4. Seković Milo	Priština
	5. Jovanović Zvenko	Priština
	6. Samardžić Slobodan	Priština
	7. Mihačević Dragan	Priština
	8. Jovanović Žarko	Priština
	9. Mirković Mirko	Priština
DRUGI VOD		
VETARIC 54	Komandir voda - Pavićević Dragan	Peć
	2. Ivanović-Mana	Peć - ALEKSIĆ
	Komandir prvog odeljenja - Stijević Momo	Peć
	2. Ivanović Momo	Peć
	3. Stojanović Mionir	Peć
	4. Laban Ranko	Dečane
	5. Ristović Branko	Peć
	6. Cerović Dušan	Peć
	7. Borčević Dragan	Prizren
	8. Ovetković Misko	Prizren
	9. Mihačević Branislav	Prizren
	10. Josić Vukoje	Peć
	11. Krsnić Dragoljub	Peć
	12. Stajić Zoran kurir-samenik Komandanta	Prizren-Orahovac

- 3 -		
VETARIC 54	Komandir drugog odeljenja 2/2 Jokić Miodrag	Peć
	2. Ćirković Dragoljub	Peć
	3. Kovačević Dejan	Peć
	4. Bulatović Slavko	Peć
	5. Martinović Pero	Peć
	6. Mihačević Slavoljub	Peć
	7. Gorković Dragan	Peć
	8. Stajić Milovan	Klina
	9. Šekić Marko	Peć
	10. Obradović Slobodan	Bar
	11. Vučković Nenad	Peć
TREĆI VOD		
LAKEN	Komandir trećeg voda Petrović Živorod	Prokuplje
	Komandir prvog odeljenja III/1 Vidojković Aleksandar	
	2. Kuvelić Sreten	Prokuplje
	3. Kovačević-Denić Srdan	
	4. Grajić Jovica	Prokuplje
	5. Simonović Dragan	
	6. Kujević Milovan	Podujevo
	7. Vukašinović Mile	Podujevo
	8. Blagojević Blažo	Podujevo
LAKEN	Komandir drugog odeljenja III/2 Seferović Slobodan-Prokuplje	
	2. Rukić Zoran	Kuršumlija
	3. Tamburkova Vesna	Skoplje
	4. Kovačević Miloje	Prokuplje
	5. Zlatković Saša	
	6. Zlatković Miliša	Prokuplje
	7. Plavo Radjep	Vučitrn
	8. Ilić Momčilo	Prokuplje
	9. Stevanović Tomislav	Prokuplje
	Komandir trećeg odeljenja III/3 Filipović Zvonimir Gnjilane	
	2. Ovetković Velibor	Gnjilane
	3. Ovetković Goran	
	4. Simić Borke	Gnjilane
	5. Stojković Radovan	
	6. Nikolić Aleksandar	
	7. Milenković Nenad	Gnjilane

BORCI RATA 1990-1993 god. KOJI SU RANJENI NA PROSTORIMA REPUBLIKE SRPSKE KRAJINE- BENKOVU.

1. NIKČEVIĆ BRANISLAV	PRIŠTINA
2. STOJMEŃOVSKA GORDANA	PRIŠTINA
3. KRSTIĆ TOMO	KOSOVO POLJE
4. KOSTIĆ GORAN	LIPLJAN
5. TAMBURKOVA VESNA	SKOPLJE
6. ZEČEVIĆ RATKO	PROKUPLJE
7. MIHAJLOVIĆ LJUBIŠA	LIPLJAN

- 4 -

8. Metodijević Žarko	Gnjilane
9. Dunić Srdan	

LOGISTIČKO ODELJENJE

1. Vranić Čedomir	zamenik pomoćnika komandanta za posadinu - Intendant
2. Đorđević Ljubinko	sastavnik Ručovalac za municiju i oružje.
3. Žarković Stanimir	Gračanica
4. Vučković Slavko	Priština
5. Simić Slavko	Prizren
6. Guberinić Danilo	Peć
7. Mihajlović Jordan	Priština

K O M A N D A N T K T D O
KAPETAN
Ratko Zečević

Regjistër prej 4 faqesh i "luftëtarëve vullnetarë" serbë të të ashtuquajturës "Kosovë - Toplicë", pjesëmarrës në të gjitha luftimet në hapësirat e ish-Jugosllavisë, dhe atyre të plagosur në luftime në Benkovc të Krainës serbe, gjatë viteve 1990-1993

REPUBLIKA SRPSKA
MINISTARSTVO OBRANE
VEŠTAČENJE

27. 11. 1993

Delegatët koji su primisli ovu delegaciju

Skupština dana 28. 11. 1993. godine u Prištini u 11. časova.

1. Đorđević Ljubinko	Đorđević Ljubinko
2. Đorđević Srdan	Đorđević Srdan
3. Mihajlović Slavko	Mihajlović Slavko
4. Krstić Miloš	Krstić Miloš
5. Kostić Goran	Kostić Goran
6. Brežević Stanimir	Brežević Stanimir
7. Jokić Miroslav	Jokić Miroslav
8. Stojanović Miroslav	Stojanović Miroslav
9. Nikolić Gavril	Nikolić Gavril
10. Ristić Miroslav	Ristić Miroslav
11. Simić Vasilije	Simić Vasilije
12. Žarković Ivan	Žarković Ivan
13. Arsović Miroslav	Arsović Miroslav
14. Pavlović Dragan	Pavlović Dragan
15. Golatović Dejan	Golatović Dejan
16. Đorđević Miroslav	Đorđević Miroslav
17. Đorđević Miroslav	Đorđević Miroslav
18. Ristić Miroslav	Ristić Miroslav
19. Đorđević Dragan	Đorđević Dragan
20. Đorđević Miroslav	Đorđević Miroslav
21. Nikolić Čedomir	Nikolić Čedomir
22. Nikolić Slavko	Nikolić Slavko
23. Petrović Vlastimir	Petrović Vlastimir


Isključeno na rednim brojevima 13. (Golatović Dejan), 14. (Pavlović Dragan), 15. (Golatović Dejan), 16. (Đorđević Miroslav), 17. (Đorđević Miroslav), 18. (Ristić Miroslav), 19. (Đorđević Dragan), 20. (Đorđević Miroslav), 21. (Nikolić Čedomir), 22. (Nikolić Slavko), 23. (Petrović Vlastimir).

Mihajlović Gavril


Faksimil i listës së delegatëve të Lidhjes së Luftëtarëve të Serbisë prej vitit 1990 për Qarkun e Pejës



Miodrag Jokić – Dragani, gjatë luftës në Kosovë, (nga e djathta)




Факсимил i urdhëresës së KOMANDËS 125 të Brigadave të Motorizuara të Serbisë, i datës 31.12.1998, e shifruar "sekret ushtarak" për aktivizimin dhe përqendrimin e njësive të blinduara në brezin kufitar Kosovë-Shqipëri. Vlen të përmendet se në këtë periudhë vetëm gjatë një muaji janë vrarë e masakruar mbi 100 shqiptarë




Факсимил и документит të UJ-së, për shpërblimin e 11 pjesëtarëve të saj, për meritat e veçanta, të treguara gjatë luftës në Kosovë




*Pjesëtarë të formacioneve serbe, pjesëmarrës në krime kundër shqiptarëve.
I dyti nga e majta në këmbë, Miodrag Jokić – Dragani,
kryetar i Lidhjes së Luftëtarëve të Serbisë për Qarkun e Pejës*





Shtabi i Mbrojtjes Civile në Pejë. (Dorëshkrim i Miodrag Jokiqit – Draganit)





Faksimil i dokumentit të Sekretariatit Federativ të Mbrojtjes (Beograd) - Njësia e Mbrojtjes në Pejë, i datës 24.2.1999, për emrimin e komandantëve dhe kryeshefave të Shtabit të Mbrojtjes Civile në komunat Pejë, Deçan, Istog, Gjakovë e Klinë, nën direktivat e të cilëve u bënë masakra e spastrime etnike në këto rajon






Dislokimi i 150 000 trupave ushtarake serbe në Kosovë, u bë para fillimit të bombardimeve të NATO-s, me qëllim të "spastrimit të terrenit"


Faksimil i dokumentit të shifruar "Тепër Секрет" të Komandës 125 të Brigadave të Motorizuar (Komanda 125 Motorizovanje Brigade), nr. 1183-2, i datës 3 mars 1999, nënshkruar nga kolonel Dragan Zhivanoviq, nëpërmjet të të cilit, 6 Brigadave iu jipen udhëzime për luftë energjike kundër shqiptarëve. Prej tyre, Brigada 2, Brigada 3, Brigada 5 dhe Brigada 6, caktohen për veprim në rajonin e Dukagjinit



Faksimil i planit intern serb, i shifruar "Patkoi", lidhur me operacionin sekret të Serbisë, për shuarjen e kryengritjes dhe ndërrimin e strukturës etnike në Kosovë



Faksimil i dokumentit sekret të Shtabit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, me qendër në Prishtinë, nënshkruar nga gjeneral-nënkoloneli Sreten Lukic, i njohur për urdhërat e dhëna në njësitë të caktuara të PJP-ve për fshehjen dhe zhdukjen e gjurmëve të krimeve



Martirët e fshatit Meqe të Gjakovës, MUP-i serb nuk i paraqet si shqiptarë, por si “qytetarë të bashkësive tjera nacionale, civile, të vrarë nga terroristët shqiptarë”. (Faksimil i librit “Злочини албанских терористов (1995-1998)”, f.119)



U MARTIRIZUAN PËR TË MOS VDEKUR KURRË
Përmendorja e martirëve të Meqes, bri magjistrales Gjakovë-Klinë



FOTOGRAFIA FLET VETË: Pjesëtarë të forcave serbe me popin e kishës (në mes) gjatë kohës së luftës në vendqëndrimin e tyre në Manastirin e Deçanit. (Fotografi e gjetur pas luftës në bazën e forcave serbe në Kooperativën e fshatit Irzniq)



Pjesëtarë të policisë serbe të MUP-it të Pejës. Në mes kryekrimineli Vidimir Shalipuri (nga e djathta)



Terroristë të njësive speciale policore serbe të OPG-së dhe të "Munja"-s. (Fotografuar në Parkun "Karagaç" të Pejës, më 1998)



Terroristë të njësive speciale policore serbe të OPG-së dhe të "Munja"-s në Parkun "Karagaç" të Pejës, më 1998



ESKADRONET E VDEKJES - terroristë të Njësisë “Munja”, pjesëmarrës në krime e masakra anembanë Kosovës



*Kriminelët me damkë të njohur për urrejtje patologjike kundër shqiptarëve fotografohen pas krimeve të kryera mbi popullatën civile. Nga e djathta në këmbë: **Nebojsa Miniqi** - **MRTVI** (“I vdekuri”), në fotografi shihet me një mitraloz të rëndë në duar, i veshur me uniformë policie, i dyti **Vidomir Shalipuri** - **MUNJA**. Ulur në anën e majtë, i pari është **Milan Kaljeviqi** – i njohur si “**Rambo**” e “**Puçrrani**”, një mostër i vërtetë i krimit mbi shqiptarët. Përreth tyre janë kriminelët tjerë të spikatur, komandantë të ndryshëm të njësisë terroriste “**MUNJA**”. Fotografuar në Glogjan të Deçanit, te Blini (flamuri ishte i punuar në trafon e fshatit), pas depërtimit të forcave serbe, më 12 gusht 1998*



Të gjitha forcat serbe kanë patur komandë dhe veprim të përbashkët. Fletëkomunikimi për vrasjen e kriminelit Vidimir Shalipur, me foto në uniformë polici. E përkujtojnë kolegët e tri njësitë që u ka takuar OPG, PJP dhe MUP-i i Pejës



*Kriminelë serbë të njësisë së kombinuar terroriste "Munja" ("Vetëtima") të fotografuar pas krimeve monstruoze, plaçkitjeve, djegieve e shkatërrimeve në rajonin e Pejës.
I pari nga e djathta, krimineli me damkë Srećko Popović*



Kriminelë serbë në aksione monstruoze kundër popullsisë civile shqiptare, të prirë nga Srećko Popović (i pari nga e djathta në këmbë)



Pjesëtarë të ushtrisë serbo-jugosllave, zbatojnë urdhërat për “tokën e djegur” e spastrim etnik



Pjesëtarë të ushtrisë serbo-jugosllave, zbatojnë urdhërat për “tokën e djegur” e spastrim etnik



Kriminelët serbë, gjatë kryerjes së krimeve në Kosovë, kanë keqpërdorur edhe simbolet e UÇK-së



Kriminelët serbë, gjatë kryerjes së krimeve në Kosovë, kanë keqpërdorur edhe simbolet e UÇK-së



Kriminelët serbë, gjatë kryerjes së krimeve në Kosovë, kanë keqpërdorur edhe simbolet e UÇK-së



Kriminelë serbë, pjesëtarë të MUP-it të Deçanit, të fotografuar në Sukë të Baballoçit



Pjesëtarë të Njësisë Speciale të Serbisë, pjesëmarrës në masakra të shumta anekënd Kosovës



Pjesëtarë të njësive paramilitare serbe



Aeroplan ushtarak i tipit "Orao" me të cilin u bombardua Loxha dhe fshatrat tjera të Dukagjinit



Masakra te Ura e Rakovinës



Rogovë e Hasit, 29 janar 1999: Në masakrën e tmerrshme në Rogovë të Hasit dhe në atë të Rakovinës, ka marrë pjesë i njëjti kriminel serb nga Gjakova, siç shihet edhe në fotografitë e "Reuters"-it



Masakra makabre e kryer nga forcat serbe në Rogovë të Hasit, më 29 janar 1999



Masakra makabre e kryer nga forcat serbe në Rogovë të Hasit, më 29 janar 1999



Masakra makabre e kryer nga forcat serbe në Rogovë të Hasit, më 29 janar 1999



Gani Shala nga Ruhoti i Pejës, i zënë rob, i plagosur e i torturuar mizorisht nga forcat serbe. (Fotografuar nga vëzhguesit e OSBE-së, më 28 janar 1999, në Bishtazhin të Gjakovës)



Kriminelë serbë në krye me Millutin Prashçeviqin shqyejnë flamurin shqiptar e bëjnë aheng pas krimeve gjenocidiale që bënë mbi popullatën civile shqiptare në Gjakovë. (2 prill 1999)



Kriminelët serbë, sipas dëshmitarëve, janë fotografuar pasi kryen masakrën mbi familjen Vejse në Gjakovë, më 2 prill 1999.

Të identifikuar janë: 1. Marko Llonqar, 2. Naser Arifaj, 3. Millosh Shqepanoviq, 4. Dragan Raçiq, 5. Ljubisha Rakoçeviq, 6. Boban Baboviq, 7. Sergjan Kërstiq, 8. Rajko Aleksiç, 9. Nenad Bosanac, 10. Millutin Prashçeviq, 11. Lubisha Radunoviq



Pjesëtarë të njërive elite serbo-jugosllave që kanë operuar veçanërisht në brezin kufitar Kosovë – Shqipëri – Mal i Zi, pjesëmarrës në një varg masakrash mbi shqiptarët



*Kriminelë të luftës, dy prej tyre oficerë - mercenarë rusë,
pjesëmarrës në krimet e kryera gjatë luftës në rajonin e Gjakovës*



*Krimineli me damkë Nebojsa Miniq – “Mrtvi” (“I vdekuri”),
së bashku me djalin e axhës së tij, Miroslav Miniqin, të njohur në Pejë e më gjerë
edhe si pjesëtarë të formacionit terrorist “Dora e Zezë”*



Letërnjoftimi: Nebojsna Miniq – MRTVI, krimineli monstruoz që e gjakosi Pejen. Pos tjerash, vrasës i familjes Bala: Vjollcë Faredin Balës (28), Agron Isa Balës (6), Hajri Isa Balës (13), Dardane Isa Balës (12), Rina Musa Balës (7), Nita Musa Balës (5) dhe Musa Shaip Balës (31), të plaçkitur, të përdhunuar e të ekzekutuar në shtëpinë e tyre, më 12 qershor 1999 në Pejë



Kriminelët serbë Srećko Popović (i dyti nga e majta) dhe Sllavisha Kastratović (i tretë nga e majta), bashkë me dy kriminelë të tjerë, pjesëmarrës në masakra mbi popullatën civile shqiptare në rajonin e Pejë, Istogut e më gjerë



Krimineli Srećko Popović, komandant i njësisë terroriste “Munja” (“Vetëtima”), pjesëmarrës në masakrat çnjerëzore, më 14 maj 1999, në Çyshk, Zahaq, Pavlan etj., pozon para shtëpive shqiptare pasi ua kanë vënë zjarrin



Mbetje të raketave tokë-tokë, të tipit “Luna” (prodhim rus – me 1187 kilogram mbushje eksplozive), me të cilat u goditën fshatrat Gillogjan e Irzniq, më 11 qershor 1998



Gëzhoja të artilerisë serbe, me të cilat u sulmua Shqiponja (ish-Jabllanica) më 2 gusht 1998



Në Fushë-Kosovë kriminelët serbë fotografohen para trupave të tre shqiptarëve të masakruar. Në mesin e tyre me nr. 1, Baleviq dhe me nr. 2, Gojković, pjesëmarrës në një varg krimesh në Pejë



Krimineli serb Gorolub Paunoviq (1969), ish-punëtor i PTT-së në Vushtrri, duke prerë në fyt një të ri shqiptar. Sipas dëshmitarëve, ky kriminel ishte pjesëmarrës edhe në krimin në familjen e Hamdi Uglarit (Shallcëve), 1999



Pjesëtarë të Njësisë Terroriste "Munja", pos tjerash, pjesëmarrës edhe në Masakrën në Burgun e Dubravës



Më 19, 21 dhe 22 maj 1999, në masakrën në burgun e Dubravës, kriminelët ordinerë serbë kanë vrarë e masakruar 184 të burgosur shqiptarë dhe plagosur 140 të tjerë



*Të burgosurit **Përparim Efendiu** (krejt trupi – pa flokë) nga Gjakova, **Ali Guta** (pa flokë, i duket vetëm koka), i vëllai i viktimës Napoleon Guta, **Kolë Berisha** (me flokë të zeza) nga Peja, i cili thuhet se është vrarë një ditë më vonë nga kriminelët serbë. Me revole dhe automatik në dorë kriminelë serb Boban Bashçeviqi nga Nikshiqi. (Burgu i Dubravës, 22 maj 1999).*



*Krimineli Boban Bashçeviq ekzekuton të burgosurit shqiptarë në burgun e Dubravës.
(22 maj 1999)*



*Krimineli serb Ilia Mishkoviq nga Çaçaku, ish-i burgosur, pjesëmarrës aktiv në masakër.
(Dubravë, 22 maj 1999)*



Krimineli serb Mirolub Miki Vidiq nga “Kapeshnica” e Pejës, ish-komandant i burgut të Dubravës, vret të burgosurit shqiptarë. (Dubravë, maj 1999)



Civilë të masakruar nga forcat serbe, më 25 maj 1998, në Lybeniq të Pejës.



Njëra nga vendet e krimit ku janë djegur një pjesë e trupave të civilëve të ekzekutuar nga forcat kriminale serbe, më 1 prill 1999, në Lybeniq të Pejës



Mbetje eshtrash të shqiptarëve të masakruar në Lybeniq të Pejës, më 1 prill 1999



Kufoma shqiptarësh, të vrarë nga forcat serbe në prill të vitit 1999, në Lybeniq të Pejës



Kufomat e shtatë vëllezërve Bobi, të masakruar nga forcat okupuese serbe, më 18 prill 1999, në Devë të Gjakovës



FOTOGRAFIA E TMERRIT

Mbetje eshtrash të 14 luftëtarëve të UÇK-së, të vvarë më 29 mars 1999 në Shishman të Bokës.
Pas vrasjes, forcat serbe i grumbulluan dhe i dogjën trupat e tyre,
bashkë me armatimin dhe municionin që kishin me vete.
Pas luftës, janë varrosur në një arkivol të përbashkët në varrezat e Gjakovës



Pjesë të mbetjes së eshtrave të civilëve të plagosur, të zënë të gjallë, të masakruar nga forcat serbe, e të djegur në shtëpinë e Rrustem Tahirit në Bardhaniq të Gjakovës, më 6 prill 1999. Në mesin e tyre ishin Nezir Ibish Vishaj (1934) nga Belegu i Deçanit, Fatime Isuf Gashi (1937) dhe Hatixhe Smajl Gashi (1949) nga Kosuriri i Pejës, Miftar Demë Povataj (1945), nga Strellci i Epërm, mësues, dhe gruaja e tij Hatixhe Povataj (1947), Qazim Muçaj (1951), nga Lluka e Epërme, Hysen Hatashi nga Jabllanica e Pejës



Gjurmë të masakrës së forcave serbe në Meje-Korenicë të Gjakovës, më 27 prill 1999



Mbetje eshtrash të civilëve të vrarë në masakrën e Meje-Korenicës, më 27 prill 1999



Çyshk i Pejës: Vendi ku pas masakrës së 14 majit 1999, forcat serbe kanë djegur 42 kufoma të civilëve shqiptarë



Kafka e Lan Dobrës (82), rapsod i njohur nga fshati Gramaçel i Deçanit, i masakruar nga kriminelët serbë, së bashku me Ukë Beçirajn (80) dhe Bekë Muslijajn (60) nga fshati Shaptej, më 10 maj 1999, në vendin e quajtur Shavare (mes fshatrave Gramaçel dhe Shaptej), derisa kishin shkuar për të tërhequr kufomat e vëllezërve Shemsi (41), Bajram (25) e Azem Muslijaj (24), dhe Rifat Beçiraj (21), të masakruar një ditë më parë nga forcat ushtarake e paramilitare serbe. (Fotografuar me rastin e gjetjes së tyre më 3 korrik 1999)



Vendi ku janë djegur trupat e 14 pjesëtarëve të UÇK-së, (në mesin e tyre edhe disa të plagosur), të vrarë në pritën e ushtrisë jugosllave, më 24 maj 1999, në trekëndëshin kufitar Kosovë – Shqipëri – Mal i Zi, në Bjeshkë të Bogiqes. Ata që mbetën gjallë – të plagosur, forcat serbe i ekzekutuan nga afërsia, pastaj i dogjën kufomat tyre. Mbetje eshtrash të këtyre të vrarëve, janë gjetur në varrezën masive në Petrovo Sello të Serbisë, në vitin 2003



Pos djegies së kufomave të shqiptarëve në shkritoren e Borit, hekuranën e Smederevës e të Mačkaticës, djegien e kufomave, me qëllim të shkatërrimit të dëshmimeve të krimeve, forcat serbe e kanë bërë edhe në minierën e Trepçës dhe në termocentralet e Obiliqit
Gjurmë të krimeve në njërin nga lokalet e objektit të kombinatit "Trepça" në Mitrovicë



KRIMINELËT UA VRANË FËMIJËRINË
Fëmijë të komunës së Gjakovës, të vrarë, të masakruar e të zhdukur nga forcat pushtuese serbe

Burimet dhe Literatura:

- a) Arkivi i UÇK-së së Zonës Operative të Dukagjinit
- b) Arkivi Shtetëror i Kosovës
- c) Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) - Pejë, Deçan, Prishtinë.
- d) Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) – Beograd.
- e) Qendra për Informim e Kosovës (QIK)

ABDYLI, Dr. Ramiz,

Politika serbe e gjenocidi ndaj Kosovës dhe shqiptarëve,
“Kosova”, nr. 2, 1994.

Arkivi Shtetëror i Kosovës - Sektori i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999,
përgatitur nga Nusret Pllana, Prishtinë, 2001.

BERISHA, Engjëll I.,

Masakra e Mejes dhe e Korenicës, SHB “Gjon Nikollë Kazazi”, Gjakovë, 2001.

KMDLNJ - Pejë,

Kronikë e dhunës dhe represionit policor serb mbi popullatën shqiptare të regjionin e Pejës gjatë vitit 1998,
(dorëshkrim).

KMDLNJ - Qendra Rajonale - Pejë,

Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës (mars-qershor 1999), Pejë, 2002.

Kosova e Lirë, 1999.

Kosovapress, 1999.

MEHMETAJ, Faton,

Veprimtaria kriminale e “Dorës së Zezë” serbe në trojet shqiptare, “Anatema”, Prishtinë, 2004.

Zloçini albanskih terorista (1995-1998), “Jedinstvo”, Prishtinë, janar 1999.

Gazetat dhe revistat:

24 Orë, Prishtinë, 2002.

Fokusi, Prishtinë, 2003-2005.

Koha Ditore, Prishtinë, 2004.

Kosova Sot, 2 shkurt 1999, 2005.

Shekulli, Tiranë, janar 2005.

Zëri, Prishtinë, 2004-2005.

Adresa interneti:

<http://www.mup.sr.gov.yu>

<http://www.americanradioworks.org>

<http://www.kosova.com>